

Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore



Mbështetur nga projekti i financuar nga USAID “Fuqizimi i Kapaciteteve Shqiptare Kundër Trafikimit” i zbatuar nga IOM

SHËNIM

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve apo të Qeverisë së SHBA-ve dhe/ose të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (ONM).

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

**Kuadri ligjor mbi trafikimin e qenieve
njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura
në praktikën gjyqësore**

Shkurt, 2013

HYRJE

Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtohet sot si një nga problemet prioritare të shoqërisë. Në instrumentet e ndryshme ndërkombëtare, trafikimi i qënieve njerëzore konsiderohet si “*një shkelje e të drejtave themelore të njeriut, të dinjitetit dhe të integritetit të qënieve njerëzore*”. Në këtë vështrim, trajtimi dhe analiza juridike e veprave penale në këtë fushë përbën një çështje të rëndësishme për të gjithë profesionistët e drejtësisë.

Në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve (USAID) “Fuqizimi i kapaciteteve shqiptare kundër trafikimit”, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ka organizuar disa aktivitete trajnuese me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerë të policisë gjyqësore. Shkolla e Magjistraturës ka mbështetur në vazhdimësi çdo iniciativë apo projekt, që ndikon në forcimin e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Këto aktiviteteve trajnuese kanë synuar rritjen e kapaciteteve kombëtare në identifikimin dhe asistencën e viktimave të trafikimit, rritjen e cilësisë së hetimit dhe gjyqimit të këtyre çështjeve penale, në funksion të parandalimit të tyre. Në aktivitetet e zhvilluara, ekspertët dhe pjesëmarrësit kanë theksuar me forcë edhe nevojën e bashkërendimit të të gjitha masave kundër trafikimit të qënieve njerëzore, duke siguruar një bashkëpunim efektiv mes prokurorisë dhe policisë gjyqësore.

Botimi që ju prezantohet është një përpyetje serioze për të përmbledhur eksperiencat dhe problematikat e shumta, me të cilat ndeshet sot praktika gjyqësore shqiptare, veçanërisht në identifikimin e rasteve të trafikimit të brendshëm. Materialet e përfshira në këtë botim trajtojnë çështje të rëndësishme të interpretimit gjyqësor të figurave të veprave penale në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore; elementë të trafikimit të brendshëm, në veçanti të fëmijëve; trajtimi dhe dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit; probleme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në këtë fushë. Ky botim jo vetëm që përmbledh të gjitha materialet e trajtuara nga ekspertë të ndryshëm, por duhet vlerësuar edhe si një mundësi e mirë për të gjithë aktorët e drejtësisë, për të reflektuar mbi çështjet e parashtruara, në përpyetje për të harmonizuar qëndrimet e praktikës gjyqësore.

Me këtë rast, falenderojmë të gjithë ekspertët e përzgjedhur për kontributet dhe qëndrimet e tyre profesionale.

Në mënyrë të veçantë falenderojmë Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), që mundësoi realizimin e këtij botimi.

Albana Boksi
Shkolla e Magjistraturës

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	3
1. Trafikimi i qënieve njerëzore. Këndvështrimi juridik. (Arqile Koca)	5
2. A e kalon legjislacioni penal shqiptar për trafikimin e qënieve njerëzore pragun e standarteve ndërkombëtare. (Iva Zajmi)	24
3. Analiza juridiko-penale të veprës penale të “trafikimit të personave”, dhe problematika e hasur në lidhje me kualifikimin e drejtë ligjor të kësaj vepre penale. (Luan Hazneziri)	34
4. Shfrytëzimi për prostitucion parashikohet në nenin 114 dhe 114/a të kodit penal parashikohet shfrytëzimi në rrethana të cilësuar, ndërsa në nenin 114/b të kodit penal parashikohet trafikimi i femrave. (Perparim Kulluri)	46
5. Trafikimi i qënieve njerëzore. Problemet e vërejtura në fazën e hetimit. Nevoja për ndryshime në kuadrin ligjor. (Olsian Çela)	51
6. Çështje të praktikës gjyqësore në lidhje me krimin e trafikimit të femrave. (Saida Dollani)	55
7. Disa mendime në lidhje me problematikën e hasur gjatë marrjes së provës me dëshmitarë në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar. (Amarildo Laci)	63
8. Trajtimi i viktimave të trafikimit si dëshmitarë gjatë procesit gjyqësor. Mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore. (Sander Simoni)	75
9. Trafikimi i të miturve. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore. (Dhurata Haveri)	86

OBJEKTIVAT

Njohja e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore në të gjitha dimensionet. Ndërgjegjësimi për shkallën e rrezikut që i kanoset shoqërisë nga trafikimi human. Njohja e aspekteve ligjore e juridike në lidhje me luftën kundër trafikimit në njerëz. Përvetësimi i teknikave hetimore e gjyqësore që sigurojnë efektivitet.

Gjendja në planin ndërkombëtar: Trafikimi human po bëhet gjithnjë e më tepër një fenomen global në rritje. Aspekti më i herët i globalizmit të shek.21. Asnjë vend apo rajon i botës nuk ka imunitet. Shifrat e trafikimit janë marramendëse, rreth 800,000-900,000 persona në vit (trafikim ndërkufitar). Rreth 2,000,000 persona në total (trafikim ndërkufitar + trafikim të brendshëm). Rreth 700,000 gra e fëmijë të trafikuar çdo vit. Rreth 7-8 miliard dollarë amerikan të ardhura vjetore. Rreth 90 % e femra të huaja që punojnë në industrinë e seksit në Evropën Juglindore janë viktima të dyshuara të trafikimit, dhe 10-15 % e tyre janë të mitura.

Tendencat globale: Pothuajse të gjitha vendet janë të përfshira në trafikim si vend origjine, transiti apo destinacioni, synimi drejt vendeve me ekonomi të zhvilluar. Rreth 18,000-20,000 persona të trafikuar për në USA çdo vit.² Rreth 120,000 gra e fëmijë janë trafikuar çdo vit për në vendet e BE.³ Vështirësia për të pasur të dhëna të sakta në lidhje me trafikimin. *“Numri i përgjithshëm i viktimave të trafikuar për në vendet e BE është ende i panjohur dhe vetëm vlerësimet e përgjithshme janë të vlefshme. Ajo që është e qartë, është fakti se, numri i viktimave është shumë herë më i lartë se numri i dhënë në statistikat zyrtare në çështjet e hetuara në vendet e BE”*.⁴

Gjendja në planin rajonal. Përfundimi i “luftës së ftohtë” dhe pasojat në trafikim. Fenomeni i shpërbërjes së shteteve dhe trafikimi. Vendet e rajonit, vende origjine dhe **transiti** me tendencë dhe destinacioni. Ndër vendet e rajonit Moldavia, Rumania, Shqipëria dhe Bullgaria konsiderohen si vendet kryesore origjine për në BE. Viktimat (kryesisht femrat dhe të miturit) trafikohen në Evropën Perëndimore por jo vetëm.⁵

Gjendja në planin e brendshëm. Ndryshimi i sistemit ekonomik-shoqëror dhe lëvizja e lirë. Çorientimi i vlerave në shoqëri dhe rritja e prostitucionit. Shqipëria konsiderohet si vendi kryesor i tranzitimit për në Itali për shkak të porteve, Shqipëria ka qenë kryesisht vend transit, vend origjine dhe destinacioni i përkohshëm. Aktualisht vend origjine dhe tendence destinacioni. Format kryesore të trafikimit janë ato për prostitucion dhe i fëmijëve për lypje kryesisht në Itali e Greqi. Femrat shqiptare trafikohen kryesisht për në Itali por dhe në Belgjikë e Greqi në një masë të konsiderueshme e më pak në Ukrainë e Holandë⁶. Më

1 Prokuror, në Prokurorinë e Përgjithshme.

2 Raport i Departamentit Amerikan të Shtetit.

3 Raport i Komisionit Evropian për 2001.

4 Të dhënat e Evropës 2000.

5 Linjat e trafikimit dhe kontrolli i dobët kufitar. Ukrainë - Jugosllavi (Beograd nëpërmjet Hung)– Kosovë - Shqipëri (liqeni Shkodrës), Beograd-Bosnje- Mali i Zi- Shqipëri (liqeni Shkodrës)-Vlorë Durrës ose Beograd-Bosnje- Kroaci-Sllloveni- Itali; Moldavi – Rumani – Bullgari – FYROM- Kosovë; Rumani–Serbi– Kosovë–Shqipëri; Rum-Bulg-FYROM(Greqi)-Shqipëri; Kosovë ose Bosnjë-Shqipëri (Durrës,Vlorë) ose Sllloveni, Kroaci-Itali; Kosovë- Shqipëri-Greqi ose Shqipëri-Itali; Bullgari –FYROM- Shqipëri(liq.Ohrit) ose Kosovë - Shqipëri.

6 Zonat më të prekura:Tiranë,Vlorë, Berat, Kucovë, Skrapar, Pukë, Lezhë.

shumë se 5,000 femra shqiptare kanë qenë viktima të trafikimit në dekadën e fundit Trafikimi stimulohet nga kufiri me vende të BE, nga pozicioni gjeografik, pasja e deteve e liqeneve.⁷

Trafikimi human një fenomen shumë dimensional çështje e dhunimit të drejtave themelore të njeriut të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare: *“Trafikimi, formë moderne e skllavërisë”*, çështje e zhvillimit ekonomik të vendit apo rajonit:

- çështje humanitare e shëndetësore;
- çështje e natyrës kriminale.

Baza social-ekonomike janë raportet kërkesë – oferte që përcaktojnë tendencën e lëvizjes nga vendet e pazhvilluara në ato të zhvilluara bazuar në shfrytëzimin dhe abuzimin e qënieve njerëzore nga individë apo grupe kriminale.

Format e trafikimit, grupet sociale të rrezikuara: **femrat e reja, fëmijët, meshkujt e rinj**, format e shfrytëzimit:

- prostitucion e shërbime të tjera seksuale;
- punë të detyrueshme;
- dhurim organesh;
- Shërbim ushtarak të detyruar;
- Martesa të ndërmjetësuar.

Trafikimi për qëllime të shfrytëzimit seksual ruan mbizotërimin në raport me format e tjera:

- siguron të ardhura më të mëdha;
- kondicionohet nga kërkesa dhe dëshira të shumëllojshme në realizimin e kënaqësisë seksuale;
- ka tendencë uljen e moshës së viktimave të trafikuar;
- ka tendencë zhvendosjen në rajone të largëta nga vendi i origjinës;
- kërcënim për të miturit për t'i përfshirë në industrinë e seksit.

Kërcënimet e zhvillimit shoqëror prej trafikimit, destabilizim i tregjeve ekzistuese të punës dhe seksit. Stimulim të zhvillimit të formave të tjera të kriminalitetit (korrupsionit, trafik të armëve, terrorizmit). Destabilizim ekonomik nëpërmjet rritjes së pastrimit të parave. Destabilizim demografik në aspektin etnik apo gjinor. Kërcënim për shëndetin publik.

Degradim të vlerave shoqërore. Stimulon korrupsionin duke kërcënuar sistemin e drejtësisë penale. Stimulon korrupsionin politik dhe blerjen e influencës politike. Frenon investimet e huaja duke goditur besimin. Trafikimi vlerësohet si formë e krimit të organizuar. Rrjetet informale të organizuara mbi baza etnike apo familjare. Rrjetet kriminale të organizuara në shkallë të gjerë. Rrjetet e grupeve kriminale (realizim pjesor të trafikimit).

Faktorët: Faktorët kryesore të trafikimit. Kuptimi i konceptit “faktorë shtytës”, “faktorë tërheqës” të trafikimit faktorë shtytës – faktorët e gjeneruar në vendet e origjinës. Faktorët tërheqës – faktorë të gjeneruar në vendet e destinacionit. Cilët janë këta faktorë sipas auditorit.

Faktorë shtytës:

1. Diferencat në zhvillimin ekonomik-social mes vendeve e rajoneve shkak kryesor global i stimulimit të trafikimit;
2. Aspirata për një jetë më të mirë;
3. Regjim i fortë emigrimi i vendosur nga shtetet më të fuqishme e të përparuara për të ruajtur standardet;
4. Mungesa e mjeteve financiare të individëve për të siguruar migrim;

⁷ Linjat kryesore të trafikut të brendshëm: Kosove-Mali i Zi- Liqeni i Shkodrës- Tiranë - Vlorë ose Durrës –Itali; Mali i Zi- Liqeni i Shkodrës - Tiranë- Elbasan- Korçë-Greqi; FYROM-Pogradec- Elbasan- Vlorë ose Durrës – Itali; Tiranë- Gjirokastër ose Sarandë – Greqi (Igumenicë)-Itali; Njëpërmjet Aeroportit të Rinasit; Goditja e linjave detare dhe zhvendosja e linjave në veri. Rritja e nivelit të sofistikimit.

5. Situata social – ekonomike e paqëndrueshme dhe tranzicioni i gjatë e i vështirë;
6. Luftërat rajonale apo të brendshme;
7. Persekutimi, dhuna politike, etnike, sociale;
8. Fatkeqësitë ambientale;
9. Mungesa e perspektivës dhe mundësive;
10. Shoqërimi i shkatërrimit të sistemeve politike me shturje të vlerave morale;
11. Problemet sociale të familjeve në vendeve të origjinës (diskriminimi gjinor, dhuna në familje, abuzimi etj);
12. Niveli arsimor i ulët sidomos në zonat rurale;
13. Padijenja dhe mungesa e informimit për rreziqet dhe pasojat e trafikimit;
14. Struktura shtetërore jo të afta, jo të besueshme, të korruptuara;
15. Mungesa e legjislacionit të përshtatshëm dhe strukturave e mjeteve të papërshtatshme;
16. Niveli i ulët i dënueshmërisë.

Faktorë tërheqës:

1. Shpresa e punësimit dhe e një jete më të mirë;
2. Të mirat materiale e jo materiale që lidhen me vendet e destinacionit;
3. Tregu i qëndrueshëm i punës në vendet e destinacionit;
4. Kërkesa e vazhdueshme për krah të lirë pune;
5. Trajtimi i përmirësuar social;
6. Reklamimi vezullues i jetës në vendet e perëndimit;
7. Kërkesat në rritje në industrinë e seksit në Evropën Perëndimore e shoqëruar me mundësinë ekonomike të realizimit;
8. Mungesa e edukimit dhe sensitivitetit të popullsisë Europere në lidhje me trafikimin.

Faktorë karakteristik për Shqipërinë që kanë nxitur trafikimin. Faktorë shtytës.

- Niveli i ulët ekonomik e sidomos i femrave në zonat rurale;
- Niveli i lartë i papunësisë sidomos ndër femrat;
- Pozita sociale e femrës në disa zona sidomos rurale;
- Mungesa e informimit në lidhje me rrezikun e trafikimit, format e rekrutimit;
- Mos stabiliteti politik në vend. Trazirat;
- Tranzicioni i gjatë dhe ë vështirë;
- Paaftësia e organeve të shtetit për të goditur krimin;
- Mungesa e besimit për shkak të korrupsionit;
- Qenia kufi me vendet destinacion;
- Kontrolli kufitar i dobët;
- Informaliteti i jetës dhe ekonomisë;
- Lëvizjet masive dhe anonimiteti;
- Regjimi tejet i ashpër e deri diskreditues në marrjen e vizave për jashtë;
- Humbja e besimit të popullit të aftësia e politikës për një përparim të shpejtë;
- Suporti nga struktura politike apo shtetërore i aktiviteteve të paligjshme.

Faktorët tërheqës:

- Afërsia e vendeve të BE (Itali, Greqi, etj.);
- Propaganda e njëanshme e emigranteve (historitë e dhimbshme nuk përfliten);
- Reklamimi vezullues i medieve Italiane dhe Greke që arrijnë të depërtojnë në Shqipëri. Mungesa e emisioneve që lidhen me fenomenin;
- Qëndrimi favorizues ndaj prostitucionit i vendeve anëtare të BE;
- Qëndrimi jo aktiv i shteteve të BE në lidhje me “punën në të zezë”;
- Prezenca e trupave ushtarake perëndimore në Kosovë.

Trinomi: kërkesë-ofertë-kontrolli tyre nga rrjetet kriminale nëpërmjet shfrytëzimit të viktimave

Dallimi nga kontrabandimi: Çfarë është kontrabandimi⁸. Definicioni sipas Protokollit shtesë të Konventës së OKB “Mbi Krimin e Organizuar Transnacional “Kalimi kontrabandë i emigrantëve” *“Marrëveshja për të marrë, drejtpërdrejt ose jo, një të mirë financiare apo materiale nga një hyrje e paligjshme e një personi në një shtet, anëtar i të cilit ai nuk është as shtetas as rezident i përbershëm i tij”*.

Dallimet nga kontrabandimi: “Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pritja e personave, me anë të kërcënimit, apo përdorimit të forcës ose të formave të tjera të detyrimit, të marrjes me forcë, të mashtrimit, të gënjeshtërs, të abuzimit të pushtetit ose të shfrytëzimit të pozicionit të cenusshëm, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve të tjera, për të arritur pranimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi”.

Kontrabandimi – veprë penale kundër rendit publik e kufijve; trafikimi – veprë penale kundër personit e dinjitetit. Kontrabandimi nënkupton kalimin e kufirit; trafikimi mund të kryhet dhe pa kaluar kufirin. Kontrabandimi nuk cenon vullnetin e të dëmtuarit; në trafikim ky vullnet është i cenuar. Trafikimi nënkupton “viktimë”; kontrabandimi jo.

Dallimi nga kontrabandimi: Në trafikim krijohen marrëdhënie shfrytëzimi ose synohen ato të cilat dallohen nga vazhdimësia; në kontrabandim nuk krijohen të tilla marrëdhënie dhe marrëdhëniet emigrant-kontrabandist ndërpriten në momentin që është realizuar kalimi i kufirit. Në kontrabandim është emigranti që kërkon shërbimin e kontrabandistit ndërsa në trafikim është trafikanti që nëpërmjet detyrimit apo shtrembërimit të vullnetit realizon migrimin. Viktima nuk mund të zgjedhë.

Qëllimi i lëvizjes në kontrabandë është kalimi i kufirit – në trafikim është vendosja e viktimës në një ambient të huaj me pamundësi mbrojtje. Në trafikim kemi shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Kontrabanda kërkon që kalimi i kufirit të jetë doemos i paligjshëm në trafikim jo domosdoshmëri, në trafikim, viktima nuk është e ndërgjegjshme për atë që e pret.

Trafficking- koncept kompleks, **të bësh tregti** (e ligjshme ose jo) pra, trafikim nënkupton tregtinë e qënieve njerëzore ç’ka është e ndaluar.

Smuggling- procedurë import – eksporti e kundërligjshme. Në këtë kuptim kontrabandimi (organizimi i kalimit të paligjshëm të kufirit) i qënieve njerëzore nënkupton transportimin e paligjshëm të qënieve njerëzore nga vendi i origjinës në vendin pritës.

Kontrabandimi lehtësisht mund të transformohet në trafikim. Praktikisht, kontrabandimi i femrave dhe fëmijëve duhet trajtuar si trafikim, për shkak të mundësisë për abuzim e shfrytëzim të tyre. Rëndësia e dallimit të koncepteve lidhet me mënyrën e trajtimit të personave (marrjen në mbrojtje, programet e riintegrit, mosdepërtimin, trajtimin social etj).

Fazat e trafikimit: Zakonisht trafikimi kalon nëpër tre faza: **rekrutimi – transiti – destinacioni:**

1. Rekrutimi: Në varësi nga niveli i deformimit të vullnetit rekrutimi mund të bëhet, me detyrim të plotë: - rrëmbim;- dhunë fizike, psikike; - përdhunim;- shitja e fëmijëve; - mashtrimi;- për jetë më të mirë; - për punë të mirë; - martesë apo bashkëjetesë normale;- për shkollim; - martesë e ndërmjetësuar; - udhëtime jashtë shtetit; - mashtrim me gjysme të vërteta; - punë në bare, pub, klube nate apo për striptease; - mashtrim apo fshehje e kushteve në të cilat do të ushtrojnë prostitucion;- brutaliteti që e pret; - kontrolli i plotë nga të tjerë; - pamundësia për të marrë vendime; - kushtet çnjerëzore të punës; - humbja e kontrollit mbi të ardhurat; - mos lejimi i legalizimit të qëndrimit; - mbajtja në kushte vulnerabël.

⁸ Ndihe për kalim të paligjshëm të kufijve Neni 298 i ndryshuar.

2. Tranzitimi. Qëllimi: -Të arrihet tregu fitimprurës. -Të largohet nga ambienti i njohur për të humbur mundësinë e mbrojtjes. Tranzitimi mund të përfshijë: transportin dhe transferimin (strehim, pritje). Fazat, tranzitimi shoqërohet me abuzime të të drejtave, me abuzime fizike, synohet që viktimat të mos disponojnë dokumente identiteti. Tranzitimi mund të shfaqet disa ciklesh.

3. Destinacioni, Pritje + shfrytëzim: Mënyrat e hyrjes në vendet e destinacionit: - Hyrje e fshehte (këmbë, mjete transporti, skafe); - Hyrje e hapur me dokumente të falsifikuara; - Hyrje e hapur me anë të dokumenteve për studime, punësime, udhëtime turistike, - shfrytëzimi- synimi kryesor i trafikuesit; -Vendosja në kushte skllavëruese për arritjen e fitimeve maksimale;- Zhvendosja e vazhdueshme e viktimave; - Ushtrimi sistematik i dhunës fizike, psikike dhe seksuale; - Përdorimi i vrasjeve si “leksione”.

Mënyrat e kontrollit të viktimave: - Detyrimi me anë të borxhit (për udhëtimin, për mbajtjen në hotele, për qiratë); - Të egzagjeruara; - Të pa përfundueshme në kohë; - Përdorimi i gjobave për sjelljet; - izolimi fizik i shoqëruar me privime të nevojave jetësore, kulturore; - Marrja e dokumenteve për ta mbajtur në situatë ilegale; Shfrytëzimi i pikave të dobëta; Njohje e thellë e viktimës; Shfrytëzim i natyrës sensible të femrës; brutaliteti në mënyrën e te menduarit dhe të vepruarit; marrja me të mirë dhe përdorimi i gënjeshtërisë; Premtim për martesë “pasi të zgjidhin hallet”; lejimi për të dërguar disa të holla në familje; Faza të sjelljes së mirë: - Blerje të veshjeve apo bizhuterive.

Fazat: - Ushtrimi i dhunës fizike, psikike, seksuale; - Dhunë periodike; - Dhunë seksuale në grup; Shoqërohet me veprime poshtëruese; dhunë që nuk njih kufij; Synon vartësinë totale psikike nga trafikanti; Ul nevojën e mbikëqyrjes fizike në distancë të afërt; “Dhënia e mësimit”; Kur viktima shfaq shenja mosbindjeje; Kur viktima tenton kontaktin me policinë; Kur viktima tenton kontaktin me familjarët; Nëpërmjet keqtrajtimit apo ekzekutimit të viktimave të tjera në sy të saj. Synon teorizimin ekstrem të viktimës dhe vartësinë pa kushte; Kërcënimi për familjarët; Drogimi; Siguron rendimet më të lartë ; Siguron vartësinë ndaj drogës që mund t’ja gjejë trafikanti.

Situata: e vetme në vend të huaj, e izoluar nga kontakti me bashkëkombësit, me miqtë, me familjen, nuk njih gjuhën, pa identitet zyrtar pasi është pa dokumente, e çorientuar nga lëvizje të shpeshta, objekt dhunë brutale, në pamundësi për tu drejtuar policisë pasi mund të dëbohet, shërbime të lodhshme e të pasiguruar, nën mbikëqyrje e kërcënime të vazhdueshme ndaj saj dhe familjes.

E drejta ndërkombëtare në lidhje me trafikimin: Vështirësitë në unifikimin e qëndrimeve të shteteve për përcaktimin e kuptimit të trafikimit. Zhvillimi i të Drejtës Ndërkombëtare në lidhje me trafikimin human.⁹ Efektivitet minimal - përqendrohej në mbrojtjen e viktimave - I kufizuar në dënimin e autorëve.¹⁰ Parashikonte detyrimin e shteteve nënshkruese të dënonin autorët.¹¹ 2 Dhjetor 1949 - Konventa e Lidhjes së Kombeve Për Shtypjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të tjerëve. Konventa e parë e rëndësishme në lidhje me trafikimin human. Konsolidon dhe zgjeron kuptimin dhe synimet e konventave të deri atëherëshme. Në mënyrë të qartë dënon çdo person që trafikon një tjetër për qëllime prostitucioni. Në mënyrë të qartë dënon çdo person që shfrytëzon prostitucionin e një tjetri. Aktet e mësipërme bëhen të dënueshme pavarësisht nga pëlqimi i të dëmtuarit; bëhet e dënueshme mbajtja, menaxhimi, financimi i shtëpive publike apo lenia, marrje me qira i tyre; bëhet e dënueshme tentativa dhe përgatitja e veprave të mësipërme sikurse dhe pjesëmarrja në to.

Konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare që mbështesin konventat mbi trafikimin: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut¹²: – dokumente bazë ku janë mbështetur legjislacionet e shteteve dhe që kanë lidhje me liritë dhe të drejtat e njeriut – nuk ka norma detyruese e dënime – vendos objektiva e parime që shtetet

9 18 Maj 1904- Marrëveshja Ndërkombëtare për Shtypjen e Tregut të Sklllevërve të bardhë.

10 4 Maj 1910- Konventa Për Shtypjen e Trafikut të Sklllevërve të bardhë.

11 30 Shtator 1921 nën kujdesin e Lidhjes së Kombeve - Konventa për Shtypjen e Trafikut të Grave dhe Fëmijëve; 11 Tetor 1933- Konventa për Shtypjen e Trafikut të grave në moshë Madhore.

12 10 Dhjetor 1948 nga UN.

zotohen t'i ndjekin – sanksionon liritë themelore –barazinë – ndalimin e skllavërisë e trajtimit skllavërues – torturën- trajtimin degradues etj.

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile e Politike, 16 qershor 1966 – Sanksionon heqjen e skllavërisë dhe tregtisë së skllavërve, gjendjes së nënshtrimit dhe punës së detyruar – parashikon rastet e palejuara të punës së detyruar. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, po e vitit 1966 – bën plotësimin e konventës së mësipërme në lidhje me liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore.

Konventa mbi Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, 3 Shtator 1981- parashikon detyrimin e palëve të marrin masa (përfshirë dhe ato legjislative) për shtypjen e të gjitha formave të trafikimit të grave dhe shfrytëzimin për prostitucion të tyre.

Konventa kundër Torturës dhe trajtimeve apo Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese, 10 Dhjetor 1984 – jep kuptimi e torturës apo trajtimit çnjerëzor e degradues – detyron palët të bëjnë të dënueshme me legjislacion të brendshëm akte të tilla.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 20 Nëntor 1989- jep kuptimin e fëmijës si qenie humane nën 18 vjeç- detyrimin e palëve për mbrojtjen prioritare të të drejtave të fëmijëve pa dallime - detyron palët të marrin të gjitha masat për mbrojtjen e tyre nga përfshirja, shfrytëzimi seksual apo pornografik; nga trafikimi në çdo formë apo për çdo qëllim.

Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të punëtorëve Emigrante dhe anëtareve të familjeve të tyre, 18 Dhjetor 1990 – synon mbrojtjen e emigranteve dhe familjeve të tyre nga skllavëria, puna e detyruar – përcakton rastet që nuk janë punë të detyruara.

Konventa Mbi Skllavërinë - 25 Shtator 1926 – jep përcaktimin e skllavërisë, punës së detyruar dhe tregtisë së skllavërve – detyrimin e palëve të marrin masat për zhdukjen e skllavërisë në çdo formë të saj – ndalimin e tregtisë apo trafikut. Konventa Shtese mbi Zhdukjen e Skllavërisë, Tregtimit të Skllavërve, të Instituteve e Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë - 7 Shtator 1956 – përpunon më tej konceptin e skllavërisë dhe formave moderne të shfaqjes, përpunon më tej konceptin e trafikimit duke theksuar atë të fëmijëve- kriminalizon aktet e skllavërisë.

Konventat nr.29 dhe 105 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me Punën e Detyruar dhe Zhdukjen e Punës së Detyruar - 1930 dhe 1957- bëhet përkufizimi i konceptit “punë e sforcuar apo me detyrim” – jep rastet se kur nuk jemi para punës së sforcuar apo me detyrim.

Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Karta e BE mbi të Drejtat Themelore (4.11.1950). Ndalon skllavërinë dhe kushtet skllavëruese, punën e sforcuar apo me detyrim:

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri apo në kushte skllavëruese;
2. Asnjë personi nuk do t'i kërkohet të kryejë punën e sforcuar apo me detyrim”.

Konventa parashikon në nenin 4 atë se çfarë nuk është punë e detyruar:

- Puna që kërkohet të kryhet gjatë kohës së qeni nën një masë sigurimi me heqje lirie apo lirimi me kusht;
- Shërbimi me karakter ushtarak;
- Shërbimi i urdhëruar me rastin e një emergjence apo fatkeqësie natyrore;
- Punë apo shërim si pjesë e detyrimeve normale civile.

Konventa nuk jep kuptimin e punës së sforcuar apo me detyrim. Kuptimi i punës së sforcuar apo me detyrim sipas nenit 2 të Konventës nr.29 të ONP (ILO) *“Çdo lloj pune që kërkohet nga një person me urdhër, nën kërcënimin e një dënimi, dhe për të cilën personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht”*.

Parimi universal i Konventës për interpretim progresiv të së drejtës pozitive, duke mos dhënë përkufizimet e nocioneve “skllavëri”, “kushte skllavëruese”, “pune e sforcuar apo me detyrim” e duke pasur parasysh format moderne të shfaqjes. Karta e të Drejtave Themelore sjell si të re në nenin 3 të saj “Trafikimi i qënieve njerëzore është i ndaluar,” në këtë mënyrë ky dokument e identifikon trafikimin si një formë moderne skllavërie.

Konventa mbi skllavërinë (25.9.1926). E para konventë ndërkombëtare në lidhje me trafikimin human, përcakton skllavërinë si: *“Status apo gjendje e një personi mbi të cilin ushtrohen një apo të gjitha format e lidhura me të drejtën e pronësisë”,* përcakton kuptimin e tregtisë së skllavërve si: *“Akte që kanë të bëjnë me kapjen, blerjen apo largimin e një personi me synim për t’ja nënshtruar skllavërisë; aktet që kanë të bëjnë me blerjen e një skllavi me qëllim shitjen apo shkëmbimin e tij; aktet e heqjes dorë nga ai për shitjen apo shkëmbimin e një skllavi të marrë për këtë qëllim si dhe në përgjithësi çdo veprë e shitjes apo transportimit të skllavërve”.* Konventa Shtesë mbi Ndalimin e Skllavërisë (7.9.1956). Zgjeron kuptimin e skllavërisë duke përfshirë dhe praktikën e ngjashme me të duke forcuar objektin e ndalimit.

Format e ngjashme me skllavërinë: Detyrimi me borxh; Gjendje shërbimi skllavërues; institut apo praktike ku:

- Një grua jepet për martesë kundrejt pagesës pa pasur të drejtën e refuzimit;
- E drejta e bashkëshortit apo familjes së tij për të çuar gruan te një tjetër;
- E drejta për të trashëguar gruan pas vdekjes së bashkëshortit të saj;
- Dhënia e fëmijës nga prindërit me qëllim shfrytëzimi.

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale parashikon si krim kundër njerëzimit në nenin 7 atë të skllavërimit si: *“ushtrim të një apo të gjitha tagrave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person” duke përfshirë “ushtrimin e këtyre tagrave gjatë trafikimit të njerëzve e sidomos grave e fëmijëve”* kur kryhet si pjesë e një sulmi të gjerë e sistematik kundër popullsisë civile dhe me dijeninë e shkaktarëve, parashikon si krime lufte të njëjtat krime në rrethana konfliktesh të brendshme apo ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare në lidhje me trafikimin, si Karta e BE dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale përdorin konceptin e skllavërisë në kontekstin e sotëm duke përmendur në mënyrë të qartë trafikimin në të njëjtën dispozitë ku përdoret skllavëria dhe puna e detyruar.

Konventa e Palermos +Protokollet: Konventa e OKB Kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollet Shtesë, një set instrumentesh ligjore i fuqishëm në luftën kundër krimit të organizuar, u nënshkrua në 15 Dhjetor 2000 në Palermo të Italisë, u ratifikua me 11.7.2002 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Përbërja:

- Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional;
- Protokollin Shtesë kundër trafikut të Emigrantëve nga Toka, Ajri dhe Deti.

Konventa e Palermos + Protokollet:

- Protokollin shtesë për Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve;
- Protokollin shtesë Kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armeve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve.

Qëllimi: Përpjekje të Komunitetit Ndërkombëtar për zhvillimin e instrumenteve kundër krimit të organizuar transnacional për arsye se: Problemi i krimit të organizuar po bëhet serioz; rritur niveli i bashkëpunimit mes organizatave kriminale; Globalizimi i ekonomisë hap shanse për krimin e organizuar.

Konventa e Palermos + Protokollet: Qëllimi primar – Bashkëpunimi ndërkombëtar: Neni 1: “... të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar,” të ofrojë instrumente për institucionet e zbatimit të ligjit dhe ndjekjes penale për inkurajimin dhe koordinimin e përpjekjeve në parandalimin dhe goditjen e krimit dhe për mbështetjen e viktimave, të inkurajojë marrjen e masave gjithë përfshirëse dhe për të dhënë orientime për të përqsur legjislacionin dhe politikën në raport me problemin.

Natyrë: Pjesë përbërëse e legjislacionit ndërkombëtar, ka fuqi detyruese për shtetet dhe jo për shtetasit, pranimi i tekstit përfundimtar realizohet me nënshkrim, pasohet nga ratifikimi dhe implementimi që konsiston në përqsasjen e legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar.

Natyrë substanciale: Konventa + Protokoll, detyrojnë shtetet të marrin masa kundër krimit të organizuar, transnacional dhe të nxisin bashkëpunimin. Konventa e Palermos + Protokollet. Vendos minimumin bazë të standardeve me synim që masat e marra nga shtetet nënshkruese të sigurojnë efektivitetin e masave kolektive ndërkombëtare. Dispozitat e 4 instrumenteve mund t'i ndajmë në 7 kategori:

1. Përkufizimet. Çdo instrument që në dispozitat e para bën përkufizimin e termave:

- jep elementet e veprës penale me të cilat merret;
- përcakton rrethanat e aplikimit të dispozitave;
- synon standardizimin e terminologjisë mes shteteve.

2. Kërkesë për parashikim si vepër penale:

- Konventa përcakton 4 krime të veçanta (pjesëmarrja në grupe kriminale të organizuara, pastrimi i parave, korrupsioni, pengimi i drejtësisë);
- Protokollet parashikojnë vepra penale shtesë dhe secila merret me trajtimin e tyre;¹³
- Detyron shtet të penalizojnë këto lloj veprash si “krime serioze”.¹⁴

3. Masa të tjera të brendshme:

- legjislacion dhe praktika që kufizon hapësirat e aktivitetit të krimit të organizuar;
- për rritjen e mundësisë së kontrollit (banka, pika kalimi, pasaporta, etj);
- parashikim të veprave penale shtesë në mbështetjen e atyre kryesore.

4. Detyrim për bashkëpunim ndërkombëtar:

- detyrime për ekstradim;
- për ndihmë juridike;
- për shkëmbim informacioni.

5. Trajnime e asistence teknike:

- detyrime për të trajnuar punonjësit;
- për të parashikuar fonde për teknikën e nevojshme dhe ekspertizë;
- përdorimin e fondeve të konfiskuara për këtë qëllim.

6. Parandalimi:

- Detyron marrjen e masave që ndihmojnë në parandalimin e veprave penale objekt të instrumenteve.

7. Dispozita teknike. Raportet e konventës me protokollet:

- Protokollet janë instrumente plotësues të konventës;
- Secili protokoll mund të lexohet e zbatohet në lidhje të ngushtë me konventën;
- Në aspektin formal shtetet duhet të ratifikojnë konventën që të bëhen pjesë e protokolleve;
- Shtete mund të jenë pjesë vetëm e konventës por jo pjesë vetëm e ndonjë prej protokolleve;

¹³ Trafikun e emigranteve, trafikimin e qënieve njerëzore, trafikun e armëve të zjarrit.

¹⁴ Me maksimum 4 vjet burg e lart.

- Konventa ka parashikime të përgjithshme si bashkëpunimi, ndihma teknike apo ligjore dhe çdo protokoll ka parashikime specifike në plotësim dhe përshtatje të tyre, për t'u zbatuar në problemet specifike që trajton çdo protokoll.

Shtetet nënshkruese që janë duke u marrë me një çështje që trajtohet në një nga protokollat mund të mbështeten në parashikimet e përgjithshëm të konventës kur:

- Vepra parashikohet nga konventa ose është “krim serioz” dhe;
- është e natyrës ndërkombëtare dhe;
- implikon një grup të organizuar kriminal;
- vepra parashikohet nga protokollat dhe vete protokollat në mënyrë specifike deklaron se mund të zbatohen parashikimet e përgjithshme të konventës.

Protokolli i Palermos. Plotësim i Konventës së OKB Kundër Krimit të Organizuar Trans-Nacional (dhjetor 2000). Për herë të parë bëhet një përcaktim i plotë detyrues i trafikimit duke u bërë bazë për legjislacionet e brendshme. Neni 3 “**Trafikim i personave do të thotë:**

- rekrutim, transportim, transferim, strehim apo pritje të personave, me anë kërcënimi apo përdori të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të marrjes me forcë, të mashtrimit, të gënjeshtërisë, të abuzimit me pushtetin ose të shfrytëzimit të një pozicioni delikat, apo të marrjes apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme, apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme për të arritur pranimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi duhet të përfshijë, **si minimum**, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose të formave të tjera të detyrimit, të punës apo shërbimeve të detyruara, të skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë apo të heqjes së organeve ose shërbimet;*
- Pëlqimi i një viktime të trafikimit për shfrytëzimin e shpjeguar më sipër do të jetë i pavlefshëm nëse është përdorur një nga mjetet e detyrimit të parashikuara më lart;*
- Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pritja e një fëmijë për qëllime shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim i njerëzve” edhe nëse nuk përdoret asnjë nga mjetet e përcaktuara në pikën (a);*
- ”Fëmijë” do të thotë çdo person nën 18 vjeç.*

Protokolli i Trafikimit të OKB. Struktura e konceptit të trafikimit:

- Rekrutim, transportim, transferim, strehim, pritje;
- Të një personi madhor: me anë detyrimi, marrje me forcë, me mashtrim, abuzim me pozicionin dominues, duke marrë apo dhe në përfitime për të arritur pranimin e një personi që kontrollon viktimën;
- Të një personi nën 18 vjeç;
- Për qëllime shfrytëzimi;
- Shfrytëzim të prostitucionit apo shërbime seksuale;
- Punë të detyruar apo shërbime të detyruara;
- Për skllavëri apo forma të ngjashme;
- Heqje organesh dhe shërbimet;
- Nuk ka rëndësi pëlqimi për t’iu nënshtruar shfrytëzimit.

Veçoritë e protokollit:

- Duke ju përgjigjur realitetit nuk kufizohet vetëm në shfrytëzimin seksual;
- Nuk është e rëndësishme nëse viktimat në fund, për shkak të parakushteve apo pozicionit lehtësisht të cenueshëm ku ka arritur të jap pëlqimin për shfrytëzim;
- Kombinimi i: Transferimit të pavullnetshëm ose nëpërmjet shtrembërimit të tij;
- Duke e vendosur në një pozicion social vulnerabël;
- Përfundon në shfrytëzim;
- E bëjnë të krahasueshme me tregtinë e skllavërve.

Protokolli mban qëndrim neutral ndaj qëndrimit të legjislacioneve për prostitucionin. Prezumon ekzistencën e trafikimit pra, dhe fajësinë nëse i dëmtuari është nën 18 vjeç. Parashikon detyrimin e shteteve të bëjnë të dënueshëm çdo veprim të përshkruar më sipër kur bëhet me qëllim. Protokolli detyron palët të bëjnë të dënueshëm tentativën, bashkëpunimin apo organizimin e nxitjen e personave të tjerë për të kryer ndonjë nga veprimet që para shikon neni 3.

Përcakton si qëllime të saj, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore duke u fokusuar veçanërisht te gratë dhe fëmijët. Mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikut nëpërmjet respektimit të të drejtave të tyre. Nxitjen e bashkëpunimit midis shteteve për arritjen e këtyre objektivave. Realizimin e qëllimeve e bën të mundur nëpërmjet. Dhënies së definicioneve të nevojshme. Detyrimin për kriminalizimin e trafikimit. Diferencimin e dënimeve për forma të rënda të shfaqjes së krimit apo për subjekt të posaçëm. Mundësi hetimi ndjekje dhe dënimi të trafikantëve.

Shtimit të mjeteve në duart e agjencive të zbatimit të ligjit e kontrollit kufitar duke shkëmbyer informacion. Trajnimit në lidhje me: - parandalimin –hetimin – të drejtat e viktimave dhe të njeriut – në problemet gjinore. Bashkëpunimit me shoqërinë civile. Masat në pikat e kalimit kufitar dhe cilësinë e dokumenteve të udhëtimit. Ruajtja e balancës midis mbrojtjes së viktimës dhe nevojës për përfshirjen në një proces penal. Ndihmës dhe mbrojtjes së viktimës: privaci – informim në lidhje me procedimin – rikuperim fizik e psikologjik – kërkesa specifike për të miturit – mbrojtje të viktimës; parandalimit; informim dhe edukim i viktimave, zyrtareve dhe publikut; asistencë e viktimave nga avokatë gjatë procesit penal; parandalimi nga riviktimizimi.

Mjetet e trafikimit: Dhuna; Fizike ose psikike; Është e pranishme doemos në njërin nga fazat; Mashtrimi: Gënjeshtër për jetë bashkëshortore; Premtim për punë të rregullt; Premtimi për bashkëjetesë të rregullt; Gënjeshtër në lidhje me kushtet e ushtrimit të prostitucionit duke i hequr mundësinë e vendimarrjes; Abuzimi me gjendjen vulnerabel.¹⁵

Qëllimet e trafikimit: Shfrytëzimi i prostitucionit apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual; Puna e detyruar apo shërbimet e detyruara; Protokolli zgjeron konceptin e punës së detyruar tej atij të Konventës nr.29 të ILO¹⁶ por dhe kur urdhërohen me mjete abuzive; skllavëria apo praktikat e ngjashme; heqja e organeve.

Shërbimet: Koncept i ri në përpunim nënkupton tendencën për kriminalizim të shërbimeve shtëpiake; ka elemente skllavërie dhe të punës së detyruar; shfrytëzohet pozicioni vulnerabel i viktimës duke e detyruar viktimën të kryej shërbime tej kushteve të negociimit paraprak (orët e punës, kushtet e punës e jetës, shërbime jo të negociuara, mos pagim etj).

Legjislacioni ndërkombëtar, Konventa e KE: Konventa Evropiane për Veprime kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore Maj 2005, Varshavë. Kërkon të forcojë mbrojtjen e komunitetit evropian nga ky fenomen dhe të ngrëjë në një nivel më të lartë statndartet tashmë të vendosura nga Protokolli i Palermos dhe akte të tjera. Kjo Konventë u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë me 20.11.2006.¹⁷ *Qëllimet e kësaj Konvente janë: të parandalojë dhe luftojë trafikimin e qenieve njerëzore nëpërmjet garantimit të barazisë gjinore; të mbrojnë të drejtat e njeriut të viktimave të trafikimit, të ndërtojë një kuadër gjithë përfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave dhe dëshmitarëve, nëpërmjet garantimit të barazisë gjinore si dhe të sigurojë hetim dhe ndjekje penale efektive të trafikimit, të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim që të sigurojë implementim efektiv të parashikimeve të Konventës nga palët, kjo Konvente ngre një mekanizëm specifik monitorimi.*

Përmirësimet që sjell kjo konventë në luftën kundër trafikimit. Përcakton se trafikimi i qenieve njerëzore përbën një dhunim të të drejtave të njeriut dhe një shkelje të dinjitetit dhe integritetit të qenieve njerëzore.

¹⁵ Pozicion ku personi nuk ka alternativë reale e të pranueshme, por veçse t'i nënshtrohet abuzimit.

¹⁶ Punë apo shërbim i urdhëruar nën kërcënimin e një dënimi çfarëdo.

¹⁷ Ligji nr. 9642 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

Konventa Evropiane bazohet në përkufizimin që bën, Protokollin për trafikimin e qenieve njerëzore. E reja që sjell ajo është se jep përkufizimin e konceptit “viktimit të trafikimit”: “Çdo person fizik i cili ka qenë subjekt i trafikimit të qenieve njerëzore siç është përcaktuar në këtë nen”¹⁸. Nuk bën diferencë në raport me viktimat e trafikimit dhe format e shfrytëzimit dhe diferencim në raport me karakterin (kombëtar apo ndërkombëtar) të krimit të trafikimit.

Duke ecur më tej Protokollin, parashikon detyrimin e palëve për t’i konsideruar si rrethana rënduese në legjislacionin e brendshëm, rastet kur; - vepra penale qëllimisht apo nga neglizhenca e madhe rrezikon jetën e viktimës, - vepra kryhet ndaj një të mituri, - vepra kryhet nga një nëpunës në ushtrim të detyrave të tij, - vepra kryhet në kuadër të një organizate kriminale.¹⁹ Orienton uniformizimin e sanksioneve për veprat penale të trafikimit duke parashikuar në nenin 23 që “... dënimet duhet të përfshijnë.. ndësbkime që përfshijnë heqjen e lirisë e cila çon në ekstradimin e trafikantëve”. Parashikon penalizmin e “klientit” që vepron me ndërgjegje kur pranon shërbimet e viktimës së trafikimit.²⁰ Kjo masë ndikon drejtpërdrejt në goditjen e një prej faktorëve themelore të trafikimit siç është kërkesa.

Ngre në një standard më të lartë parashikimet në lidhje me përgjegjësinë e personit juridik duke e bërë atë më të detajuar dhe lehtësisht më të implementueshme në legjislacionet e brendshme.²¹ Parashikon detyrime për një mbrojtje më të mirë të viktimave të trafikimit (Neni 6). Mbrojtja konsiston në disa drejtime si; ruajtja e privacisë së tyre, dhënien e informacionit mbi procedurat gjyqësore e administrative, marrjen e masave për rikuperim fizik e psiko-social në bashkëpunim me organizata jo-qeveritare, strehimin e sigurte (neni 11), mbrojtjen veçanërisht ndaj kërcënimeve gjatë një procesi penal,²² mbrojtjen gjatë procedurave të identifikimit si të tillë²³, kompensimin e viktimave etj. E drejta për të përfituar nga statusi si viktimë nuk do të varet nga bashkëpunimi ose jo me drejtësinë.

Në ndryshim nga Protokollin, Konventa i jep rëndësi të veçantë periudhës së reflektimit²⁴. Sipas nenit 13, kjo periudhë nuk do të jetë më pak se 30 ditë brenda se cilës viktimë prezumohet se shkëput përfundimisht lidhjet psiko-fizike me autorin dhe vendos nëse do të bashkëpunojë ose jo me autoritetet. Sikurse dhe Protokollin, Konventa pengon dënimin e viktimave për vepra të kryera prej tyre gjatë dhe për shkak të trafikimit.²⁵ Në dallim nga Protokollin evidenton detyrimin për ndjekjen penale “ex-officio” krahas asaj “ex-parte”.²⁶

Krijon një mekanizëm monitorues eficient dhe të pavarur. Ky është një dallim i rëndësishëm në raport me Protokollin. Sipas nenit 36 të Konventës mekanizmi monitorues do të përbëhet nga një grup ekspertesh që do të vëzhgojnë mënyrën e zbatimit të Konventës. Ky grup është quajtur GRETA dhe do të përbëhet nga 10 deri 15 anëtarë dhe do të bëjë vlerësimin e zbatimit të Konventës nëpërmjet pyetësorëve dërguar palëve apo dhe nëpërmjet vizitave në to për të verifikuar gjendjen e zbatimit të saj.

E drejta ndërkombëtare, përkufizime të tjera: **Akti për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit i USA, Tetor 2000; Forma të rënda të trafikimit:**

a) **trafikimi i seksit** në të cilin **akti komercial i seksit** është arritur me forcë, mashtrim, apo shtrëngim ose në të cilin personi i shtyrë në këtë akt nuk ka arritur 18 vjeç;

b) **rekrutimi, strehimi, transportimi, furnizimi apo pranimi i një personi për punë apo shërbime, duke përdorur forcën, mashtrimin apo shtrëngimin me qëllimin e nënshtrimit në shërbime të padëshiruara, zgjedhe, lidhje me borxh ose skllavëri.**

18 Neni 4.

19 Neni 24.

20 Neni 6.

21 Neni 11..

22 Neni 28.

23 Periudha menjëherë pas shkëputjes së viktimës nga trafikanti dhe paraqitja në autoritet shtetërore, periudha post-traumatike..

24 Neni 26.

25 Neni 27.

26 Neni 38.

Trafikim i seksit: rekrutimi, strehimi, transportimi, furnizimi ose pranimi i një personi me qëllim të një akti seksual komercial.

Shërbime të padëshiruara: përfshin një situatë shërbimi e shtyre me:

a) anë të ndonjë skeme, plani ose model që synon të bëjë një person të besojë se nëse ai nuk hyn ose nuk vazhdon në këtë situatë, ai ose ndonjë tjetër mund të pësojë dëmtime fizike apo psikike;

b) anë të abuzimit ose kërcënimit për abuzim të një procesi ligjor.

Lidhje me borxh: Statusi apo situata e një debitori që vjen nga lenia peng prej debitorit e shërbimeve të tij apo të njerëzve që ka nën kontroll për të siguruar borxhin, nëse vlera e këtyre shërbimeve në vlerësim të arsyeshëm nuk është aplikuar për likuidimin e borxhit ose kohëzgjatja dhe natyra e këtyre shërbimeve nuk janë respektivisht të limituara apo të përcaktuara.

Legjislacioni i brendshëm. Kushtetuta Neni 3 bazat e shtetit, Neni 25, 26, 27 liritë dhe të drejtat vetjake, Neni 122 Marrëveshjet ndërkombëtare.

Kodi Penal: Dispozitat mbi trafikimin Neni 110/a; Neni 114/b; Neni 128/b.

Karakteristikat. Përafrim intensiv e dinamik me legjislacionin ndërkombëtar dhe kryesisht me konventat Jep garanci mjaft të mëdha për personat e dyshuar për veprat penale në lidhje me të drejtat e tyre në një proces penal. Ende nuk siguron standardet maksimale në mbrojtjen e viktimave dhe realizimin e të drejtave të tyre. Mangësi të akteve nënligjore të domosdoshme për bërjen efektive të parashikimeve ligjore.

Kushtetuta: Akti themelor i organizimit të shtetit i cili vendos bazat e tij dhe që bën rregullimin në mënyrë të drejtpërdrejtë liritë dhe të drejtat themelore të individit si dhe detyrat e operatorëve juridik.

- Në **nenin 3** përcakton se: *Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojtë.*
- **Neni 25:** *Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruar*
- **Neni 26:** *Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.*
- **Neni 27:** *Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të caktuara në ligj. Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme:*

Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Karakteristika të kushtetutës në raport me të drejtat:

- Të drejtat dhe liritë e njeriut, dinjiteti i tij, përfshihen në parimet themelore të kushtetutës dhe përbëjnë bazën e shteti i cili ka për detyrë t'i mbrojtë.
- Në klasifikimin e të drejtave dhe lirive themelore, ato vetjake kanë përparësinë në raport me të drejtat politike, ekonomike, kulturore duke ruajtur klasifikimin e njohur nga aktet e ndryshme ndërkombëtare.
- Përcakton si karakteristika kryesore të të drejtave dhe lirive **pandashmërinë, patjetërsueshmërinë, padhunueshmërinë.**²⁷
- Përcaktimi i qartë i kufizimeve të të drejtave neni 17 duke e lidhur me **interesin publik, mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, ligjshmërinë, proporcionalitetin.**
- Vendos si standarde minimale të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore, ato të përcaktuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Parashikon mundësinë e zbatimit të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë (neni 4).
- Parashikon detyrimin e organeve shtetërore të luajnë rol aktiv në realizimin e të drejtave.

²⁷ Si thelbi i të drejtave, neni 15.

- **Neni 5:** *Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.*
- **Neni 116:** *Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSH janë:*
 - a) Kushtetuta, b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, c) ligjet, ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.
- **Neni 121:** *Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga RSH bëhet me ligj në rastet kur lidhen me: a) të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe detyrimet e shtetasve siç parashikohen në Kushtetutë b) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.*
- **Neni 122:** *Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në fletoren zyrtare të RSH. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejte, përveç rasteve kur nuk është e vetë zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji..... Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.*

Konkluzione:

- Kushtetuta ndahet nga qëndrimi dualist duke sanksionuar qëndrimin monist në raportet midis të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare.
- Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare bën pjesë në parimet themelore kushtetuese mbi bazën e të cilave bëhet interpretimi i vetë Kushtetutës.
- Deklarohet parimi i shtetit të së drejtës në lidhje me rregullat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare.
- Vendos hierarki në zbatimin e akteve që veprojnë në territor për të siguruar koherencën e duhur midis atyre kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Pozita hierkike e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara është e dyta pas Kushtetutës pra, në rast mospërputhje midis marrëveshjes së ratifikuar dhe ligjit të brendshëm, zbatohet e para.

Vlera juridike e marrëveshjes arrihet kur:

- Ratifikohet;
- Botohet në fletoren zyrtare;
- Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut bëhet me ligj si forma më e rëndësishme;
- Pranohet mundësia e përdorimit të drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare.

Kodi Penal:

- Deri në vitin 2001 nuk kemi dispozita të drejtpërdrejta mbi trafikimin e qënieve njerëzore;
- Kodi i vjetër parashikonte vetëm dy dispozita që mund të kenë lidhje neni 135 (ushtrimi i kurvërisë) dhe neni 136 (pornografia);
- Kodi penal i Ri miratuar me ligjin nr.7895 dt.27.1.1995, ende nuk parashikon trafikimin si vepër penale;
- Dispozita më e afërt është **neni 114 I** tij **Favorizimi i prostitucionit** që parashikon: “Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit - gjobë ose burgim deri pesë vjet;
- Po kjo vepër kur kryhet ndaj një të miture ose me anë të përdorimit të dhunës- burgim nga pesë në dhjete vjet burgim”.

Dispozite tjetër e parashikuar nga kodi në atë kohë dhe që mund të ketë lidhje **neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion** që parashikon “Mbajtja,shfrytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit dënohet me gjobë ose burgim deri në 10 vjet”.

Midis vitit 1995 kur u miratua Kodi Penal dhe vitit 2001 kur shfaqen për herë të parë dispozitat për trafikimin janë bërë **dy herë** ndryshime në K.Penal duke ndryshuar apo shtuar dispozita që lidhen me trafikimin apo përmbajnë koncepte fragmentare të tij: Me ligjin 8175 të vitit 1996 në K.P bëheshin këto ndryshime në lidhje me objektin që po trajtojmë.

Neni 114 i K.P **Shfrytëzimi i prostitucionit** ndryshohej si më poshtë: “Rekrutimi, nxitja, shtrëngimi i një personi për të ushtruar prostitucion, dhënia e ndihmës a marrja në mbrojtje gjatë ushtrimit të prostitucionit,

të kryera me qëllim për nxjerrjen e fitimeve, ndarjen e të ardhurave ose pranimin e pjesëve të caktuara nga përfitimet prej ushtrimit të prostitucionit përbën shfrytëzim të prostitucionit dhe dënohet me 10 vjet burgim e konfiskim të përfitimeve prej veprave penale”.

Pas nenit 114 shtohet 114/a **Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese** “Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer: ndaj të miturve, 2. ndaj disa personave, 3. ndaj një personi që shtyhet apo shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të RSH, 4. ndaj një personi me të cilin ekzistojnë marrëdhënie gjinie të afërta ose kujdestarie, 5. nga një person që ka të drejtë të mbajë armë, 6. me përdorim të dhunës fizike a psikike, 7. nga disa persona që nuk formojnë organizata kriminale, dënohet me 15 vjet burgim e konfiskim të përfitimeve”.

Shtohet neni **114/b Shfrytëzimi i prostitucionit nga organizata kriminale** “Shfrytëzimi i prostitucionit kur kryhet nga organizata kriminale Dënohet me 20 vjet burgim dhe konfiskim të përfitimeve nga vepra penale”.

Neni 115 ndryshohet **Ndërmjetësimi**. “Ndërmjetësimi midis dy personave, nga të cilët njeri ushtron prostitucion dhe tjetri merr pjese në këtë marrëdhënie kundrejt shpërblimit dënohet me 5 vjet burgim. Ndërmjetësimi midis dy personave nga të cilët njeri shfrytëzon prostitucionin ndërsa tjetri rekrutohet, nxitet a shtrëngohet për të ushtruar prostitucion, dënohet me 7 vjet burgim. Nëse vepra penale kryhet për ndërmjetësimin për ushtrimin e prostitucionit a për rekrutim, nxitjen ose shtrëngimin për ushtrimin e prostitucionit nga persona të mitur, të disa personave, të një personi me të cilin ndërmjetësuesi ka marrëdhënie gjinie të afërt ose kujdestarie, kundrejt shpërblimit ose për ushtrimin e prostitucionit jashtë territorit të RSH, atëherë ndërmjetësuesi dënohet me 9 vjet burgim.

Neni 116 ndryshohet **Mbajtja e lokaleve për prostitucion**. “Mbajtja, administrimi, shfrytëzimi, vënia në funksionim, financimi a dhënia e kontributeve në para për financimin e lokaleve të ngritura për ushtrimin e prostitucionit dënohet me 10 vjet burgim dhe konfiskim të lokalit. Pranimi dhe dhënia rregullisht me qira e lokaleve personave që shfrytëzojnë a ushtrojnë prostitucion, e bërë për këtë qëllim dënohet me 3 vjet burgim dhe konfiskim të lokalit. Veçoritë e ndryshimeve të K.P me këtë ligj. Duke qenë se përcaktoi dënime fikse, u shpallën si antikushetuese sanksionet dhe u pezullua zbatimi i dispozitave.²⁸

Shfuqizohet tërësisht si ligj me ligjin nr.8279 dt.15.1.1998. Ka vlera të mira teoriko-historike në lidhje me evoluimin e koncepteve mbi trafikimin. Bën përpjekje për një goditje në disa plane të shfrytëzimit të prostitucionit duke përdorur tre shkallë cilësimi të veprës penale 114, 114/a, 114/b, bën të dënueshme ndërmjetësimin, rit hapësirat e goditjes së personave që mbajnë lokale për prostitucion, bën përpjekje për goditjen e trafikimit me koncepte të shfrytëzimit të prostitucionit duke mbetur i kufizuar.²⁹

Nuk arrin të depërtojë në thelbin e konceptit të trafikimit duke reflektuar dhe kufizimet e legjislacionit ndërkombëtar. Nuk bën të dënueshëm forma të tjera të shfrytëzimit. Hedh idenë e grupit kriminal të organizuar 114/a,7 për herë të parë. Ndryshimet nuk janë në koherencë me pjesën e përgjithshme të K.P.³⁰ Mënyra e të shkruarit në ndonjë rast ka kontradiksione logjiko-juridike.

Ligji nr.8279 datë 15.1.1998 bën këto ndryshime në Kodin Penal. Shfuqizoi në tërësi ligjin që sapo trajtuam duke marrë tashmë si pikë referimi përcaktimet që bëheshin në K.P. të Ri të vitit 1995, Neni 114 që titullohet **Favorizim i prostitucionit** i ndryshohet titulli në **Shfrytëzim i prostitucionit** duke shfuqizuar dhe paragrafin e dytë të tij që cilëson veprën për shkak të elementëve **dhune** dhe **i mitur**. Shton nenin 114/a duke përcaktuar elementet cilësues të nenit 114 **Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese** “Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer: 1-me të mitur, 2- ndaj disa personave, 3- me persona me të cilët ekzistojnë lidhje

28 Vendimi nr.14 dt.29.5.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

29 Futet koncepti i rekrutimit, i shtrëngimit për të ushtruar prostitucionit jashtë territorit, përdorimin e dhunës fizike a psikike pre shfrytëzimin.

30 Kuptimi i bashkëpunimit, format, detyrimin për konfiskim.

të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfitur nga raportet zyrtare, 4- me mashtrim, shtrëngim, dhune apo duke përfitur nga paaftësia mendore apo fizike e personit. 5-ndaj një personi që shtyhet apo shtrëngohet të ushtrojë prostitucion jashtë territorit të RSH. 6- nga organizata kriminale dënohet nga 7-15 vjet burgim dhe konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve.

Veçoritë e ndryshimeve të K.P me këtë ligj. Mbetet po në ato kufizime që u thanë dhe për ndryshimet e mëparshme në raport me trafikimin. Evoluon në koncept nga favorizim në shfrytëzim të prostitucionit. Redukton konceptin e rekrutimit. Cilëson subjektin e veprës penale dhe raportet e krushqisë në shfrytëzim si dhe elementin e paaftësisë së të dëmtuarit.

Ligji nr.8733 dt.24.1.2001 "Për disa shtesa e ndryshime në K.Penal të RSH", për herë të parë shfaqen në Kodin Penal dispozita që godasin drejtpërdrejt trafikimin e qënieve njerëzore. Këto ndryshime janë një reflektim i menjëhershëm i detyrimeve të marra nga nënshkrimi i Konventës së Palermos me 15.12.2000. Në raport me trafikimin e qënieve njerëzore ky ligj perverse parashikon dispozita që penalizojnë trafikimin bën ndryshime dhe në pjesën e përgjithshme të K.Penal duke harmonizuar më mirë atë me Kushtetutën në fushën e të drejtave.

Duke shtuar nenin 1/a në K.P përcaktohen bazat e legjislacionit penal si më poshtë: "*K.P bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare penale, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar*". Me anë të shtimit me nenin 1/b ligji përcakton detyrat e legjislacionit penal i cili "*...ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit, dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga v.p, si dhe parandalimin e tyre*".

Duke bërë shtesë në nenin 7 të K.P ky ligj gjithashtu zgjeron rastet se kur ligji penal shqiptar bëhet i zbatueshëm për shtetas të huaj që kryejnë vepra penale jashtë territorit shqiptar. Kështu në nenin 7, ndryshohet pika (d) me këtë përmbajtje "*...Ligji penal i RSH është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që jashtë territorit të RSH kryen në dëm të interesave të shtetit apo shtetasit shqiptar një nga krimet e mëposhtme: organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave, prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike...*" Për herë të parë parashikon mundësinë e dhënies së dy lloj dënimeve kryesore duke dalë tej rregullit të përgjithshëm. Pas paragrafit të katërt të nenit 34 shtohet: "*Për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të ndonjë lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita parashikon vetëm dënim me burgim, gjykata mund të japë dhe dënim me gjobë*."

Cilat janë arsyet e këtij ndryshimi? Kuptohet se ndryshimet kryesore të këtij ligji në K.P që lidhen me objektin janë shtimi i neneve 110/a, 114/b, 128/b:

- Neni 110/a: Trafikimi i njerëzve, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 5 deri 15 vjet. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.
- Neni 114/b: Trafikimi i femrave për prostitucion, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 7-15 vjet burgim. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin e saj, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.
- Neni 128/b: Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga 10-20 vjet burgim. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.

Analiza e dispozitave: Dispozitat mbi trafikimin janë dispozita blankete- ato të referojnë në definicionin e Konventës:

- Neni 114/b dhe neni 128/b janë forma të cilësuar të trafikimit të qënieve njerëzore;
- Neni 114/b cilësohet në dy momente;
- Gjininë e viktimës (femra) dhe lloji i shfrytëzimit në qëllimin e trafikimit (prostitucioni);
- Neni 128/b cilësohet vetëm në moshën e viktimës së trafikut (nën 18 vjeç).

Sa herë evidentohen elemente të trafikimit dhe i dëmtuari nuk është **femër** dhe **nuk është i mitur** do të zbatohet vepra do të kualifikohet sipas nenit 110/a K.P. Sa herë që do të evidentohen elementet e trafikimit dhe i dëmtuari është **femër** por, qëllimi i trafikimit **nuk** është shfrytëzimi i **prostitucionit**, vepra do të kualifikohet sipas nenit 110/a të K.P. Sa herë që evidentohen elementet e trafikimit dhe i dëmtuari është **i mitur**.³¹ Kualifikimi 128/b. Secila prej dispozitave paraqitet në dy paragrafë madje tre në varësi nga graviteti i formave të deformimit të vullnetit, bashkëpunimi, përsëritja dhe pasojave të viktimës.

Veprat parashikohen në Kreun II “Vepra penale kundër personit” në seksionet VIII dhe IX “VP kundër moralit dhe dinjitetit” “Vepra Penale kundër fëmijëve”.

Objekt i veprave penale janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, morali dhe dinjiteti i tij, të drejtat themelore të fëmijëve. Nga ana objektive vepra kryhet me anë të: rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes apo pritjes së personit duke përdorur kërcënimin, forcën, shtrëngimin, mashtrimin, marrjen me forcë, dredhinë abuzimin me pushtetin, abuzimin me pozicionin vulnerabël, dhënien apo marrjen e pagesave.

Subjekti i veprave penale është subjekti i përgjithshëm. Nga ana subjektive kryhet me dashje direkte dhe kërkon si element të domosdoshëm qëllimin e shfrytëzimit. Vepra do të quhet e konsumuar edhe kur personi ka kryer vetëm një nga veprimet: rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, ose pritjen e personave. Nuk është e domosdoshme që shfrytëzimi të bëhet doemos prej atij që kryen rekrutimin apo transportimin. Trafikimi si vepra penale konkurren me kalimin e paligjshëm apo dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm 297, 298 K.P.

Ai konkurren me vepra penale të mbajtjes së lokaleve për prostitucion, me falsifikimin, trafikimi thith shfrytëzimin e prostitucionit?

Ndryshimet e reja në K.Penal. Ligji nr. 9188 date 12.2.2004. Ndryshimet konsistojnë:

- Ndryshohen dispozitat e trafikimit neni 110/a,114/b,128/b;
- Ndryshohen dispozitat që kanë të bëjnë me falsifikimin e dokumenteve;
- Shfuqizohet paragrafi i dytë i nenit 297;
- Ndryshohet neni 298 i K.P duke përfshirë në të dhe konceptet e paragrafit të dytë të nenit 297.

Veçori të ndryshimeve të dispozitave të trafikimit:

- Nuk është më dispozitë e bardhë pasi përkruan në çdo dispozitë kuptimin e trafikimit (i personave, femrave, fëmijëve);
- Në pjesën përshkruese të dispozitave përfshihet përkufizimi i dhënë nga Konventa duke bërë modifikimet në vartësi nga elementi cilësues;
- Neni 114/b përbën formë të cilësuar të trafikimit të personave duke u cilësuar vetëm në gjininë e viktimës duke hequr cilësimin e qëllimit për shfrytëzimin e prostitucionit;
- Me vendosjen e termit “si dhe formave të tjera të shfrytëzimit” implementon konceptin e interpretimit progresiv të së drejtës pozitive të trajtuar më lart;
- Përcakton detyrimin që përveç dënimit me burgim të jepet dhe gjobë duke synuar të godasë synimin e kimit (fitimet marramendëse);
- Shkëputet nga dënimi fiks (në kundërshtim me parimet) në rastet kur viktimja ka pësuar vdekjen sikurse parashikohej;

³¹ Edhe pse mund të jetë femër dhe të shfrytëzohet për prostitucion.

- Bën të cilësuar në paragraf të dytë çdo veprë për organizuesit, drejtuesit, financuesit e trafikimit;
- Bën të cilësuar në paragraf të pestë kryerjen e veprës nga subjektet e posaçëm duke rritur masat e dënimit me ¼ duke synuar të godasë korrupsionin e strukturave shtetërore;
- Nuk ndryshon sanksionet në llojin e dënimit me burgim përveç rastit kur viktimat ka pësuar vdekjen që vendos si minimum 20 vjet burgim;
- Ka një kontradiktë paragrafi i dytë dhe i tretë.

Në situatën aktuale:

- Do të aplikohet neni 110/a i Kodit Penal sa herë që viktimat e trafikimit janë meshkuj madhore pavarësisht nga qëllimi i shfrytëzimit.
- Do të aplikohet neni 114/b i K.Penal sa herë që viktimat të trafikimit janë femra madhore, pavarësisht nga qëllimi i shfrytëzimit;
- Do të aplikohet neni 128/b i K.Penal sa herë që viktimat është i mitur, pavarësisht gjinisë dhe pavarësisht qëllimit të shfrytëzimit. Me Ligjin nr.9859 dt.21.1.2008 u bë shtesë në K.P duke përfshirë dhe "shitjen".

Metodologjia e hetimit: Koncepti i hetimit "proaktiv" dhe "reaktiv":

- **Proaktiv**- hetim i ngritur jo mbi bazën e deklarimeve të viktimave;
- **Reaktiv**- hetim i ngritur mbi bazën e deklarimit të viktimës;
- Gjithnjë e më tepër po i drejtohem hetimit proaktiv;
- Gjendja aktuale e hetimit bazohet pothuajse vetëm mbi hetimin reaktiv;
- **Hetimi reaktiv**: Nënkupton kundërpërgjigjen tonë pas marrjes dijeni nga viktimat apo të tretë për veprën penale;
- Identifikimi si viktimë - detyrë e vështirë;³²
- Disa parime që duhen pasur parasysh në identifikim.

Në intervistën e parë duhet të konsiderohet vetëm si viktimë potenciale. Identifikimi i plotë si viktimë - rezultat i hetimit të plotë të elementëve. Koha është e nevojshme për shkak të natyrës komplekse dhe nevojës së reflektimit të viktimës. Nevoja e mbledhjes së provave të tjera veç deklarimeve. Teknika e pyetjes synon detajet që ndikojnë në - evidentimin e gënjeshtërisë - rritjen e besueshmërisë së deklarimit para gjyqtarit. Kontakti permanent psikologjik. Indikator të evidentimit të viktimave. Kufizime të lirisë personale. Kufizim të zgjerimit të shoqërisë dhe thellim të kontakteve sociale mbyllja në vëzhgimi i vazhdueshëm.

Mënyra të pagesës pamundësi për të vendosur për të ardhurat, nuk ka akses të drejtpërdrejt mbi to pronari i shtëpisë publike ia kalon të ardhurat një të treti, pagesa ndryshon nga rregullat e përgjithshme për vendaset, femra ka borxhe që nuk janë nën kontrollin e saj për të cilat duhet të punojë merr vetëm një minimum të ardhurash për mbijetesë.

Situata në punë, kontroll i vazhdueshëm nga tutori orë të gjata në ambientet e shfrytëzimit nuk është e lirë të refuzojë klientë apo lloj shërbimi nuk është e lirë të përfundojë punën dhe të kthehet në shtëpi. Rekrutimi nuk ishte e informuar se do të bënte prostitutën apo për kushtet e prostituimit. Në aspektin objektiv femra nuk ka pasaportë nuk ka para ka gjurmë keqtrajtimi. Pamje të parregullt e neglizhence ndaj vetes nuk guxon të flasë për problemin jep idenë se është instruktuar mirë, përpiqet t'ja mbathë mbahet në distancë nga femrat e tjera në ambientet e shfrytëzimit, e shqetësuar e paduruar, shumë e ndjeshme; shumë e frikësuar.

Indikatorë të tjerë: mosha e viktimës - sa më e madhe mosha aq më pak mundësi për të qenë viktimë dhe e kundërta, gjinia e viktimës - femrat grupi social më i rrezikuar, shtetësia e viktimës së mundshme- nëse shtetësia i takon vendeve të pazhvilluara, mundësia më e madhe; vendndodhja e fundit- nëse është gjetur në ambiente të njohura si shfrytëzimi, organizmi që prezanton rastin - OJF kanë ekspert të specializuar në identifikim. Viktimat e trafikut mund t'i ndajmë në tre kategori që nuk do të bashkëpunojnë që do të japin informacion por jo dëshmi bashkëpunon plotësisht.

³² Shpesh ngatërrohet me kontrabandim apo krime në prostitucion.

Kontakti i parë me viktimën - vendimtar për ecurinë e hetimit bazohet mbi parimet humanitare.

Të trajtohen si viktima të një krimi të rëndë dhe të mos riviktimizohen. Siguria e viktimës dhe familjes (një femër bashkëpunon vetëm në situatë konforte). Vlerësimi i rrezikut për viktimën dhe familjen duhet të jetë në vijimësi në çdo fazë të procesit. Qëndrimi i qartë, i hapur dhe i ndershëm me viktimat për çdo aspekt siguron besueshmëri. Nevoja e periudhës së reflektimit. Sigurimi i një këshilltari të pavarur psikolog, sociolog. Përpjekjet për të mosekspozuar të kaluarën e saj në publik, familje, gjyq. Përpjeke për evitimin e kontaktit të drejtpërdrejt fizik me trafikantë.

Çfarë duhet pasur parasysh. Deklarimi të ketë linjë logjike dhe të pasqyrojë rrjedhën e ngjarjeve. Me viktima që vuajnë traumën kërkohen më shumë se një deklarime për të arritur në pikën e mësipërme. Shmangia e paragjykitimit për besueshmërinë e viktimave të trafikimit për prostitucion. Siguron objektivitetin e hetimit. Të eksplorohehen sa më shumë detaje- viktima bëhet e besueshme – siguron nivelin e besueshmërisë nga gjykata - je i përgatitur ndaj pyetjeve të mbrojtjes.

Shpesh viktimës duhet ti tërhiqet vërejtje për të thënë të vërtetën. Të bëhet e qartë se eksplorimi i detajeve është nevojë e garantimit të suksesit dhe jo pjesë e kuriozitetit. Përdorimi i asociimeve në të kujtuarit e datave vendeve. Fiksimi kronologjik i momenteve kuçe të trafikimit për të vendosur në kohë faktet e tjera.

Përdorimi i listave të verifikimit gjatë marrjes së deklarimeve – pjesë e përvojës më të mirë, synon - të na japë mundësi të marrim sa më shume prova nga deklarimi, - të evidentojë sa më mirë elementet e veprës penale - të bëjë sa më të besueshëm viktimën. Lista e verifikimit sugjerohet të jetë në tre pjesë:

Pjesa A: Tregimi i plotë vendos pika me karakter të përgjithshëm në tregimin e viktimës për të përcaktuar mënyrën e veprimit të trafikantëve në të tre fazat e trafikimit;

Pjesa B: Hollësi specifike, përmban pyetje specifike për detaje në secilën fazë;

Pjesa C: Abuzimi fizik, seksual, psikologjik, synon evidentimin e të gjitha formave të abuzimit, dhunën fizike, psikike, përdhunimin, mbylljen, frikën, mashtrimin, ndikimin e krimit mbi viktimën. Edhe kjo listë ka vlerë për të tre fazat e trafikimit.

Hapat në vijim: Marrja e të gjitha provave të evidentuara nga deklarimi i viktimës ose siç njihet verifikimi i thënies; Të shoqërohen me regjistrim si foto, video në lidhje me vendet dhe hollësitë për to duke u përqendruar në momentet që nuk janë publike; të pyeten dëshmitarët e evidentuar nga viktima; të fillojë punë për identifikimin e autorëve mbi bazën e të dhënave të mara nga deklaratimet e viktimës; Të evidentojë me saktësi vendbanimet, vendet e punës, të frekuentimit të autorëve për të organizuar arrestimet kontrollet e tyre; Të bëhet ekzaminimi mjeko-ligjor i viktimës duke pasur parasysh se edhe pse duket të këmbëngulim në këtë pikë, do të jetë viktima që do të vendosë. Për të miturit nevojitet leja e prindit apo kujdestarit.

Arrestimi i të dyshuarve dhe kujdesi për respektimin rigoroz të aspekteve procedurale (arsyet). Kontrolli i vendeve dhe sekuestrimi i provave proces që kërkon kujdes. Siguron provën dokumentare e cila ka aftësi bindëse më të madhe; Jep mundësi për kryqëzim provash duke mos u mjaftuar vetëm me deklarime; Jep mundësi për të vënë të pandehurin në pozita pohuese dhe bashkëpunuese; Siguron besueshmërinë e deklarimeve të viktimës. *Procesi psikologjik që zhvillohet “ Nëse konfirmohen deklaratimet e viktimës për pjesën më të madhe të saj, pjesë që lidhet me elemente objektive dhe të mundshëm për t’u verifikuar, atëherë sigurohet besueshmëria e deklaratimit dhe për pjesët e tjera të këtij deklarimi që lidhen me elemente subjektive dhe të vështirë ose të pamundur për t’u konfirmuar por që janë elementë të veprës penale dhe të fajësisë së autorëve”.*

Rregull i artë gjatë kontrollit: *Brenda ligjit, të merret gjithçka që mund të përbëjë provë – në rast se nuk je i sigurt, përsëri merre, ajo mund të kthehet në vend përsëri më vonë, por po të libet pa u marrë, atë mund të mos e gjesësh më kur të vijë koha që të kuptohet rëndësia që mund të ketë pasur materiali si provë.*

Ku kontrollohet: Vendet e rekrutimit; Shtëpitë publike; Vendbanimet e autorëve; Vendbanimet e viktimeve; Vendet ku viktima ka pësuar dëmtime; Vendet e punës (agjencitë e udhëtimeve, agjencitë e ndërmjetësimit etj.).

Çfarë kërkohet:

- Çdo dokumentacion që ka të bëjë me procesin e rekrutimit, si kopje njoftimesh, agjendë takimesh, letra të drejtuara shkollave të gjuhëve të huaja, seksioneve të vizave, etj.
- Të hollat, kartat e kreditit, bllok çekesh ose ndonjë dokumentacion tjetër që lidhet me transaksionet financiare të çfarëdo lloj shume, pavarësisht nëse këto shuma janë të vogla apo të mëdha.
- Çdo lloj dokumentacioni që lidhet me pagesat e dhëna nga viktimat trafikuesve, si shënimet ditore për pagesat, listat e shkruara me dorë për pagesa të tjera, transfertë parash, etj.
- Çdo dokumentacion që lidhet me dokumentet e identifikimit dhe të udhëtimit, biletat, kuponët, mandat pagesat, kartat e udhëtimit në avion, kuponët e bagazhit, etj.
- Çdo lloj dokumentacioni që lidhet me nxjerrjen e pasaportës dhe të vizës, përfshirë këtu edhe letrat e sponsorizimit apo të garancisë, kontratat e agjencive martesore apo të damave të shoqërimit, format e regjistrimit në shkollën e gjuhëve, etj.
- Çdo dokumentacion që lidhet me menaxhimin e përditshëm të prostitucionit, si njoftimet, fletët ditore të punës, menyte e shërbimeve seksuale, listat e çmimeve, tekstet e parapërgatitura për t'u përdorur gjatë shërbimeve seksuale apo gjatë emisioneve të seksit me anë të shërbimit telefonik, etj.
- Çdo artikull tjetër që lidhet me shërbimin e prostitucionit, si uniformat, artikuj seksi, sasi të mëdha kontraceptivësh, materiale pornografike, etj.
- Çdo dokumentacion në lidhje me marrjen apo dhënien me qira të mjedisit, të vendeve të sigurta, ose adresat e tjera të lidhura me këto, së bashku me dokumentacionin që flet për pagesat e bëra.
- Të gjitha format e pajisjeve teknike të përdorura për komunikacion dhe informacion, si kompjuter, telefona celularë, fakse, agjenda personale të informatizuar, etj.
- Çdo pjesë me vlerë që ilustron shpenzime më të mëdha nga sa do ta lejonte e ardhura personale që zotërohet faktikisht nga të dyshuarit, si mjete të shtrenjta motorike, xhevahire, mobilime apo pajisje të tjera të cilësisë shumë të lartë, etj.

Prof. Asocc. Dr. Iva ZAJMI¹

1. HYRJE

Legjislacioni Shqiptar për goditjen e Trafikimit të Qenieve Njerëzore është frymëzuar nga legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë që prej viteve të para 2000. Në një dekadë, ai ka krijuar një mjet të rëndësishëm ligjor për të luftuar Trafikimin Njerëzor dhe për të mbrojtur viktimat e trafikimit në sistemin ligjor të brendshëm. Megjithatë janë hasur probleme në praktikë që vijnë prej vitesh dhe ka një nevojë më të madhe për harmonizim të dispozitave mbi trafikimin me gjithë sistemin ligjor në fuqi. Në të njëjtën kohë, kanë lindur sfida të reja, dhe kanë dalë vështirësi lidhur me goditjen e formave të tjera të trafikimit, lidhur me zbatimin e standardeve më të larta për mbrojtjen e viktimave të miratuara në ligjin Evropian dhe të ratifikuara edhe në sistemin ligjor shqiptar. Ka ardhur koha për një rishikim të vërtetë të këtyre dispozitave në një mënyrë që t'u përgjigjet të gjitha këtyre nevojave të dala në praktikë dhe të kërkuara nga Institucionet Evropiane. Ky Artikull paraqet pikëpamjet e mia mbi këto aspekte si juriste, si pedagoge dhe si ish-Koordinatorë Kombëtarë e Shqipërisë në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

2. KODI PENAL SHQIPTAR DHE PËRPUTHSHMËRIA ME KONVENTËN E PALERMOS TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PROTOKOLLI SHITESË PËR LUFTËN NDAJ TRAFIKIMIT TË GRAVE DHE TË FËMIJËVE

Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar që krijoi bazën për të luftuar Trafikimin e Njerëzve është Konventa e OKB kundër Krimin të Organizuar Transnacional, si dhe dy protokollat e saj shtese të ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8920 dt 11.07.2002. Me ndryshimet e ligjit nr. 9188, datë 12.02.2004 në Kodin Penal janë parashikuar 3 nene për trafikimin.² Ky dokument është i fokusuar tek masat penale që duhet të merren për të luftuar fenomenin në nivel ndërkombëtar.

Instrument tjetër shumë i rëndësishëm që avancoi mënyrën e përqasjes ndaj këtij problemi është Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, ku në qendër të vëmendjes qëndron mbrojtja e viktimave të trafikimit.

Mbi këtë bazë është ndërtuar edhe kuadri ligjor i brendshëm i vendeve që kanë ratifikuar këto dokumente përfshirë edhe Shqipërinë. Po cili është përkufizimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore sipas Konventës së Palermos? Ai parashihet në Nenin 3 të Protokollit 3 të Konventës së Palermos:

a) “Trafik personash” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet.

¹ Komisionere pranë Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, Lektore e së Drejtës Evropiane në UT.

² Nenet 110/a “Trafikimi i personave”; 114/b Trafikimi i femrave dhe neni 128/b “trafikimit i të miturve.

b) Pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin (a) të këtij neni do të jetë i pavend nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a).

c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet "trafik personash" edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

d) "Fëmijë" nënkupton çdo person nën 18 vjeç.

Elementët e Trafikimit të Personave sipas përkufizimit të Protokollit të Palermos ndahen në 3 grupe:

- **Veprimi (aktiviteti, procesi):** rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave;
- **Mjetet:** kërcënim, përdorimi i forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrim, marrjes me forcë, drehisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabel ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve;
- **Format e shfrytëzimit:** shfrytëzimi seksual, për punë ose shërbime të detyruara, skllavëria ose praktikatat e ngjashme me skllavërinë, heqja e organeve ose servitutet.

Tiparet të Trafikimit të personave sipas Legjislacionit të Kombeve të Bashkuara janë të shumfishta: Viktima trafikimi mund të jenë të gjithë: gratë, burrat dhe fëmijët; Trafikimi dhe shfrytëzimi mund të jetë si **transnacional dhe i brendshëm;** Rëndësi të veçantë paraqet **çështja e shfaqjes (deformimit, shtypjes) së vullnetit** të vet për të pranuar për t'u shfrytëzuar; Në rast se provohet se janë përdorur mjetet e shtypjes së vullnetit (detyrim, forcës), **pëlqimi i shprehur nga viktimi për shfrytëzim nuk do të merret parasysh** në gjykimin e veprës së trafikimit; **vet nuk mban përgjegjësi** për veprimet e kryera si viktimë trafikimi, si psh kalimin e paligjshëm të kufirit, mbajtjen e dokumenteve të identitetit të falsifikuar, etj; **Format e shfrytëzimit janë të shumfishta** dhe përfshijnë shfrytëzimin seksual, punën e detyruar, skllavërinë, heqjen e organeve, etj. Lista e formave të shfrytëzimit nuk është shteruese. **Shfrytëzimi i një fëmije konsiderohet trafikim edhe kur nuk vërtetohet një nga mjetet e forcës së parashikuar në paragrafin e parë të nenit 3 të Konventës.**

Pra, mund të themi se, përkufizimi i Trafikimit të Personave sipas Protokollit të Palermos është i gjerë, shpjegues, dhe përmban shumë elementë, duke e bërë edhe pak të komplikuar në interpretim.

Le të citojmë tani përkufizimin e **Kodit Penal Shqiptar për Trafikimin, Nenin 110/a Trafikimi i Personave** për ta parë atë në një vështrim krahasues:³

- *Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrim, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.*
- *Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë.*
- *Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.*
- *Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjeshëm, si dhe me gjobë nga shtatë milionë deri në dhjetë milionë lekë.*

3 Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 1.

- Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Parë në dritë krahasimore me konventën e Palermos, tiparet e Trafikimit sipas Kodit Penal Shqiptar janë⁴: Neni 3 paragrafi (a) (veprimet, mjetet, format e shfrytëzimi); aplikohet një **politikë relativisht e ashpër penale** me sanksione me burgim nga 5-15 vjet dhe në varësi të rrethanave deri edhe burgim i përjetshëm dhe me gjobë nga 2-8 milionë lekë; **nuk parashikohet mbetja e veprës në tentativë** (Kjo do të thotë që edhe në rastin kur nuk ka ndodhur shfrytëzimi i viktimës, vepra penale quhet e konsumuar); dispozitat shqiptare mund të **aplikohen njësoj si për trafikimin transnacional dhe trafikimin e brendshëm**. Në përmbajtjen e dispozitave të Trafikimit të Personave nuk bëhet ndonjë dallim i tillë edhe pse në praktikë ka pasur vështirësi dhe rezistencë të kuptimit të drejtë të Trafikimit të Brendshëm. Kohët e fundit ka një përpjekje sidomos nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për të goditur Trafikimin e Brendshëm duke bërë një interpretim të elementëve të figurës së Trafikimit të Personave me këtë ndarje: rekrutim, zhvendosje, shfrytëzim. Me termin *zhvendosje* nënkuptohet lëvizja e personit nga një zonë (qytet, fshat, zonë periferike apo urbane) në një zonë tjetër atje ku ajo/ai do të shfrytëzohet, si brenda territorit të një vendi edhe përtej kufijve të Shqipërisë.

Por zbatimi me sukses i Ligjit Penal Shqiptar në goditjen e krimit të trafikimit ka hasur në vështirësi pjesërisht për shkak të paplotshmërisë së ligjit, dhe pjesërisht prej praktikës së paharmonizuar siç duhet me atë ndërkombëtare. Më konkretisht disa probleme me ligjin penal janë si vijon:

Edhe pse **përkufizimi i Trafikimit** është marrë nga Neni 3 paragrafi (a) i Konventës së Palermos, ai **nuk është transpozuar në mënyrë të plotë**. Më saktësisht Neni 110/a paragrafi i parë i KP shqiptar përsërit Nenin 3 paragrafin (a) të Konventës, por lë jashtë paragrafët (b) deri në (d) të saj. Në praktikë, kjo ka sjellë probleme të zbatimit me fuqi të plotë të ligjit për trafikimin. Për ilustrim mund të përmend raste të shfrytëzimit të fëmijëve për lypje, ku prokuroria në disa raste, ka hezitur t'i cilësojë këto vepra si trafikim, pasi kërkonte medoemos të provonte detyrimin e fëmijëve nga të tretë për shfrytëzim. Referuar përkufizimit ndërkombëtar, provimi i detyrimit nuk është i nevojshëm për ta cilësuar veprën si trafikim në rastin e shfrytëzimit të fëmijëve. Prandaj **transpozimi i plotë i dispozitës ndërkombëtare në ligjin e brendshëm** do të ishte i nevojshëm në një nen hyrës, pasi sistemi ynë ligjor është pozitivist dhe praktikuesit e ligjit bazohen më shumë në germën e ligjit sesa në diskrecionin e tyre dhe në interpretimin e ligjit ndërkombëtar. Aktualisht, në Kodin Penal Shqiptar kemi **tre nene për trafikimin** respektivisht Nenin 110/a Trafikimi i Njerëzve, Neni 114/b Trafikimi i Femrave dhe Neni 128/a Trafikimi i Fëmijëve. Këto nene kanë përkufizim dhe përmbajtje të njëjtë dhe ndryshojnë vetëm në subjektin që preket, pra respektivisht njerëz, gra, fëmijë. Kjo ka rezultuar në paqartësi në praktikë dhe përsëritje të panevojshme. Për hir të efikasitë juridike do të ishte më mirë që të kishte një **nen të vetëm për trafikimin e qënieve njerëzore**. Parashikimi në **tre nene të veçanta ka krijuar vështirësi në kualifikimin ligjor të veprave penale** dhe përdorimin e termave të ndryshëm. Këtu më shumë probleme ka me nenin 110/a "Trafikimi i personave". Termi "person" i përdorur në këtë nen i referohet çdo individ, qoftë femër apo mashkull, i rritur apo fëmijë. Ndërsa në praktikë, neni 110/a interpretohet duke u zbatuar vetëm në rastet kur viktima është mashkull (i rritur mbi 18 vjeç), sepse rastet e tjera kualifikohen sipas nenit 114/b për femrat (mbi 18 vjeç), dhe nenit 128/b për fëmijët (femër apo mashkull nga 0-18 vjeç).

Gjithashtu mendojmë se është i nevojshëm **një organizim më i mirë i përmbajtjes së nenit** duke përdorur një gjuhë më të thjeshtë, lehtësisht të kuptueshme dhe të pranuar nga zbatuesit e ligjit. Do të ishte më mirë që neni të ndahet në pesë paragrafë (paragrafi i parë të përmbajë një përkufizim të përgjithshëm të veprës penale të trafikimit të personave, paragrafi i dytë elementët e veprës penale, paragrafi i tretë format e shfrytëzimit të trafikimit, paragrafi i katërt sanksionet dhe paragrafi i pestë rrethanat rënduese). Një variant i

4 Në përgjithësi ruhen tre elementët e parashikuar si në Konventën e Protokollit të Palermos.

mundshëm për paragrafin e parë mund të ishte: - “Trafikimi i personave është krim i rëndë kundër personit, dhunim i rëndë i të drejtave themelore të njeriut, moralit dhe dinjitetit. Trafikimi i personave përfshin trafikimin e burrave, grave, dhe fëmijëve nga 0-18 vjeç” (për paragrafët e tjerë elementët janë në variantin ekzistues të nenit 110/a por duhet bërë një riorganizim sipas paragrafëve të listuar më sipër duke shtuar si rrethanë rënduese edhe trafikimin e femrave dhe fëmijëve).

Për këto nene duhen **standardizuar edhe termat dhe elementët e përdorur në përmbajtjen e neneve për trafikimin**, pasi në Kod nuk ka një përkufizim të qartë për to. Në përgjithësi, edhe nga zbatuesit e ligjit në praktikë janë hasur vështirësi në kuptimin dhe interpretimin e elementëve të veprës penale të trafikimit. Edhe raporti i GRETA,⁵ sugjeron që të rishikohen dhe qartësohet interpretimi i disa termave si “fshehja”, “mashtrimi”, “përfitimi nga gjendja shoqërore”, “vënia në përdorim ose transplantimi i organeve” etj.⁶ Qartësimi i termave dhe koncepteve të përdorura në Kod Penal do të na ndihmonte për të standardizuar edhe termin e saktë që duhet të përdorimin për vetë fenomenin, problem i krijuar edhe për shkak të vështirësive në përkthimin dhe kuptimin e termave të tillë si: *trafikimi i qënieve njerëzore, trafikimi i personave, trafikimi në njerëz* etj. Mendoj se sot eksiton eksperiencia e mjaftueshme në praktikë për të rënë dakord mbi përkufizime të reja të përbashkëta.

Neni 114/b në praktikë ngatërrohet shpesh me nenin 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”. Kjo pasi Kodi ynë Penal ka kaluar mjaft rishikime për të trajtuar krime në periudha të ndryshme. Nenet për trafikimin kanë ardhur më pas në kod se ato mbi ushtrimin apo shfrytëzimin e prostitucionit. Për kushtet e sotme të zhvillimit të sistemit ligjor botëror dhe vendas mendoj se, sot elementet e shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese përhithen prej trafikimit të personave. Për të shmangur këtë paqartësi ne mendojmë që **neni 114/a duhet shfuqizuar pasi parashikohet në nenin 114/b “Trafikimi i Femrave”** me synim mbrojtjen më të mirë të viktimave të trafikimit dhe bashkëpunimin e tyre me drejtësinë. Vështirësitë qëndrojnë në elementët e përbashkët që kanë këto vepra penale dhe në faktin se shfrytëzimi seksual është një ndër format më të njohura të trafikimit në Shqipëri. Raporti i GRETA-s,⁷ përmend në raportin e saj mbi Shqipërinë, Dhjetor 2011, edhe faktin se sanksionet për të dy nenet janë pak a shumë të ngjashme për sa i përket dënimit me burgim, por në rastin e nenit 114/a mungon dënimi me gjobë. Moskualifikimi i drejtë ligjor i veprave penale krijon pasoja të pariparueshme për të dëmtuarit, në veçanti për viktimat e trafikimit. Edhe Raporti i GRETA-s citon se ka një konfuzion në kuptimin e këtyre dy neneve.⁸

Lidhur me **sanksionet** e aplikuara për veprën penale të Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Raporti i GRETA-s (Paragrafi 154) nënvizon se **minimumi prej 5 vjetësh burg duket jo bindës**, prandaj duhet rishikuar edhe ky element duke hapur diskutimin për **rritjen e minimumit të dënimit me burgim**. Marzhi i madh, që ligji i lë për të vendosur prokurorit dhe gjyqtarit, krijon mundësi për vlerësime dhe praktika të ndryshme për situata të njëjta dhe për një zbatim jo të duhur të ligjit.

Lidhur me **rrethanat rënduese**, Raporti i GRETA-s konstaton se një nga rrethanat rënduese të parashikuara në nenin 24 paragrafi (a) të Konventës së KE-së “vepra penale e kryer me dashje ose nga pakujdesia flagrante ka rrezikuar jetën e viktimës” nuk është parashikuar shprehimisht as në nenet e trafikimit as në nenin 50 të KP ku listohen rrethanat rënduese për krimet në përgjithësi.⁹ Për këtë qëllim sugjerojmë që kjo rrethanë rënduese të shtohet si pikë më vete në nenin 50 të KP, për të mos e rënduar më tepër përmbajtjen e nenit për trafikimin.

5 Grupi i Ekspertëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Goditjen e Trafikimit.

6 Për më shumë informacion shiko Raportin e GRETA-s - paragrafët 48 – 52.

7 Grupi i Ekspertëve të Konventës së KE që mbikëqyr Konventën e KiE për Trafikimin të 2005-ës.

8 Për më shumë informacion shiko paragrafët 51, 157, 158 dhe rekomandimin nr. 20.

9 Shih paragrafin 156 të Raportit të GRETA-s.

3. KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR MASAT KUNDËR TRAFIKIMIT DHE STANDARDET E REJA TË KËRKUARA TEK NE

Pse lindi nevoja për Konventën e Këshillit të Evropës për të goditur Trafikimin e Qënieve Njerëzore? Vendet e origjinës, transitit dhe destinacionit duhet të ndërtonin një politikë të përbashkët kundër trafikimit. Instrumentet ekzistues ndërkombëtare përfshi edhe Konventën e Palermos prekin vetëm aspektin penal të fenomenit. Konventa e KiE synon një përjasje më të gjerë: parandalim, mbrojtje e viktimave, ndjekje penale për trafikantët, bashkëpunim ndërkombëtar. Konventa ngre në një shkallë shumë më të lartë mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe garantimin e të drejtave të tyre ligjore. Edhe në këtë Konventë, trafikimi shihet në disa forma: trafikim i brendshëm dhe trafikim ndërkufitar, i lidhur apo jo me krimin e organizuar; viktimat mund të jenë meshkuj, femra ose fëmijë, për të gjitha format e shfrytëzimit përfshi lypjen dhe punën e detyruar.

Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës me Ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”.

Ia vlen të shohim përkufizimin e trafikimit që përmban kjo Konventë: *“Trafikim i qënieve njerëzore” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.”* Në tërësi, përkufizimi pasqyron atë të Konventës së Palermos si edhe përputhet me Përkufizimin e Ligjit Shqiptar. Ka një **element shtesë** tek mjetet e përdorura që është **shpërdorimi i detyrës** si mjet për të bindur apo nënshtuar viktimën e trafikimit të shfrytëzohet. Ky element synon të kapë fajësinë e zyrtarëve të përfshirë në ndihmën apo organizimin e Trafikimit në vende të ndryshme.

Lidhur me Kontributet e Konventës në tërësi mund të thuhet se Asnjë instrument ndërkombëtar i mëparshëm nuk jep **përcaktimin e viktimës** së trafikimit dhe të **formave të mbrojtjes** dhe asistencës që duhet të marrë ai/ajo: *Viktimë do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të personave, siç përcaktohet në këtë Konventë.* Përcaktimi është relativisht i gjerë me synimin që t’i lënë fushë veprimi për zbatim të lartë gjykatave kombëtare. Duhet theksuar po ashtu, se asnjë instrument i mëparshëm nuk i jep **përparësi themelore respektit për të drejtat e viktimave**, mbrojtjes dhe asistencës së tyre. Pra, mund të thuhet se në këtë dokument mund të vihet re një qasje sipas të drejtave themelore të viktimës dhe jo një qasje formale penaliste me synim kapjen dhe ndëshkimin e trafikantëve.

Masat që shtetet palë duhet të marrin **përfshijnë**: parandalimin, mbrojtjen dhe asistencën e Viktimave të Trafikimit, plotësimin dhe standardizimin e ligjit penal dhe të Procedurës Penale për këto raste, si edhe ngre Mekanizma Monitorues për zbatimin. Konkretisht **parandalimi** do të bëhet përmes: fushatave ndërgjegjësuese dhe informuese, programeve të zhvillimit për shtresat vunerabël në rrezik shfrytëzimi, masave parandaluese për uljen e kërkesës për shërbime nga viktimat e trafikimit si edhe kontrollit më të mirë kufitar për të identifikuar rastet gjatë kalimeve në kufi.

Konventa përshkruan gjerësisht si duhet të kryhet procesi i identifikimit, llojet asistencës që viktima mund të marrë, përcakton periudhën e rikuperimit dhe të reflektimit, dhënien e lejes së qëndrimit për viktimat e huaja të trafikimit, të drejtat për kompensimin, riatdhësimin e asistuar dhe marrjen e masave të veçanta nga autoritetet për viktimat gra dhe fëmijë të trafikimit. Në këtë kuadër, stafi që merret me identifikimin apo me hetimin dhe asistencën, kërkohet të jetë i specializuar dhe i trajnuar për raste dhe procedura të konsoliduar. Në këtë drejtim duhet thënë se përveç urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe të Ministrisë të Brendshme, së fundi miratimi në 2011 i Procedurave Standarde të Veprimit, ka krijuar një

kuadër të parashikueshëm në këtë drejtim. Për viktimat e huaja të trafikimit ndalohet kthimi i tyre dhe përkundrazi lëshimi i **lejes së qëndrimit** dhe asistenca e nevojshme duhet të ofrohet mbi bazën se është viktimë. Zbatimi i këtij detyrimi do të vendoste një standard më të lartë të trajtimit sidomos në vendet kryesore të destinacionit që janë vende evropiane. Asistenca për t'iu dhënë viktimave duhet të jetë e plotë. Ajo duhet t'i çojë ato drejt integritetit të plotë psikologjik, emocional, dhe shoqëror. Periudha e rikuperimit është vendosur të jetë e paktën 30 ditë. Ky është kufiri minimal brenda të cilit lëshohet leja e qëndrimit dhe ofrohet asistenca në vendin pritës. Jashtë këtij kufiri, viktimat duhet të bashkëpunojë me drejtësinë për të marrë në vijim përfitimin e qëndrimit dhe të asistencës. Mendohet se presioni i vendeve të destinacionit ka qenë i madh në këtë kuadër për të ulur kohëzgjatjen e sugjeruar të lejes së qëndrimit në vetëm 30 ditë. Megjithatë Konventa shërben si nivel minimal i mbrojtjes. Nëse shtetet duan të adoptojnë një nivel më të lartë, ata mund ta zgjasin kohën e leje qëndrimit në ligjin e tyre të brendshëm. Gjatë leje qëndrimit personi merr të gjithë asistencën e nevojshme. Konventa i parashihet të dyja mundësitë për lëshimin e leje qëndrimit si atëherë kur viktimat bashkëpunon me autoritetet apo atëherë kur vlerësohet e nevojshme si rezultat i situatës në të cilën ndodhet viktimat.

Viktimat kanë të drejtën për **ndihme ligjore falas** si edhe mjete efektive për **kompensim**. Lidhur me kuadrin ligjor shqiptar, sot është tërësisht e mundur që një pjesë e mirë e rasteve të viktimave të merren përsipër nga Agjencia e Ndhmë Ligjore Shtetërore, për të cilët gratë dhe fëmijët në procese gjyqësore duhet të jenë një prioritet. Por **lehtësimi i eksedit në drejtësi për viktimat e trafikimit** është më shumë se kaq. Legjislacioni për taksat dhe tatimet në RSH parashikon një sërë detyrimesh për palët që marrin pjesë në proces. Këto detyrime kanë krijuar probleme dhe pengesa edhe për eksedin e viktimave të trafikimit në drejtësi dhe për këtë kërkohet që të përmirësohen aktet e mëposhtme:

Tarifa për shërbimin e administratës gjyqësore në vlerën 12.000 lekë;¹⁰

- Viktimat duhet të paguajnë **tarifën prej 1 % të vlerës së objektit të padisë dhe 3 % të vlerës për ekzekutimin e vendimit**.¹¹

Unë propozoj heqjen dhe eliminimin e këtyre tarifave dhe detyrimeve të lidhura me kryerjen e proceseve gjyqësore që përbëjnë një barrë të panevojshme që deri më sot është përballuar më së shumti nga OJF-të që ofrojnë përfaqësimin ligjor falas për viktimat.

Lidhur me të drejtën e **kompensimit** në Shqipëri, duhet thënë se kjo mbetet ende një e drejtë perspektive për t'u realizuar. Mundësi për realizimin e kësaj të drejte aktualisht ekzistojnë në kuadrin e ngritjes së fondit për luftën ndaj kriminalitetit të ngritur sipas Ligjit Antimafia, ku ky është një nga qëllimet për të cilat ai mund të përdoret. Aktualisht e drejta e kompensimit mund të trajtohet vetëm si një kërkesë civile në një proces penal, ku zakonisht gjyqtarët e referojnë atë nga Gjykata e Krimeve të Rënda, ku gjykohet trafikimi në Gjykatën e Rrethit. Kjo e vështirëson realizimin pasi kështu viktimat duhet të ndjekë njëkohësisht dy procese, një penal dhe një civil. Mundësia për t'i trajtuar të dyja në të njëjtin proces, do t'i rriste shanset e viktimave të Trafikimit për sukses. Deri më sot kemi vetëm një vendim civil të marrë në Gjykatën e Tiranës në 2011 për dhënie kompensimi një viktime trafikimit, ku ajo përfitoi një vlerë prej 4 milionë lekë të reja si kompensim për dëmin e shkaktuar asaj. Është e qartë se shtetet nuk e kanë të lehtë të zgjidhin këtë çështje, por ajo që kërkohet është që ata të ofrojnë alternativa dhe mundësi. Pra, në drejtim të sigurimit të instrumenteve efektiv për **kompensimin e viktimës së trafikimit** ka nevojë për përmirësime ligjore. Krahas krijimit të një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të trafikimit duhen ndryshuar dhe plotësuar edhe dispozitat e K.Pr.P për ngritjen e padisë civile në procesin penal dhe gjykimin e saj brenda këtij procesi. Ky është edhe rasti i vetëm ku, sipas K.Pr.P nenet 58-68, viktimat e trafikimit mund të marrë pjesë si palë në proces, nëpërmjet padisë civile në procesin penal, për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit. Për çështjen e kompensimit të viktimave të trafikimit, Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe

¹⁰ Udhëzimi nr.13/2009 i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë.

¹¹ Ligji 8977/2002, Lidhja 5 "Për sistemin e Taksave në RSH".

Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.¹² Megjithatë, mbetem e mendimit se krahas skemës shtetërore të kompensimit, zgjidhja më e drejtë dhe më efikase do të ishte **gjykimi i padisë civile brenda procesit penal** dhe për këtë sugjerojmë që rregullimi të bëhet në K.Pr.P.

Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011 (paragrafi 13 dhe neni 17) rekomandojnë dhe inkurajojnë përdorimin e asetëve të konfiskuara për mbështetjen e viktimës së trafikimit për mbrojtje përfshirë edhe kompensimin. Lidhur me kompensimin e viktimave të trafikimit ka disa eksperiencia pozitive edhe në vendet e BE-së si p.sh. Austria - Pas një studimi të zhvilluar për këtë çështje në nëntor 2010 është miratuar një paketë e ligjore “Criminal Law Competence Package”, e cila ka për qëllim zbatimin e urdhrave të për konfiskimin e asetëve dhe kompensimin e viktimave të trafikimit. Në vitin 2011, Ministria e Drejtësisë e Austrisë ka angazhuar disa Prokurorë të veçantë për çështjet e konfiskimit të asetëve të përfituara nga veprat e trafikimit me qëllim përdorimin e tyre edhe për kompensimin e viktimave të trafikimit.

Lidhur me **riatdhësimin** duhet thënë se, që të kryhet riatdhësimi, vendi i origjinës duhet të pranojë kthimin e viktimës duke siguruar në të njëjtën kohë kushte të përshtatshme për kthim dhe kthimi i fëmijës bëhet vetëm në rastet kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës, pra nuk mund të kthehet një fëmijë në një ambient apo në një familje që e viktimizoi atë.

Lidhur me **plotësimet në Kodin Penal** dhe në Procedurën Penale, Konventa parasheh disa standarde të reja. Ato kanë të bëjnë me aspekte të cilat ne i kemi injoruar apo quajtur të tepërta deri më sot. Konkretisht, Konventa kërkon kriminalizimin e fenomenit të trafikimit; penalizmin e personave që përdorin shërbimet e viktimave; dispozita që sigurojnë mos ndëshkueshmërinë e viktimave; mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë; autoritete të specializuara; procedura gjyqësore të cilat sigurojnë mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së viktimës. Kërkesa për reformën tonë ligjore pra janë këto:

Duhet ndryshuar KP ose shtuar **një nen për përjashtimin nga përgjegjësia** penale të viktimave të trafikimit për veprime të paligjshme, të cilat ato mund t’i kenë kryer si gjatë shfrytëzimit të tyre si viktimë trafikimi. Neni 307 i KP, paragrafi parë, i ngarkon me përgjegjësi penale personat që refuzojnë për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth dënjësive për kryerjen e një vepre penale. Edhe në paragrafin e tretë të këtij neni nuk del qartë se cilat janë arsyet e ligjshme që e përjashtojnë një person nga kërkesa për të dhënë informacion, dhe/apo për të dëshmuar. Për të zgjidhur këtë situatë, sugjeroj që në nenin 307 të shtohet një paragraf ku të listohen arsyet e ligjshme për përjashtimin nga përgjegjësia penale të personave që kanë dënjësi për veprën penale, duke e shprehur më vete edhe rastin kur personi është viktimë e trafikimit apo viktimë e krimit në përgjithësi (këtu mund të përfshihen të gjitha ato vepra që ndiqen kryesisht). Për më tepër, viktimat e trafikimit për shkak të pozitës së tyre si viktimë mund të detyrohen të kryejnë edhe vepra të tjera penale si: kalimi i paligjshëm i kufirit, falsifikimi i dokumenteve, përfshirje në veprimtari kriminale (shitje të lëndëve narkotike, vjedhje deri edhe vrasje). Prandaj sugjeroj që në KP të shtohet një dispozitë e veçantë në të cilën të parashikohet përjashtimi nga përgjegjësia penale i viktimave të trafikimit për të gjitha krimet apo kundërvajtjet e kryera si viktimë trafikimi¹³. Edhe pse në praktikë asnjë viktimë trafikimi nuk është dënuar penalisht në një proces me këtë qëllim në Shqipëri. Mungesa e përcaktimit në ligj krijon kushtet që një ndëshkim i tillë të ndodh. Duhet parashikuar dispozita të veçanta në KP për **kriminalizimin e përdorimit të shërbimeve** që janë objekt i shfrytëzimit, me dënjësi që personi nga i cili po merren shërbimet është viktimë e trafikimit.¹⁴

Duhet parashikuar **dispozita të veçanta** për vepra penale që kanë të bëjnë me **falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit ose identitetit**, marrjen në zotërim ose sigurimin e këtij dokumenti, mbajtjen, heqjen, fshehjen, dëmtimin ose shkatërrimin e dokumentit të udhëtimit apo identitetit të një personi tjetër me qëllim trafikimin e qënieve njerëzore.¹⁵ Kjo dmth se trafikantët duhet të dënohen jo vetëm për organizimin dhe kryerjen e trafikimit por edhe për shkeljet e tjera që shoqërojnë shfrytëzimin.

12 Raporti i GRETA-s paragrafët 171, 172, 174, 128 dhe rekomandimi nr. 17.

13 Raporti i GRETA-s – paragrafi 162, 163, 164, 165 dhe rekomandimi nr. 24 referuar nenit 26 të Konventës së KE-së “Dispozita e Mosdënjimit”.

14 Raporti i GRETA-s – Paragrafi 152, 159 dhe rekomandimi nr. 21 referuar nenit 19 të Konventës së KE-së.

15 Raporti i GRETA-s – Paragrafi 152, 160 dhe rekomandimi nr. 22 referuar nenit 20 të Konventës së KE-së.

Duhet të ndërmerret iniciativa ligjore për **ndryshimin e nenit 6/2 të Kodit Penal dhe riformulimin e nenit 7 të K.Pr.P.**, nën këndvështrimin e nenit 4 të Protokollit të 7, të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sipas të cilit: *“Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht, nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një veprë për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar...”*¹⁶

Duhen rishikuar dhe qartësuar edhe **dispozitat për penalizmin e shfrytëzimit për punë**. Nga raporti i GRETA-s ngrihet shqetësimi për faktin se në praktikën shqiptare nuk ka asnjë rast kur një subjekt (person fizik apo juridik) të jetë proceduar apo dënuar penalisht për raste të shfrytëzimit për punë.

Lidhur me **plotësimet në Kodin Penal** dhe në Procedurën Penale, Konventa parasheh disa standarde të reja. Ato kanë të bëjnë me aspekte të cilat ne i kemi injoruar apo quajtur të tepërta deri më sot. Konkretisht, Konventa kërkon kriminalizimin e fenomenit të trafikimit; penalizmin e personave që përdorin shërbimet e viktimave; dispozita që sigurojnë mos ndëshkueshmërinë e viktimave; mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë; autoritete të specializuara; procedura gjyqësore të cilat sigurojnë mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së viktimës. Kërkesa për reformën tone ligjore pra, janë këto:

Duhet ndryshuar Kodi Penal ose shtuar **një nen për përjashtimin nga përgjegjësia penale** të viktimave të trafikimit për veprime të paligjshme, të cilat ato mund t'i kenë kryer si gjatë shfrytëzimit të tyre si viktimë trafikimi. Neni 307 i KP, paragrafi parë, i ngarkon me përgjegjësi penale personat që refuzojnë për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth dënjësive për kryerjen e një veprë penale. Edhe në paragrafin e tretë të këtij neni nuk del qartë se cilat janë arsyet e ligjshme që e përjashtojnë një person nga kërkesa për të dhënë informacion, dhe/apo për të dëshmuar. Për të zgjidhur këtë situatë, sugjeroj që në nenin 307 të shtohet një paragraf ku të listohen arsyet e ligjshme për përjashtimin nga përgjegjësia penale të personave që kanë dënjë për veprën penale, duke e shprehur më vete edhe rastin kur personi është viktimë e trafikimit apo viktimë e krimit në përgjithësi (këtu mund të përfshihen të gjitha ato vepra që ndiqen kryesisht). Për më tepër, viktimat e trafikimit për shkak të pozitës së tyre si viktimë mund të detyrohen të kryejnë edhe vepra të tjera penale si: kalimi i paligjshëm i kufirit, falsifikimi i dokumenteve, përfshirje në veprimtari kriminale (shitje të lëndëve narkotike, vjedhje deri edhe vrasje). Prandaj sugjeroj që, në KP të shtohet një dispozitë e veçantë në të cilën të parashikohet përjashtimi nga përgjegjësia penale i viktimave të trafikimit për të gjitha krimet apo kundërvajtjet e kryera si viktimë trafikimi.¹⁷ Edhe pse në praktikë asnjë viktimë trafikimi nuk është dënuar penalisht në një proces me këtë cilësi në Shqipëri, mungesa e përcaktimit në ligj krijon kushtet që një ndëshkim i tillë të ndodh.

Mungojnë parashikime të qarta në K.Pr.P për **dhënien e ndihmës dhe asistencës për viktimat e trafikimit në mënyrë të pakushtëzuar**. Në praktikë kjo është zgjidhur duke iu referuar direkt akteve ndërkombëtare ose me instrumente të tjera si: në Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit (MKR) dhe së fundi edhe me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/viktimave të Mundshme të Trafikimit”. Megjithatë, mendojmë se një rregullim i tillë duhet të bëhet me një dispozitë edhe në K.Pr.P.

Sipas rekomandimeve të GJKR (raporti i ZKKA maj 2009) duhet të ndryshohet K.Pr.P., përkatësisht neni 158 të K.Pr.P. Nga praktika gjyqësore është konstatuar se, në kushtet kur viktimat e trafikimit janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale, organet e zbatimit të ligjit, në përgjithësi, nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P. Por në të vërtetë, në mënyrën se si është aktualisht e formuluar dispozita e mësipërme krijon paqartësi lidhur me **të drejtën e të dëmtuarve për të mos dhënë deklaramë** në fazën e hetimeve paraprake apo dëshmi gjatë gjykimit, në rastet kur deklarojnë se kanë bashkëjetuar apo kanë lidhur martesë me tutorët e tyre.

¹⁶ Rekomandimet e GJKR - Raporti i ZKKA maj 2009.

¹⁷ Raporti i GRETA-s – paragrafi 162, 163, 164, 165 dhe rekomandimi nr. 24 referuar nenit 26 të Konventës së KE-së “Dispozita e Mosdënjimit”.

Konventa i detyron palët për bashkëpunim ndërshtetëror në të gjitha aspektet e luftës ndaj trafikimit. Konventa ngre GRETA-n,¹⁸ e cila ka vlerësuar Shqipërinë nga fillim i vitit 2011 e deri në publikimin e rekomandimeve dhe konkluzioneve për Shqipërinë në Dhjetor 2011. Në përfundim, GRETA për Shqipërinë ka rekomanduar: Fushata ndërgjegjësuese mbi barazinë gjinore dhe mosdikriminimin; Rritjen e aksesit në punë dhe arsimimin për grupet vulnerabël; Rritjen e masave afatgjata në luftë kundër varfërisë, diskriminimit dhe marginalizimit; Identifikimin e viktimave të trafikimit meshkuj, të huaj dhe viktimave të trafikimit të brendshëm; Të jetë e garantuar me ligj mosndëshkueshmëria e viktimave të trafikimit; Asistenca e garantuar me ligj, të garantohet plotësisht edhe në praktikë; Mbështetje për organizatat jo shtetërore që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit; Të sigurohet që viktimat të përfitojnë nga e drejta për kompensim; Të sigurohet mbrojtja për viktimat e trafikimit pavarësisht vullnetit për të bashkëpunuar me autoritetet e drejtësisë; Të sigurohet zbatimi i legjislacionit që lidhet me konfiskimin e aseteve që burojnë nga vepra e trafikimit; Masa për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të meshkujve; Përfshirje më intensive e autoriteteve lokale në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave; Përmirësim të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave mbi arrestimet, ndjekjet penale dhe dënimet e trafikimit të personave dhe situatës së viktimave në proceset gjyqësore; Realizimin e studimeve serioze mbi shkaqet, tendencat dhe treguesit e trafikimit.

4. PËRFUNDIME

Mund të thuhet se Ligji Penal Shqiptar dhe në përgjithësi kuadri i ndërtuar për të parandaluar dhe goditur trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat e trafikimit, është në frymën e parimeve ligjore ndërkombëtare.

Megjithatë, ligji shqiptar ka nevojë për përmirësime që të vijë, qoftë në përputhje me germën e ligjit ndërkombëtar, qoftë për të kapur standardet e reja të kërkuara. Legjislacioni është një krijesë e gjallë, e cila duhet t'u përgjigjet nevojave të kohës. Mos-Transpozimi i duhur i dispozitave ndërkombëtare në ligjin e brendshëm (si psh marrja vetëm e pjesës dhe përcaktimit të Trafikimit në Nenin 110/a të Kodit Penal Shqiptar) si edhe sistemi i ngurtë pozitivist i drejtësisë ku germa e ligjit kombëtar përbën bazën e një dënimi më shumë se sa fryma e ligjit ndërkombëtar, kanë sjellë zbatimin e paplotë dhe disa herë të pasaktë të ligjit për trafikimin në vend.

Rishkrimi i të paktën dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me trafikimin, të cituara më lart, është një detyrim për hartuesit e ligjit, të kërkuar nga praktika shqiptare dhe nga standardet e reja ndërkombëtare të marra përsipër nga Shqipëria mbi këtë çështje.

Së fundi dhe jo më pak e rëndësishme, nuk duhet të harrojmë rolin e praktikës gjyqësore ndërkombëtare. Ka plot vend që gjyqtarët tanë sot të shohin vendime të Gjykatave Ndërkombëtare mbi çështjet e trafikimit, si psh, të Gjykatës së Strasburgut, e cila me sukses vitet e fundit dhe në mënyrë të përsëritur ka marrë vendime historike për goditjen e trafikimit. Kështu në çështjen *Rantsev v. Cyprus and Russia* vendim i 7 Janarit 2008 dhe *Siliadin v. Francë* vendim Nr. 73316/01 i vitit 2005 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zbatuar Nenin 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi ndalimin e skllavërisë dhe të punës së detyruar si bazë për të goditur dy raste trafikimi: një për shfrytëzim seksual me pasojë vdekjen e viktimës dhe një tjetër ku viktimat shfrytëzohej për punë të detyruar në shërbime shtëpiake në Francë. Ky do të ishte një shembull i aplikimit me vendosmëri, por edhe në mënyrë të gjerë të ligjeve për trafikimin. Nuk duhen harruar as ligjet e BE-së në këtë drejtim si Karta e BE-së për të Drejtat Themelore, që ndalon shprehimisht trafikimin si një formë skllavërie dhe Direktiva 2011/36/BE botuar më 5 Prill 2011, duke pasur parasysh rëndësinë aktuale që merr integrimi evropian edhe në rrafshin juridik.

¹⁸ Grup i pavarur ekspertësh që mbikëqyrin mbi bazë inspektimesh zbatimin e saj nga palët.

As ligji për trafikimin dhe as jurisprudenca shqiptare nuk janë ishuj të izoluar në Legjislacionin Penal Shqiptar apo Ndërkombëtar. Ato duhen parë dhe duhen lidhur detyrimisht me nenet e tjera të luftës ndaj Krimit të Organizuar si edhe me legjislacionin dhe praktikën ndërkombëtare në përgjithësi. Vetëm kështu ligji do të sillte efektet që priten prej tij në rrafshin e brendshëm si edhe do të lëshonte ato sinjale stimuluuese të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërshtetëror, për të cilat kemi nevojë për të bërë kthesën. Mundësia dhe kapacitetet ekzistojnë. Duhet vetëm të dëgjojmë dhe përfshijmë njëri-tjetrin.

BIBLIOGRAFIA:

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Protokollin i Dytë mbi Goditjen, Shtypjen dhe Parandalimin e Trafikimit të Grave dhe të Fëmijëve, 2000;
2. Konventa e Këshillit të Evropës “Mbi Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerzore”, 2005;
3. Konventa e Këshillit të Evropës mbi Liritë dhe e Drejtat Themelore të Njeriut, 1950;
4. Raporti i GRETA-s (Grupi i Ekspertëve të pavarur të ngarkuar me Monitorimin e Zbatimit të Konventës së KE-së të 2005) për Shqipërinë botuar në Dhjetor 2011;
5. Kushtetuta Shqiptare, 1998;
6. Karta e BE për të Drejtat Themelore, 2000;
7. Direktiva 2011/36/BE botuar më 5 Prill 2011;
8. Kodi Penal Shqiptar, 2002;
9. Kodi i Procedurës Penale Shqiptare;
10. Koca Arqilea, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, “Një analizë krahasuese e ligjit dhe procedurës mbi Trafikimin e Njerzve”, Konica 2006;
11. Raportet Vjetore të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Shqiptar të vitit 2010, 2011 tek www.moi.gov.al/njësiaantitrafik;
12. Raporti mbi Trafikimin e Qenieve Njerzore të Departamentit Amerikan të Shtetit për Shqipërinë 2010, 2011;
13. Raport Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2010, 2011 <http://www.mie.gov.al/>
14. Ligji Nr. 10192, date 3.12.2009 “Mbi parandalimin dhe Luftën e Krimit të Organizuar”;
15. Vendimi Nr.1202 date 19.02.2010 i Gjykatës së Rrethit Tiranë në <http://www.gjykatatirana.gov.al/>
16. Çështja Rantsev v. Cyprus and Russia Vendim i 7 Janarit 2008 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
17. Çështja Siliadin v. Francë (Vendimi Nr. 73316/01) 2005.

Dr. Luan Hasneziri¹

HYRJE

Vepra penale e “*Trafikimit të personave*”, është një nga veprat që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, në ditët e sotme dhe për pasojë, analiza e saktë juridike i kësaj vepre penale, përbën një çështje të rëndësishme për të gjithë gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë. Rrezikshmëria e madhe e kësaj vepre penale, rezulton jo vetëm nga sanksionet e ashpra që ligji ka parashikuar për këtë veprë, të cilat fillojnë nga minimumi shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe përfundojnë me burgim të përjetshëm, kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, por, edhe nga përhapja e kësaj vepre dhe karakteri thellësisht i papranueshëm i kësaj vepre nga shoqëria njerëzore në tërësi dhe nga shoqëria shqiptare në veçanti.

Nuk është e rastit që kjo veprë nga shumë juristë, sociologë dhe profesionistë që kanë lidhje me të drejtën, është konsideruar edhe si një nga format e skllavërisë moderne, dhe realisht kjo veprë përbën një formë të skllavërisë moderne, dhe për mendimin tim, një nga format më të shëmtuara të saj, prandaj, kuptimi i drejtë i kësaj vepre penale dhe ndëshkimi i merituar i autorëve që e kryejnë këtë veprë, është një nga detyrat e çdo shoqërie humane.

Duke u nisur nga fakti se, vepra penale e “*Trafikimit të personave*”, paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe duke u nisur nga fakti se, kjo veprë është një veprë penale e re, që nuk është njohur më parë në praktikën gjyqësore shqiptare, në praktikën e punës së organeve të drejtësisë, janë hasur probleme, në lidhje me kuptimin e drejtë juridiko-penal të kësaj vepre penale. Është kjo arsyeja pse kjo temë u zgjodh nga ana ime, qëllimi i së cilës është që të analizojë, nga ana formale juridike, elementët e veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, si dhe të ndalet më në veçanti tek problemet që ka hasur praktika gjyqësore, në lidhje me kuptimin e drejtë juridik të kësaj vepre penale.

Tema e mësipërme, do të përbëhet nga dy çështje kryesore; në çështjen e parë, do të trajtohen, në mënyrë të përmbledhur, veçoritë specifike që paraqet vepra penale e “*Trafikimit të personave*”, në legjislacionin tonë penal, ndërsa në çështjen e dytë, e cila përbën edhe çështjen kryesore të kësaj teme, do të ndalemi tek analiza juridiko-penale e kësaj vepre, si dhe në vështirësitë praktike që kanë lindur në kuptimin e drejtë të saj.

Në fund të temës, ashtu si çdo punim tjetër, do të jepem edhe disa konkluzione dhe do të pasqyrohet edhe bibliografia ku është bazuar ky punim, duke shpresuar që, kjo temë, të hapë debatin ndërmjet juristëve në lidhje me kuptimin e drejtë të kësaj vepre penale.

1. VEÇORITË E VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE NË LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR

Vepra penale e “*Trafikimit të personave*”, në Shqipëri, paraqet një sërë specifikash, të cilat mendoj se duhet të trajtohen në këtë temë, sepse në këtë mënyrë, do të mund të kuptohet më mirë natyra dhe elementët e

¹ Kjo temë është përgatitur nga Dr. Luan Hasneziri, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

kësaj veprë penale. Si *veçori të parë*, në lidhje me këtë veprë penale, për vendin tonë, do të përmendja faktin se, kjo veprë penale, është një veprë penale e re, e cila nuk ka ekzistuar në Kodet tona Penale të mëparshme, të para viteve 90-të të shekullit të kaluar, kjo për faktin se fenomeni i trafikimit të personave, për vetë kushtet e izolimit total të vendit tonë, në atë periudhë, jo vetëm nuk ekzistonte, por, ishte edhe i pakonceptueshëm nga gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë.

Jo vetëm aq, por, vepra penale e *"Trafikimit të personave"*, çuditërisht nuk u parashikua si e tillë as nga Kodi Penal, i ri, i cili hyri në fuqi më 1 qershor të vitit 1995, pavarësisht nga fakti se, fenomeni i trafikimit të personave, për periudhën e pas viteve 1991-1992, e deri me miratimin e Kodit të ri Penal, të vitit 1995, ishte bërë një fenomen shqetësues, për një pjesë të mirë të shoqërisë shqiptare. Por, në qoftë se mosparashikimi i veprës penale të mësipërme, nga ana e ligjvënësit në Kodin e ri Penal të vitit 1995, mund të justifikohet deri në një farë mase, me mungesën e përvojës dhe eksperiencës në këtë fushë, ajo që nuk mund të justifikohet për asnjë arsye është fakti se, pse ligjvënësit, iu deshën edhe plot gjashtë vite të tjera, pasi ishte miratuar Kodi i ri Penal, që ta parashikonte për herë të parë këtë veprë penale, konkretisht në vitin 2001, me ligjin nr 8733, datë 24.01.2001.

Ky fakt, i tillë bëhet akoma më i papranueshëm në kushtet kur fenomeni trafikimit të personave dhe më posaçërisht, i trafikimit të femrave për qëllime prostitucioni, ishte bërë një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë shqiptare dhe ku Shqipëria prej shumë kohësh, po etiketohej, me të drejtë, nga kancelaritë evropiane, si një nga vendet kryesore të origjinës dhe të transitit, të trafikimit të qenieve njerëzore, në Ballkan dhe më gjerë.

Më në fund, pas kalimit të një periudhë prej rreth dhjetë vitesh, nga koha kur lindi në shoqërinë shqiptare, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore dhe pas kalimit të pesë viteve nga miratimi i Kodit të ri Penal, dhe në kohën kur trafikimi i qenieve njerëzore u bë një fenomen tepër shqetësues për shoqërinë shqiptare, ligjvënësi shqiptar, e pa të arsyeshme që të parashikoj në Kodin Penal, në vitin 2001, me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, veprën penale të trafikimit të personave, duke e shtuar në Kodin Penal ekzistues, me nenin 110/a të tij, me titullin *"Trafikimi i njerëzve"*, veprë e cila do të ndryshohet më vonë, me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004, ku do të ndryshohej dhe titulli i dispozitës nga *"Trafikimi i njerëzve"* në *"Trafikimi i personave"*.

Veçoria e dytë, në lidhje me këtë veprë penale, është fakti se, kjo veprë penale edhe në momentin kur u parashikua për herë të parë në Kodin Penal në vitin 2001, u parashikua me një dispozitë të bardhë ose blankete, ku jepej vetëm titulli i dispozitës dhe nuk përcaktohej përmbajtja e saj në dispozitë.²

Formulimi i kësaj dispozite, nga ana e ligjvënësit, me anë të një dispozite blankete, ku nuk jepej në vetë dispozitën, përmbajtja e veprës penale, e vështirësoi edhe më tej punën për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj veprë penale. Nisur nga fakti që, kjo veprë penale ishte një veprë penale e re, a pa hasur më parë në praktikën gjyqësore shqiptare, ishte e domosdoshme që, nga ana e ligjvënësit kjo veprë penale të parashikohej me një dispozitë përshkruese, ku të jepej në mënyrë të qartë, përmbajtja dhe elementet e kësaj veprë penale. Një gjë e tillë u bë më në fund nga ana e ligjvënësit tre vjet me vonë, konkretisht në vitin 2004,³ i cili në nenin 1 të tij, veprën penale të: *"Trafikimit të personave"* e përcaktoi në këtë mënyrë: *Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies së përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pese deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.*

² Paragrafi i parë i nenit 110/a, i Kodit Penal, (dispozitë e cila u shtua me nenin 28 të ligjit nr, 8733, datë 24.01.2001 përcaktonte: *"Trafikimi i njerëzve, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër denohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet"*.
³ Ligjit nr. 9188, datë 12.2.2004.

Përcaktimi sa më sipër, i kësaj vepre penale, nga ana e ligjvënësit, i cili është edhe formulimi që kjo vepër penale ka edhe sot, ishte një hap i rëndësishëm përpara, në drejtim të identifikimit të saktë dhe të qartë të konceptit “*trafikim i personave*” dhe në këtë mënyrë u bë më e lehtë, zbatimi i kësaj vepre në praktikë. Ligji i mësipërm, jo vetëm që përcaktoi veprën penale të “*Trafikimit të personave*” në mënyrë përshkruese, duke identifikuar qartësisht përmbajtjen dhe elementët e saj, por, bëri edhe një kategorizim të saktë të dispozitës, në pikëpamje të teknikës legjislative, duke e ndërtuar këtë dispozitë në disa paragrafë, sipas rrethanave konkrete të kryerjes së veprës, nga më i lehti, tek më i rëndi, si dhe duke shtuar për herë të parë, një paragraf që kishte të bënte me rastet kur, kjo vepër kryhej nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik.

Një tjetër veçori, që ka të bëjë me parashikimet që ka bërë ligjvënësi, në Kodin Penal në fuqi, me qëllim luftën kundër “trafikimit të qënieve njerëzore”, është fakti se, në këtë Kodin janë parashikuar tre dispozita konkrete që kanë si qëllim parandalimin dhe ndëshkimin e këtij fenomeni kriminal.⁴ Të tre këto dispozita penale, duhet të kemi parasysh se janë dispozita të ndryshme, të cilat zbatohen në varësi të faktit, nëse i dëmtuari është fëmijë, në këtë rast zbatohet neni 128/b i Kodit Penal, nëse është femër mbi 18 vjeç, në këtë rast zbatohet neni 114/b i Kodit Penal dhe nëse është mashkull mbi 18 vjeç dhe në këtë rast zbatohet neni 110/a i Kodit Penal.

Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh faktin se, pavarësisht, këto tre vepra penale janë vepra penale të ndryshme dhe zbatohen në varësi të rrethanave konkrete, që kanë të bëjnë me të dëmtuarin, të shpjeguara më lart, këto tre vepra penale në thelb, janë të njëjta dhe kanë të njëjtën natyrë. Një gjë e tillë rezulton, jo vetëm nga përmbajtja e tyre, ku, po të shikojmë formulimet e secilës prej tyre, me ndonjë përjashtim të vogël, tek masat e dënimit, ato janë pothuajse identike, aq sa është e vështirë të gjesh dallime ndërmjet tyre, por, edhe nga qëllimi i njëjtë që kanë këto vepra penale, i cili ka të bëjë me parandalimin dhe ndëshkimin e fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore.

Nisur sa më lart, për arsye të mos përsëritjes së gjërave, kur do të trajtojmë veprën penale që ka të bëjë me trafikimin e qënieve njerëzore, do t’i referohemi konkretisht veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, të parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, sepse kjo vepër përmbledh në mënyrë të plotë edhe konceptet që kanë të bëjnë me trafikimin e femrave dhe trafikimin e të miturve, pavarësisht nga fakti se, në praktikë, më e përhapur si vepër, është vepra e “*Trafikimit të femrave*”, më pas ajo e “*Trafikimit të të miturve*” dhe në fund ajo e “*Trafikimit të personave*”. Nisur nga ajo që u tha më lart, në këtë temë, sa herë që do të flasim për veprën penale të “*Trafikimit të personave*”, do të nënkuptojmë edhe veprat penale të “*Trafikimit të femrave*” dhe atë të “*Trafikimit të të miturve*”.

Një veçori tjetër, që ka të bëjë me veprën penale të “*Trafikimit të personave*”, në të tre format e saj, të parashikuara në Kodin Penal, është fakti se, kjo vepër, në ndryshim nga vepra penale e “*Trafikimit të narkotikëve*”, nuk ka si pjesë të anës objektive të saj, transferimin e të dëmtuarit jashtë shtetit, pra, kjo vepër, nuk është e domosdoshme që të ketë karakter ndërkombëtar. Në praktikën gjyqësore, është e vërtetë se, në shumicën e rasteve, kjo vepër kryhet duke e transferuar të dëmtuarin jashtë shtetit, por, kalimi dhe qëllimi për të shfrytëzuar të dëmtuarin jashtë shtetit, nuk është një element i domosdoshëm i anës objektive të kësaj vepre penale, pasi kjo vepër, mund të kryhet edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në rast se ekzistojnë, të gjithë elementët e anës objektive që ligji ka parashikuar për këtë vepër penale.

Si veçori të fundit, në lidhje me veprën penale të “*Trafikimit të personave*”, të shfaqur në të tre format e saj, do të përmendja faktin se aktualisht, ndryshe nga vitet e mëparshme, kjo vepër penale, është relativisht pak e përhapur dhe fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore, është një fenomen që po bëhet gjithnjë e më pak shqetësues për shoqërinë shqiptare. Një gjë e tillë ka ardhur, qoftë si pasojë e ndërjegjësimit të qytetarëve, të cilët mund të ishin viktime të kësaj vepre penale, për pasojat e rënda që sjellë kjo vepër, qoftë edhe për shkak të masave të marra nga ana e shtetit shqiptar, në drejtim të luftës për parandalimin dhe ndëshkimin e kësaj vepre penale.

⁴ Neni 110/a i Kodit Penal, i titulluar “*Trafikimi i personave*”, neni 114/b, i titulluar “*Trafikimi i femrave*”, dhe neni 128/b, i titulluar “*Trafikimi i të miturve*”.

2. ELEMENTET JURIDIKO-PENAL TË VEPRËS PENALE TË “TRAFIKIMIT TË PERSONAVE” DHE PROBLEMATIKA E HASUR NE LIDHJE ME KUALIFIKIMIN E DREJTË LIGJOR TË KËSAJ VEPRE PENALE

Përcaktimi i konceptit të trafikimit të personave, nga ana e ligjvënësit shqiptar, i bërë në Kodin Penal në fuqi, është në përputhje me kuptimin që i jep këtij koncepti, “*Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar*” dhe dy Protokollat Shtesë të saj, të cilët janë bërë pjesë të brendshme të legjislacionit shqiptar, me anë të ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002.⁵ Siç shihet, nga vendi që zë kjo dispozitë në Kodin Penal *objekt i përgjithshëm* i kësaj dispozite janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtat dhe liritë e personit, nga çdo veprim ose mosveprim kriminal. *Objekt i drejtpërdrejtë* i kësaj dispozite, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar lirinë e personit, përfshirë lirinë seksuale të tij, të drejtën e personit për të qenë i lirë dhe për të vendosur në mënyrë të vullnetshme mbi jetën e tij dhe mbi veprimet që ai dëshiron të kryejë, në raport me subjektet e tjerë të së drejtës, i cili përbën *objektin parësor* të kësaj vepre penale. *Si objekt dytësor* i kësaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar jetën dhe shëndetin e personit, dinjitetin dhe personalitetin e tij, nga çdo veprim ose mosveprim kriminal.

Nga ana objektive kjo veprë penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme, të cilët konsistojnë, detyrimisht, në tre elementë të mëposhtëm:

a) Elementi i parë, ka të bëjë me *rekrutimin, ose transportimin, ose transferimin, ose fshehjen ose pritjen e personit*.

Në mënyrë që të kuptohet në mënyrë të saktë ky element dhe secila prej pjesëve përbërëse të tij, është e domosdoshme që të bëhet sqarimi i koncepteve “rekrutim i personit”, “transportim i personit”, “transferimi i personit”, “fshehja e personit” dhe “pritja e personit”. *Rekrutimi i personit*, si pjesë e anës objektive e figurës së kësaj vepre penale, ka të bëjë me gjetjen e personave dhe me nënshtrimin e tyre, qoftë me anë të dhunës fizike apo psikike, apo me anë të mashtrimit ose duke përfutur nga gjendja vulnerabël e tij, etj, me qëllim trafikimin e tyre.

Transportimi i personit, nënkupton zhvendosjen e këtij personi, nga një vend në një vend tjetër, qoftë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, qoftë jashtë këtij territori, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj vepre penale të kryer në formën e transportimit të personit, nuk ka rëndësi nëse viktimat, transportohet me anë të mjeteve të transportit rrugor, ujor, ajror apo hekurudhor, e rëndësishme është që, viktimat jashtë vullnetit të saj dhe me qëllim trafikimin e saj, transportohet dhe lëviz nga një vend në tjetrin.

Transferimi i personit, me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin, ku subjekti i veprës penale, e transferon një person nga një vend, në një vend tjetër, zakonisht jashtë shtetit, me qëllim që ta trafikojë. Pavarësisht se, transferimi i personit me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin e personit, kjo nuk do të thotë se këto dy koncepte janë identike.

Përkundrazi, këto koncepte kanë dallime ndërmjet tyre dhe si dallim të parë do të përmendja faktin se, transportimi i personit, përfshihet brenda konceptit të transferimit, domethënë, është i vërtetë pohimi sipas të cilit, në çdo rast që kemi transferim të personit, detyrimisht kemi edhe transportimi të tij, por, pohimi i anasjelltë, nuk është i vërtetë, sipas të cilit, në çdo rast që kemi transportim të personit, kemi dhe transferimi të tij nga një vend në tjetrin.

Kjo për faktin se, transportimi mund të realizohet nga ana juridike edhe pa bërë transferimin e personit nga një vend në tjetrin, siç është rasti kur subjekti e transporton subjektin për disa kilometra, brenda të njëjtës qytet ose qark. Në këtë rast, nuk jemi para konceptit të transferimit të personit, me qëllim trafikimi, sepse personi nuk është transferuar nga një vend në tjetrin, por, thjesht është transportuar brenda të njëjtës zonë ose lokaliteti.

⁵ Shih për më tepër: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, miratuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.

Kjo do të thotë se, koncepti i transferimit të personit, me qëllim trafikimi, kërkon detyrimisht transferimin e personit nga një rreth ose qark në tjetrin ose nga një shtet në tjetrin dhe jo thjesht transportimin e tij brenda të njëjtës zonë ose qark. Një dallim i tjetër, që mund të bëhet ndërmjet “transferimit të personit” dhe “transportimit të personit”, për qëllime trafikimi, është fakti se, tek transferimi, subjekti i veprës penale, kryen një veprimtari kriminale me të gjatë në kohë, deri sa të arrijë plotësisht transferimin e viktimës, nga një qytet ose qark, në një tjetër, ose nga një shtet në një tjetër, ndërsa tek “transportimi i personit”, për qëllime trafikimi, veprimtaria e subjektit të veprës penale, është më e shkurtër në kohë, ajo zgjat, zakonisht, disa orë dhe brenda kësaj periudhe, subjekti konsiderohet se, e ka kryer veprën penale të “*Trafikimit të personave*” në këtë formë.

Fshehja e personit, nënkupton, mbajtjen të izoluar të personit nga ambienti i jashtëm dhe moslejimin e komunikimit të tij me persona të afërm të familjes apo me persona të tjerë, e bërë kjo me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale, kërkohet detyrimisht që viktimës t’i hiqet liria dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme.

Në rastet kur vepra penale e “*Trafikimit të personit*”, kryhet me anë të “*fshehjes së personit*”, në këtë rast, mund të lind pyetja: A konkurren kjo veprë penale me atë të “*Heqjes së paligjshme të lirisë*” apo me veprën penale të “*Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit*”?

Në lidhje me këtë pyetje, jam i mendimit se, vepra penale e “*Trafikimit të personave*”, nuk konkurren me veprën penale të “*Heqjes së paligjshme të lirisë*”, të parashikuar nga neni 110 të Kodit Penal, për faktin se heqja e paligjshme e lirisë, në këtë rast, shërben si mjet për kryerjen e veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, e thënë ndryshe, vepra penale e “*Trafikimit të personit*” e kryer në formën e “*fshehjes së personit*”, nuk mund të kryhet ndryshe, përveçse, duke i hequr në mënyrë të paligjshme lirinë viktimës. Për këtë arsye, mendoj se, në këtë rast, nuk jemi para konkurrimit të veprave penale, por, jemi para thithjes së tyre.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe në lidhje me konkurrimin apo jo të kësaj vepre penale të kryer në formën e “*fshehjes së personit*”, me veprën penale të “*Rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit*”. Edhe në këtë rast, mendoj se, kjo veprë penale, nuk konkurren me veprën penale të “*Rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit*”, për faktin se, në këtë rast, izolimi i personit, bëhet me qëllim trafikimin e tij, ndërsa në rastin e veprës penale të “*Rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit*”, viktimë izolohet ose mbahet peng, për qëllime të tjera të paligjshme, të ndryshme nga ajo e trafikimit të personit.

Pritja e personit, si pjesë e elementit të parë të trafikimit të personave, nënkupton, veprimet që kryhen nga ana e subjektit të veprës penale, që kanë të bëjnë me strehimin e personit dhe me shoqërimin e tij, për në një vend të caktuar, zakonisht, banesë ose hotel, me qëllim trafikimin e tij. Ndodhemi para kësaj forme të kryerjes së kësaj vepre penale, zakonisht, në rastet kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, ndërmjet dy ose më shumë personave,⁷ ku një prej bashkëpunëtorëve bën “*rekrutimin e personit*”, bashkëpunëtori tjetër bën “*transportimin dhe/ose transferimin e viktimës*”, ndërsa bashkëpunëtori tjetër bën “*pritjen e viktimës*”.

Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si plotësisht e kryer nga ana e autorit të saj, mjafton që prej tij, të kryhet edhe vetëm në një nga format e mësipërme të realizimit të veprës penale, kuptohet kur ekzistojnë edhe dy elementët e tjerë të anës objektive, të cilët do të trajtohen më poshtë. Kjo do të thotë se, kur plotësohen edhe dy elementët e tjerë të anës objektive të kësaj vepre penale, subjekti do të konsiderohet se e ka kryer në mënyrë të plotë të këtë veprë penale, në rastet kur ai ka bërë vetëm *rekrutimin e personit*, ose vetëm *transportimin e personit*, ose vetëm *transferimin e personit*, ose vetëm *fshehjen e personit*, ose vetëm *pritjen e personit*, me anë të mashtrimit ose kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj, dhe më qëllim trafikimin e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar këtë person.

6 Të parashikuar nga neni 110 dhe nga neni 109 të Kodit Penal.

7 Fakt i cili përbën edhe rastet më të shpeshta të kryerjes së kësaj vepre penale.

Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe praktika gjyqësore në Shqipëri, e të tre niveleve, ku është konkluduar se, për t'u konsideruar si plotësisht e kryer vepra penale e *"Trafikimit të personave"*, mjafton që subjekti të ketë bërë vetëm *rekrutimin e personit*, ose vetëm *transportimin e personit*, ose vetëm *transferimin e personit*, ose vetëm *fshehjen e personit*, ose vetëm *pritjen e personit*, me anë të mashtrimit ose kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj, dhe më qëllim trafikimin e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar atë.

Kështu, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera arsyeton: *"...Gjykata çmon me këtë rast të sqarojë se, vepra penale e "Trafikimit të femrave", e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është veprë penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kjo veprë që të konsiderohet e konsumuar, mjafton që të provohet të gjithë elementët e saj që kanë të bëjnë me objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive dhe nuk kërkon ardhjen e asnjë lloj pasoje..."*⁸

Qëndrimi i mbajtur më sipër, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është konfirmuar në këtë rast edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, e cila me vendimin e saj, nr. 47, datë 23.10.2007, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera ka arsyetuar: *"...Figura e veprës penale të trafikimit të femrave, konsiderohet e formuar dhe me ekzistencën e njërit nga elementët e saj, kur bëhet në format dhe qëllimet e sipërcituara të kësaj dispozite. Pra, do të mjaftonte dhe vetëm elementi i rekrutimit apo i transportimit, etj, nëpërmjet formave dhe qëllimeve të lartpërmendura, që i pandehuri të ketë përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Fakti që i pandehuri nuk ia arriti qëllimit që ta shfrytëzojë të dëmtuarën për prostitutë, nuk bën që ai të mos përgjigjet penalisht, pasi ai i ka konsumuar të gjithë elementët e kësaj figure vepre penale..."*⁹

Qëndrimi ligjor i mbajtur nga të dy gjykatat e faktit në këtë çështje, është konfirmuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin e tij nr. 310, datë 5.6.2009, ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtja, për shkak se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në ligj, duke konfirmuar se qëndrimi i mbajtur nga dy gjykatat e faktit, në këtë çështje, ka qenë ligjor dhe i drejtë.¹⁰

Në qoftë se, autori e ka kryer veprën penale, me dy ose më shumë forma të kryerjes së saj, nga pikëpamja e anës objektive, për shembull, ka bërë edhe rekrutimin edhe transferimin dhe fshehjen e personit, me anë të mashtrimit ose kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj, si dhe ka bërë shfrytëzimin e tij, ai nuk do të përgjigjet, aq herë, sa janë format që ka kryer këtë veprë, por, do të përgjigjet vetëm njëherë, sipas nenit 110/a të Kodit Penal dhe fakti që ai e ka kryer veprën në disa prej formave të kryerjes së saj, tregon për rrezikshmërinë e madhe të tij dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

b) Elementi i dytë, i cili, duhet të ekzistojë në çdo rast, nga pikëpamja e anës objektive është që, rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale *të bëhet ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës, me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të dëmtuarit, me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.*

Nga formulimi që ka përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 110/a të Kodit Penal, ku jepet edhe kuptimi i veprës penale të *"Trafikimit të personave"* konstatohet se elementi i dytë i anës objektive të kësaj figure të veprës penale, mund të zërthehet në disa elementë që konkretisht janë:

1. Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet *me anë të kërcënimit* që i bëhet personit, me qëllim trafikimin e tij, ku, kërcënimi i personit, nënkupton dhunën psikike ose kanosjen që i bëhet personit. Në mënyrë që të jemi para kësaj

8 Shih për më tepër: Vendimin nr. 31, datë 14.6.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

9 Shih për më tepër: Vendimin nr. 47, datë 23.10.2007, të Gjykatës Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.

10 Shih për më tepër: Vendimin nr. 310, datë 5.6.2009, të Gjykatës së Lartë.

forme të kryerjes së veprës penale, duhet që kërcënimi ose dhuna psikike ose kanosja të plotësojë të gjithë elementët e veprës penale të “Kanosjes”.¹¹

2. Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përdorimit të forcës, me të cilën kemi parasysh përdorimin e dhunës fizike, që subjekti i veprës penale ndaj të dëmtuarit. Dhuna fizike nënkupton, dëmtime dhe lëndime fizike që i bëhen personit, si rrahje, goditje me sende të ndryshme, shtyrje, rrëzime për tokë, deri tek plagosja e lehtë, që i bëhen të dëmtuarit me qëllim trafikimin e tij.
3. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të formave të tjera të shtrëngimit, me të cilat do të kuptojmë, të gjitha ato veprime të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në vullnetin e të dëmtuarit, duke i hequr atij plotësisht lirinë që të disponojë për veten e tij, të cilat janë të ndryshme nga dhuna fizike apo psikike. Si veprime të tilla, mund të përmendim, për shembull, lënien e të dëmtuarit pa ushqim, ose mos sigurimi për të dëmtuarin të kushteve minimale higjieno-sanitare ose të fjetjes etj.
4. Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të rrëmbimit, kur subjekti i veprës penale me veprimet e tij të kundërligjshme, plotëson të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.¹²
5. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të mashtrimit, kur subjekti përdor gënjeshtëri ose shpërdoron besimin e të dëmtuarit, me qëllim trafikimin e tij.
6. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të shpërdorimit të detyrës, kur në veprimet e subjektit të veprës penale, ekzistojnë të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.¹³ I vetmi dallim që ekziston në këtë rast, është fakti se, subjekti veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryen, me qëllim trafikimin e të dëmtuarit.
7. Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja ose pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të dëmtuarit, kur subjekti e kryen veprën penale, duke shfrytëzuar disa nga këto rrethana që lidhen me të dëmtuarin si:
 - gjendja e rëndë ekonomike e të dëmtuarit, ku i dëmtuari nuk ka asnjë mjet për jetesë;
 - gjendja e keqe familjare e të dëmtuarit, për shembull, e dëmtuara është rritur pa prindërit, ose është rritur me prindër të divorcuar, të cilët kanë ribërë martesë të re, ose e dëmtuara është e divorcuar dhe është e vetme me ose pa fëmijë të mitur etj;
 - niveli i ulët arsimor i të dëmtuarit;
 - izolimi nga bota e jashtme që mund të ketë pasur i dëmtuari, si pasojë e kushteve të rënda ekonomike ku është rritur;
 - mentaliteti dhe traditat në disa raste të disfavorshme ku është rritur i dëmtuari etj.

¹¹ Neni 84 i Kodit Penal.

¹² Neni 109/1 i Kodit Penal përcakton: “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t’iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë”.

¹³ Neni 248 i Kodit Penal përcakton: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë”.

8. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike e të dëmtuarit, ku me gjendje të rëndë fizike, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari është i dëmtuar rëndë fizikisht, për shembull, është pa këmbë ose është me një këmbë, ose, kur personi nuk shikon ose nuk dëgjon, apo kur është i paralizuar dhe ecën me karrocë invalidi etj. Me gjendje të rëndë psikike të të dëmtuarit, do të kuptojmë rastet kur, i dëmtuari ka zhvillim të vonuar mendor ose vuan nga sëmundje mendore, të cilët e bëjnë të paaftë për të kuptuar, plotësisht, veprimet që kryen në dëm të tij dhe pasojat që vijnë prej tyre.
9. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të dhënies së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, jep një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.
10. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, merr një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.

Në mënyrë që vepra e “*Trafikimit të personave*” të konsiderohet e kryer, në mënyrë të plotë, nga ana e subjekti të veprës penale, mjafton të provohet se ai ka përdorur, qoftë edhe një nga format e mësipërme, për të realizuar trafikimin e personit. Pra, vepra penale do të konsiderohet plotësisht e kryer, në qoftë se, subjekti rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, ose pritjen e personave, e ka bërë qoftë edhe vetëm me anë të kërcënimit ose qoftë edhe vetëm me anë të përdorimit të forcës ose qoftë edhe vetëm me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të rrëmbimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të mashtrimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të shpërdorimit të detyrës, ose qoftë edhe vetëm me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, psikike apo fizike, ose qoftë edhe vetëm me anë të marrjes ose dhënies së pagesave për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

Në qoftë se, rezulton që, subjekti e ka kryer veprën, në dy ose më shumë prej këtyre formave të trajtuara më lart dhe të parashikuara në dispozitë, ai nuk do të përgjigjet aq herë në sa forma e ka kryer veprën, por, do të përgjigjet vetëm një herë, dhe fakti që ai e ka kryer veprën, me anë të disa prej këtyre formave, tregon për rrezikshmërinë e madhe të tij, fakt që duhet të mbahet nga gjykata në caktimin e dënimit.

c) Elementi i tretë, i referohet faktit që rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, i bërë ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, ose me anë të mashtrimit, ose me anë të shpërdorimit të detyrës, ose me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të dëmtuarit, ose me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, duhet që të bëhet ose me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose me qëllim shfrytëzimin e punës ose shërbimeve të detyruara, ose me qëllim skllavërimin e personit ose formave të ngjashme me të, ose me qëllim vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me qëllim të çdo shfrytëzimi tjetër.

Nga përcaktimi i mësipërm rezulton se ky element i kryerjes së veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, shfaqet në një ose disa prej këtyre mënyrave:

- a) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për qëllime prostitucioni;
- b) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për forma të tjera të shfrytëzimit seksual;
- c) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për punë të detyruar ose
- ç) Shfrytëzimi i personit për shërbime të tjera të detyruara;
- d) Shfrytëzimi i të dëmtuarit si skllav;
- e) Shfrytëzimi i të dëmtuarit në pozita të ngjashme me skllavërimin;

- f) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për vënien në përdorim të organeve;
- g) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për transplantim të organeve;
- h) Shfrytëzimi i të dëmtuarit për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm.

Siç mund të konstatohet, secili prej këtyre rasteve të elementit të tretë të anës objektive të figurës së veprës penale, është i lidhur me konceptin “*Shfrytëzim i të dëmtuarit*”. Ky koncept ka kuptimin që, në çdo rast i dëmtuari, jashtë vullnetit të tij dhe kundër dëshirës së tij, dhe i detyruar nga subjekti i veprës penale, shfrytëzohet, në një nga format e përmendura më lart,¹⁴ Tek kjo veprë penale, në të gjitha format e kryerjes së saj, mungon vullneti i të dëmtuarit në kryerjen e veprimeve, i dëmtuari është totalisht i kontrolluar nga subjekti i veprës penale dhe kryen çdo veprim që i kërkohet prej tij.

Ky kontroll, që ushtron subjekti i veprës penale tek i dëmtuari, realizohet, siç është thënë më lart, ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës, ose me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës ose duke përfutur nga gjendja shoqërore apo fizike ose psikike e të dëmtuarës etj.

Një tjetër veçori e rëndësishme e kësaj veprë penale është edhe fakti se, gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale, çdo fitim i nxjerrë nga ana e të dëmtuarit si pasojë e shfrytëzimit të tij, përfitohet, si rregull, nga ana e subjektit të veprës penale. Të dëmtuarit, gjatë kohës së kryerjes së kësaj veprë penale nga ana e subjektit, i është hequr në mënyrë të plotë liria, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ai shndërrohet në një vegël të bindur të subjektit të veprës penale, duke mos pasur fare mundësi që të kryejë veprime sipas vullnetit të tij, dhe kjo përbën edhe një nga dallimet bazë, ndërmjet veprës penale të “*Trafikimit të personave*”,¹⁵ dhe me veprat penale të “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”.¹⁶

Në mënyrë që, vepra të konsiderohet e kryer, nga ana e subjektit, mjafton që ai ta ketë pasur qëllimin për ta kryer atë, qoftë edhe vetëm me anë të një prej formave të shfrytëzimit, të parashikuara nga dispozita, pra, qoftë edhe me anë të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose qoftë edhe vetëm me anë të shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të detyruara, ose qoftë edhe vetëm me anë të skllavërimit të personit ose formave të ngjashme me të, ose qoftë edhe vetëm me vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me çdo shfrytëzimi tjetër.

Në qoftë se subjekti e ka pasur si qëllim për ta kryer veprën, në dy ose më shumë prej formave të parashikuara më lart, pra, e ka pasur si qëllim për ta kryer edhe për shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, edhe me anë të shfrytëzimit të punës së detyruar, edhe me anë të vënies në gjendje skllavërie të personit, etj, subjekti, nuk do të përgjigjet, aq herë, në sa forma ka pasur për qëllim për ta kryer veprën, por, vetëm një herë të vetme,¹⁷ ndërsa fakti që ai ka pasur si qëllim për ta kryer veprën, në disa forma, tregon për rrezikshmërinë e lartë të tij, dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

Për kuptimin e drejtë të veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, do të duhet të theksojmë edhe një herë që, në mënyrë që kjo veprë të konsiderohet si plotësisht e kryer, elementi i tretë i saj, qëllimi për shfrytëzimi prostitucioni, ose për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm të të dëmtuarit, nuk është e domosdoshme që të realizohet nga subjekti i veprës penale, por, mjafton që të provohet qëllimi i subjektit për të shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme personin e dëmtuar.

Ky është qëndrimi që ka mbajtur edhe praktika gjyqësore, në Shqipëri, gjatë gjithë kësaj periudhe, ku shfrytëzimi i kundërligjshëm i të dëmtuarit nuk është konsideruar si pjesë e anës objektive të veprës penale të “*Trafikimit të personave*”. Kështu në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndër të tjera arsyeton se: “...*Që të konsiderohet e formuar figura e veprës penale të trafikimit të femrave, mjafton*

14 Forma të cilat janë të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 110/a i Kodit Penal.

15 Të parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal.

16 Të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal.

17 Neni 110/a të Kodit Penal.

që të jetë prezent qoftë edhe njëra nga elementët e saj, pra, do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo ai i transportimit apo transferimit apo i fshehjes apo i pritjes së femrës, në një nga format dhe për qëllimin e përcaktuar në dispozitën e lartpërmendur”.¹⁸

Përsa i përket veprës penale të “*Trafikimit të personave*”, duhet thënë, së fundmi, se, nga pikëpamja e anës objektive, në praktikën gjyqësore ka pasur debate se, kur ajo do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, ose më saktë, nëse kjo veprë do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, në rastet kur përveç një autori, nuk janë identifikuar autorët e tjerë, që kanë bashkëpunuar në kryerjen e kësaj veprë penale. Këto debate juridike, u shuan përfundimisht, me Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 15.4.2011, e cila unifikoi praktikën gjyqësore në këtë mënyrë: “*Kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paafësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë”.*¹⁹

Subjekti i kësaj veprë penale, është i përgjithshëm, pra, çdo person që ka arritur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit për veprimet që kryen.

Nga ana subjektive, kjo veprë penale, kryhet në çdo rast me dashje direkte dhe me qëllim realizimin e përfitimeve monetare ose pasurore, ose të çdo qëllim tjetër. Ligjvënësi në lidhje me këtë veprë penale, përsa i përket dënimin, parashikon dy dënime kryesore, dënimin me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, si dhe me gjobë, nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.

Përsa i përket dënimin me gjobë, si dënim kryesor për këtë veprë penale, por, edhe për të gjitha veprat e tjera penale, për të cilat Kodi Penal, parashikon dy dënime kryesore, atë me burgim dhe me gjobë, duhet thënë se dënimin me gjobë, si dënim kryesor, në këtë rast, nuk mund të zbatohet nga gjykata, sepse ky lloj dënimi kryesor, është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr. 47 të vitit 2012. Kështu, në vendimin e mësipërm, në lidhje me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera arsyeton: “*...me ligjin nr.9086, datë 19.06.2003, ligjvënësi, në kuadër të forcimit të masave kundër kriminalitetit, e pa me vend, që t'i hapë rrugë një sërë ndryshimesh të tjera në legjislacionin penal, të cilat “detyrojnë” gjykatën të vendosë njëkohësisht dy dënime kryesore për kryerjen e një veprë penale. Këto ndryshime nuk mund të realizoheshin pa modifikuar fillimisht dispozitën parimore lidhur me dënimet kryesore, nenin 29 të KP-së. Kështu, me ligjin e lartpërmendur këtij neni iu shtua paragrafi i fundit, me këtë përmbajtje: “Dënimin me burgim dhe me gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi”... .*

...25. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilëso natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se, që të jetë i pranueshëm dënimin penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer.”²⁰

26. Gjykata ka vlerësuar se qëllimi i secilit prej dënimeve kryesore të parashikuara në Kodin Penal është i ndryshëm. Dënimin me burgim, duke konsistuar në një privim të lirisë, është konceptuar në të drejtën penale, edhe në kuptim të parimit të favor libertatit, si extrema ratio. Pra, duke qenë se dënimin me burgim passjell sakrificimin maksimal të lirisë personale të personit, kjo e fundit e mbrojtur nga Kushtetuta, ai është konsideruar nga ligjvënësi si masa e fundit shtrënguese si dhe dënimin më i rëndë ndër dënimet kryesore. Ndërsa, dënimin me gjobë lindi si një mënyrë për të shmangur dënimin me burgim, pasi konsiderohet si më e drejtë që personi të mund të paguante një shumë të hollash për vepra që kishin një rrezikshmëri të ulët shoqërore, pa pasur nevojë që të privohej nga liria. Qëllimi i dënimin me gjobë, në frymën e Kushtetutës, duhet rilexuar në kuptimin që funksioni riedukativ, për disa vepra të caktuara penale, mund të përmbushet edhe nga pagesa e një shume të caktuar, pa qenë nevoja që personi të privohet nga liria vetjake.

18 Shih për më tepër: Vendimin nr. 5, datë 17.1.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

19 Shih për më tepër: Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 15.4.2011.

20 Shih vendimin nr.19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

27. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore dhe në thelb të ndryshëm nga njëri tjetri dhe se ndikimi i secilit prej tyre mbi të dënuarin, dhe procesin riedukativ ndaj tij, është shumë i ndryshëm, pasi qëllimi i dënimit me burgim është diametralisht i kundërt nga ai i dënimit me gjobë.....

...39. Si pasojë, gjatë përcaktimit të dënimit, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe, nëpërmjet formulimit të sanksionit, t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete. Koncepti i fajit dhe përcaktueshmëria e pasojave juridike janë në një marrëdhënie tensioni njëra me tjetrën, marrëdhënie kjo për të cilën duhet gjetur një balancë funksionale kushtetuese.²¹

...43. Po ashtu, Gjykata konstaton se deri në hyrjen në fuqi të paragrafit të fundit të nenit 29 të KP-së, i cili parashikon dy dënime kryesore, ligjvënësi ka mbajtur parasysh këtë ekuilibër të domosdoshëm midis parashikimit të llojeve të veprave penale dhe marzheve të dënimit si atribut i tij me individualizimin e veprës penale, shkallës së fajit dhe llojit dhe masës së dënimit, për efekt të përgjegjësisë penale, si atribut ekskluziv i gjykatës. Në këtë linjë ka shkuar edhe plotësimi që iu bë nenit 34 të KP-së, me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, duke i shtuar paragrafin e pestë, i cili i njehtë drejtën gjykatës të caktojë krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. ...

...48. Për pasojë, Gjykata çmon se parashikimi apriori i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, jashtë kriterëve të analizuara më lart, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim. ...

...52. Si konkluzion, Gjykata arrin në përfundimin se nenet 29, paragrafi i fundit, 190 dhe 191, të KP-së që sanksionojnë parashikimin e njëkohshëm të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, vijnë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe si të tillë duhen shfuqizuar.²²

Megjithatë, pavarësisht nga shfuqizimi që i ka bërë Gjykata Kushtetuese, paragrafit të fundit të nenit 29 të Kodit Penal, i cili parashikonte që dënimi me burgim dhe me gjobë jepen bashkërisht, kur parashikoheshin në dispozitat përkatëse të këtij Kodi, në rastin e veprës penale të "Trafikimit të personave", por, edhe të çdo vepre tjetër penale, që kryhet me qëllim fitimi, gjykata mund të vendosë që të ndëshkojë autorin e veprës penale, krahas dënimit me burgim, edhe me dënim me gjobë, nga 100 mijë deri në 5 milionë lekë, në bazë të paragrafit të pestë të nenit 34 të Kodit Penal.²³

3. KONKLUZIONE

Nga analiza juridiko-penale, që iu bë veprës penale të "Trafikimit të personave", mund të nxjerrim këto konkluzione:

- kjo vepër penale, është një vepër penale e re, në legjislacionin penal në Shqipëri, dhe është parashikuar për herë të parë në vitin 2001, në Kodin tonë Penal, çka tregon se ka mungesë të traditës juridike në kuptimin e drejtë të kësaj vepre penale;
- vepra penale e "Trafikimit të personave", është një vepër penale formale, pra, që nuk kërkon ardhjen e asnjë pasojë, mjafton që subjekti të konsumojë të gjithë elementët e figurës së kësaj vepre penale, në mënyrë që ajo të konsiderohet plotësisht e kryer;
- në Kodin tonë Penal, janë parashikuar tre dispozita penale që bëjnë rregullimin juridiko-penal

²¹ Shih vendimin BVerfGE 105, 135 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane.

²² Shih për më tepër: Vendimin nr. 47, të vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

²³ Paragrafi i pestë i nenit 34 të Kodit Penal parashikon se: "Për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita penale parashikon vetëm dënimin me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë nga 100 mijë deri në 5 milion lekë".

- të veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore, që janë konkretisht nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të këtij Kodi, thelbi i të cilëve është i njëjtë, por, i vetmi element që ndryshon, përveç, masave të dënimit, është i dëmtuari që trafikohet, që është, respektivisht, personi mashkull mbi 18 vjeç, femra mbi 18 vjeç dhe i mituri, mashkull ose femër, nën 18 vjeç;
- vepra penale e *“Trafikimit të personave”*, paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore, sepse cenon një nga të drejtat dhe liritë më themelore të njeriut, siç është liria e personit, ku si objekt dytësor i kësaj vepre penale, është edhe jeta dhe shëndeti i personit;
 - dallimi themelor ndërmjet veprës penale të *“Trafikimit të personave”*, me veprën penale të *“Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”*, e parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, është fakti se tek trafikimi i personit, cenohet vullneti dhe liria e personit, ndërsa tek ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, nuk kemi cenim të vullnetit dhe lirisë së të dëmtuarit, por, kemi cenim të normave juridike që mbron paprekshmërinë e kufijve shtetëror;
 - vepra penale e *“Trafikimit të personave”*, në ndryshim nga vepra penale e *“Trafikimit të narkotikëve”*, nuk është në çdo rast, vepër me karakter ndërkombëtar, pasi trafikimi i personit, mund të bëhet edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe territori ose vendi ku kryhet kjo vepër penale, nuk është pjesë e anës objektive të saj;
 - praktika gjyqësore në Shqipëri, pavarësisht nga vështirësitë e fillimit, kjo edhe për shkak të mungesës juridike, ka ecur, në përgjithësi drejt dhe i ka kuptuar si duhet elementet juridiko-penal të veprës penale të *“Trafikimit të personave”*, çka provohet me faktin se shumica e vendimeve në lidhje me këtë çështje, janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta;
 - vepra penale e *“Trafikimit të personave”*, si pasojë e ndërjegjësimit të vetë personave të dëmtuar, por, edhe si pasojë e masave të marra nga organet rendit publik, si dhe, si pasojë e dënimeve të rënda që parashikon Kodi Penal për kryerjen e kësaj vepre penale, si dhe e gjykimit të tyre me profesionalizëm nga organet e drejtësisë në Shqipëri, vitet e fundit, ka pësuar një ulje të ndjeshme, duke mos përbërë më një rrezik aq të rëndë për shoqërinë tonë.

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa e Kombeve të Bashkuar kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, miratuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002;
3. Protokolli “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht, të grave dhe fëmijëve në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuar kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”;
4. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 15.4.2011;
5. Vendimi nr. 31, datë 14.6.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë;
6. Vendimi nr. 5, datë 17.1.2008, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë;
7. Vendimi nr. 47, datë 23.10.2007, i Gjykatës Apelit për Krime të Rënda, Tiranë;
8. Vendimi nr. 310, datë 5.6.2009, të Gjykatës së Lartë;
9. Vendimi nr. 47, të vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

4

SHFRYTËZIMI PËR PROSTITUCION PARASHIKOHET NË NENIN 114 DHE 114/A TË KODIT PENAL PARASHIKOHET SHFRYTËZIMI NË RRETHANA TË CILËSUARA, NDËRSA NË NENIN 114/B TË KODIT PENAL PARASHIKOHET TRAFIKIMI I FEMRAVE

Përparim KULLURI¹

HYRJE

Sipas definicionit të parashikuar në shtojcën plotësuese të Konventës së Krimit Ndërkombëtar, trafikimi i qenieve njerëzore është rekrutimi i personave, transportimi, transferimi, ndihma ose marrja e personave, nëpërmjet mjeteve të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose e formave të tjera të dhunës, rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërs, abuzimit të pushtetit ose pozicionit të dobët ose dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimeve për të siguruar miratimin e një personi që ka kontroll mbi një tjetër për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së pakti shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbime ose punë të detyruar, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, nënshtrimi ose heqja e organeve”.

Ky definicion përfshin të gjitha ato veprime që kanë të bëjnë me rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet detyrimit, forcës, rrëmbimit, gënjeshtërs ose mashtrimit, me qëllim vendosjen e personave në punë ose shërbim të detyruar, siç është prostitucioni i detyruar, nënshtrimi i plotë për punët shtëpiake, detyrim borxhi, shfrytëzim pune, skllavërim ose praktika të tjera të ngjashme me skllavërinë, transplant të organeve. Të gjitha këto veprime formojnë atë që quhet “trafikim i qenieve njerëzore”.

“Trafikimi i qenieve njerëzore” përfshin lëvizjen e njerëzve me qëllim vendosjen e tyre në punë të detyruar ose në forma të tjera nënshtrimi të pavullnetshëm. Ai bëhet për qëllime seksuale dhe jo seksuale dhe të gjitha veprimet e tjera gjatë gjithë procesit të trafikimit nga rekrutimi ose rrëmbimi i njerëzve në fillim të trafikimit dhe deri tek qëllimi ose rezultati i fundit – shfrytëzimi i trupit ose punës së viktimës kanë një qëllim të vetëm që është përfitimi i trafikantit apo trafikanteve nga shfrytëzimi i personave.

Neni 114/b përbën një formë të cilësuar për trafikimin e personave duke u cilësuar vetëm në gjininë e viktimës. Neni 114/b ka një përkufizim identik me nenin 110/a “Trafikimi i personave”, por viktimat në nenin 114/b është e cilësuar-e seksit femër.

1. DALLIMET, RËNDËSIA, PASOJAT E KËTYRE VEPRAVE PENALE

Dallimet mes këtyre veprave penale, për vetë rëndësinë dhe pasojat që sjellin jo vetëm në vetë personin e dëmtuar, por për shoqërinë në tërësi shihet që në kompetencën e Prokurorisë dhe Gjykatës që heton dhe gjykon këto çështje penale.

Pavarësisht se të dy këto vepra penale përfshihen në seksionin e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale e parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal është kompetencë e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal është kompetencë e Gjykatës për Krime të Rënda dhe Prokurorisë për Krime të Rënda.

¹ Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ndryshe nga **trafikimi i femrave**,² i cili nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhi apo abuzim të pushtetit ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër për qëllime shfrytëzimi (shfrytëzimi përfshin atë për prostitucion, punën apo shërbime të tjera të detyruara, praktika të ngjashme me skllavërim), **shfrytëzimi i prostitucionit**³ si një trajtim i ngushtë penal ka si qëllim të mbrojë personat që të mos bien viktima të prostitucionit ose të mos mbikëqyren ose shfrytëzohen kur janë duke punuar si prostituta, ose të mos influencohen që të qëndrojnë në prostitucion.

Elementi thelbësor i trafikimit është kundra ligjshmëria e veprimit të dhunës, mashtrimit dhe realizimit të fitimit të paligjshëm, të turpshëm. Trafikimi i njerëzve cenon ato raporte shoqërore që kanë të bëjnë me lirinë dhe të drejtat e personit të cilat mbrohen dhe garantohen si nga Kushtetuta dhe Legjislacioni Penal. Liritë dhe të drejtat e personit si dhe dinjiteti i tij moral e shoqëror garantohet vetëm në një shtet juridik.

Në Kodin Penal trafikimi i njerëzve parashikohet si veprë penale në nenin 110/a të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite trafikimi i njerëzve dënohet nga 5- 15 vjet burg, dhe kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim më shumë se një herë, dhe shoqërohet me dhunë fizike konsiderohet veprë penale e cilësuar e dënohet jo më pak se 15 vjet burg dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen e personit dënohet me burgim të përjetshëm. Ligjvënësi me të drejtë e ka konsideruar këtë veprë penale dhe autorët e tyre me rrezikshmëri të lartë shoqërore duke caktuar dhe masa të rënda dënimi.

Vepra penale e trafikimit të qënieve njerëzore konkurron me veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal. Veprat penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit edhe kur bëhet me qëllim fitimi ajo drejtohet kundër kufijve shtetëror dhe regjimit të rregullt ligjor të tyre. Ndërsa në rastin e trafikimit të njerëzve vepra penale drejtohet kundër personalitetit, lirisë dhe të drejtave të personit. Prandaj kur të njëjtët autorë vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë realizojnë këto krime duhet të akuzohen për të dyja këto vepra penale. Trafikimi i njerëzve ndryshe nga dhënia ndihme për kalim të kufirit mund të kryhet si brenda shtetit ashtu dhe nga një shtet në tjetrin. Dallimi midis këtyre veprave penale ka rëndësi të madhe si teorike dhe praktike.

Me qëllim për të mbrojtur moralin dhe dinjitetin por dhe lirinë dhe të drejtat e grave dhe të vajzave në Kodin Penal është parashikuar si dispozitë e veçantë “Trafikimi i femrave për prostitucion” nr 114/b i Kodit Penal. Sipas paragrafit, por po të kësaj dispozite kjo veprë penale dënohet nga 7 –15 vjet burg. Duke e bërë të cilësuar këtë veprë në paragrafin e dytë për shkak të kryerjes në bashkëpunim, më shumë se njëherë e shoqëruar me dhunë ose pasoja për shëndetin, ligjvënësi ka parashikuar një mase dënimi jo më pak se 15 vjet, dhe kur ka sjellë pasojë vdekje me burgim të përjetshëm.

Në vetvete fjala prostitutë, sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe por edhe kuptimit juridik nënkupton ato gra dhe vajza që shesin nderin dhe trupin e tyre për të siguruar të ardhurat, pra mjete jetese, me vullnetin e lirë të tyre. Me shfrytëzim të prostitucionit duhet të kuptojmë shtytjen, ndërmjetësimin e femrave për të prostituuar dhe marrjen e shpërblimit prej tyre për shkak të këtij aktiviteti. Ndërsa shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese nënkupton mashtrimin, dhunën fizike e psikike, pamundësinë për t’u mbrojtur ose ndodhjen e tyre jashtë territorit të Shqipërisë, elemente të cilat e bëjnë veprën penale të cilësuar dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Trafikimi për prostitucion nënkupton rekrutimin, transportimin, fshehjen dhe pritjen, këmbimin e këtyre femrave në mënyrë të fshehtë, me mashtrim ose dhunë për të siguruar fitime të paligjshme nga trafikantët, qofshin këta brenda vendit ose me trafikantë të shteteve të tjera fqinje.

2 Neni 114/b i Kodit Penal.

3 Neni 114 i Kodit Penal.

2. KONKURRIMI I VEPRAVE PENALE TË PROSTITUCIONIT DHE TË TRAFIKIMIT

Veprat penale, shfrytëzimi i prostitucionit dhe trafikimi i femrave për prostitucion konkurrojnë me njëra tjetrën, dhe anëtarët e tyre duhet të përgjigjen për të dy veprat penale.

Është ky dallimi thelbësor midis veprës penale të trafikimit të femrave për prostitucion me veprat penale të shfrytëzimit për prostitucion, qoftë kjo dhe në rrethana rënduese.

Dallim tjetër është ai në masën e dënimit, ndërsa shfrytëzimi i prostitucionit dënohet me burgim deri në 5 vjet, trafikimi i femrave dënohet me burgim nga 7-15 vjet si dhe me gjobë nga 3 milion deri në 6 milion lekë.

Është i kuptueshëm ky diferencim në masën e dënimit, pasi pavarësisht se në të dy rastet vepra penale kryhet për qëllime përfitimi material, nocioni i “viktims” dhe në këtë këndvështrim edhe rrezikshmëria e këtyre dy veprave është i ndryshëm.

Në rastin e shfrytëzimit të prostitucionit “e dëmtuara” jo detyrimisht ushtron prostitucion kundër dëshirës së saj. Nga ana tjetër subjekti i kësaj vepre penale mund të mos marrë asnjë përfitim personal, por vetëm të nxisë apo të ndërmjetësojë që një person të ushtrojë prostitucion. Praktikisht subjektet e këtyre veprave penale kane gjithmonë synim që të përfitojnë edhe vetë nga shtytja e personit tjetër që të prostituojë.

Në veprat penale të trafikimit të femrave, të dëmtuarat **shfrytëzohen kundër vullnetit të tyre**, të detyruara forcërisht, me mashtrim, nën pushtetin e personave me detyra të rëndësishme, apo të detyruara nga gjendja shoqërore në të cilën jetojnë, apo duke përfituar nga gjendja fizike apo psikike e tyre. Pra, viktimat e kësaj vepre penale vihen ose janë në pamundësi për të vendosur vetë për fatin e tyre.

Ndryshe nga shfrytëzimi sipas neneve 114 dhe 114/a të K.Penal, ku bëhet fjalë vetëm për shfrytëzim të prostitucionit, shfrytëzimi i femrave sipas nenit 114/b nuk është detyrimisht vetëm seksual, por mund të jetë shfrytëzim i punës, skllavërim i këtyre femrave e deri në përdorimin e tyre për marrjen e organeve.

Nga ana e tyre subjektet e kësaj vepre penale,⁴ gjithmonë synojnë dhe kanë qëllim realizimin e përfitimeve nga shfrytëzimi seksual, ose jo, i viktimave të trafikimit.

Tri janë veprimet e anës objektive me të cilën konsumohet vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit - shtytja, ndërmjetësimi, marrja shpërbllim për ushtrim prostitucioni, ndërsa janë disa veprimet në anë objektive me të cilët konsumohet vepra penale e trafikimit të femrave. Këto veprime mund të ndahen në dy grupe-**forca** në njërin anë dhe **mashtrimi** në anën tjetër, janë bërë elemente objektive të një kodi për veprën penale të trafikimit.

Ndërsa të shfrytëzuar për prostitucion mund të jenë jo vetëm femrat, por teorikisht edhe meshkujt, në veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, të dëmtuara janë femrat.

Në rrethana cilësuese vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit parashikohet në nenin 114/a të Kodit Penal, ku veç femrave viktimat mund të jenë edhe të miturit, personat me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie apo krushqie, kujdestarie apo duke përfituar nga raportet zyrtare, me mashtrim, shtrëngim, dhune, të paafte fizikisht apo mendërisht. Një tjetër rrethane që e bën të cilësuar shfrytëzimin e prostitucionit, është kur personi shtyhet apo shtrëngohet për të ushtruar prostitucionin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rrethanë duhet bërë dallimi mes shfrytëzimit në rrethana të cilësuar, e parashikuar nga neni 114/a pika 5 e Kodit Penal dhe trafikimit të femrave. Në fakt do të jemi para veprës penale të shfrytëzimit në rrethana të cilësuar, e parashikuar nga neni 114/a pika 5 e K.Penal në rast se i/e shfrytëzuara ndodhet jashtë territorit të vendit tonë. Nëse personi - femra, nxirret nga territori i vendit tonë me qëllim për ta detyruar për të ushtruar prostitucion, atëherë do të jemi para veprës penale të trafikimit të femrave.

⁴ Neni 114/b i Kodi Penal.

Duhet të theksojmë se trafikimi i femrave jo detyrimisht kërkon që femra të nxirret jashtë territorit të vendit tonë. Jemi para veprës penale të trafikimit të femrave edhe në rast se e dëmtuara transportohet apo transferohet nga një qytet në tjetrin, brenda Republikës së Shqipërisë.

Një element që vihet re në dënimin e veprës penale të parashikuar nga neni 114/b i K.Penal, është aplikimi jo vetëm i dënimit me burg, por edhe atij me gjobë. Ky është një qëndrim i drejtë duke pasur parasysh faktin që subjektet e kësaj vepre penale sigurojnë të ardhura monetare të mëdha nga shfrytëzimi i femrave dhe goditja e tyre edhe në anë ekonomike, është një e domosdoshme për të penguar aktivitetin e tyre kriminal në organizimin, drejtimin apo financimin e trafikëve të tjera. Jo më kot, organizmi, financimi, bashkëpunimi, janë elemente të anës objektive që e bëjnë këtë vepër në rrethana të cilësuar.

Duke vlerësuar rrezikshmërinë e veprës dhe autorëve të tyre organet e Prokurorisë ndaj anëtarëve të trafikimit të qënieve njerëzore dhe femrave për prostitucion duhet të reagojnë fort duke zhvilluar hetime të shpejta “agresive” dhe me masa sigurimi të rrepta.

3. TEKNIKAT E HETIMIT

Teknikat e hetimit të krimit të organizuar në formën e trafikimit të qënieve njerëzore, femrave për prostitucion ose shfrytëzimit të prostitucionit:

- Duke pasur parasysh se të dëmtuarit e veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore, të trafikimit të femrave për prostitucion ose shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese vazhdimisht janë objekt dhunë fizike e psikike, kanosje ose premtimi për t'u dhënë para ose përfitime të tjera, personaliteti i rënduar i tyre pas krimit, largimit të tyre etj, çka rrezikon të mos bëjnë dëshmi në gjyq ose të bëjnë dëshmi të gënjeshtërt, është e domosdoshme që sa më shpejt të jetë e mundur të bëhet sigurimi i provës në Gjykatë konform kërkesave të neneve⁵ të Kodit të Procedurës Penale.
- Përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve dhe filmimeve ambientale në zbatim të kërkesave të neneve⁶ 221-226 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në veprën penale të parashikuar nga neni 114 të Kodit Penal nuk mund të përdoret përgjimi i komunikimeve të personave të përfshirë në këto veprime të kundraligjshme, përgjimet telefonike të organizatave kriminale që merren me trafikimin e femrave apo edhe në rastet e shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese⁷ janë veprime hetimore shumë rezultateve që mbështeten në prova shkencore. Subjektet e krimit, të interesuar të gjejnë femra për trafikim, tregjet për tregtimin, transportimin dhe mbikëqyrjen e tyre, gjithmonë komunikojnë mes tyre nëpër mjeteve telefonike duke na dhënë mundësi për të dokumentuar veprimtarinë kriminale. Shoqërimi i kësaj teknike hetimi sipas rastit dhe me filmime ambientale të ambienteve dhe personave që zhvillojnë këtë veprimtari kriminale na jep mundësinë të provojnë me prova të pakundërshtueshme fajësinë e tyre.
- Ekspertimet mjeko-ligjore, kriminalistike, psikike të të dëmtuarave janë forma të dokumentimit shkencor që rast pas rasti policia gjyqësore dhe prokurorët aplikojnë ndaj çdo gjurme të gjetur në vendin e ngjarjes, trupin e të dëmtuarës ose çdo formë krahasimi që ndihmon në zbulimin e së vërtetës. Në rast se në veprën penale të shfrytëzimit për prostitucion jo detyrimisht kërkohet si element i veprës penale ushtrimi i dhunës fizike apo psikike ndaj të dëmtuarës, në veprën penale të trafikimit është thelbësore të provohet se e dëmtuara ka vepruar në një gjendje të tillë dhunimi të vazhdueshëm, fizik dhe psikik. Jo vetëm kaq, por ekspertimet mjeko-ligjore janë të domosdoshme për të përcaktuar jo vetëm faktin e shfrytëzimit seksual, kryerjes së marrëdhënieve seksuale, por në rastin e formave të tjera të shfrytëzimit është e domosdoshme të

5 Nenet 316-321 të Kodit të Procedurës Penale.

6 Nenet 221-226 të Kodit të Procedurës Penale.

7 Neni 114/a i Kodit Penal.

provohet dëmi që i është shkaktuar të dëmtuarës, dëmtim që mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm,⁸ ose edhe vdekja e të dëmtuarës, rrethana këto që e bëjnë të cilësuar veprën penale të trafikimit. Në këto rrethana është e domosdoshme të provohet lidhja shkakësore mes shfrytëzimit skllavërues, seksual, etj, dhe pasojës së ardhur. Për këtë arsye nevojiten ekspertime mjeko-ligjore.

- Një nga detyrimet kryesore të hetimit duhet të jetë dhe sekuestrimi i pasurive të anëtarëve të krimit që kanë si burim paratë e pista të grumbulluara nga aktiviteti kriminal. Kështu, siç e ka përcaktuar edhe ligjvënësi, në veprën penale të trafikimit të femrave krahas dënimit me burgim aplikohet edhe dënimi me gjobë, ndryshe nga vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit. Prandaj është e domosdoshme në raste të tilla të hetohet paralel edhe për gjendjen pasurore të subjekteve të kësaj vepre penale, burimit të këtyre pasurive, nëse është bërë pastrim pasurie nga këto subjekte, duke bërë transaksione për të fshehur burimin e vërtetë të këtyre pasurive. Një hetim i tillë mbi pasurinë e autorit/ve të veprës mund dhe duhet të bëhet edhe në veprën penale të shfrytëzimit në rrethana të cilësuar.

- Ndryshe nga shfrytëzimi i prostitucionit që përgjithësisht ka një shtrirje të vogël territori dhe përfshin pak persona, në shumë raste nuk evidentohen organizime të qëndrueshme, në veprën penale të trafikimit ka një shtrirje të gjerë territoriale që mund të përfshijë edhe territoret e më shumë se një shteti dhe këto janë veprimtari që kontrollohen nga organizatat kriminale të mirë organizuara. Për këtë arsye bashkëpunimi me policitë e vendeve të tjera, Interpol, FBI, është thelbësor për të siguruar një hartë të shtrirjes së aktivitetit kriminal të trafikimit, për të identifikuar grupet kriminale që merren me këtë aktivitet dhe për të koordinuar punën në mbledhjen e provave dhe goditjen njëkohësisht të autorëve të kësaj vepre që mund të shtrihet në disa vende, por edhe për të mundësuar lirimim e viktimave të këtij shfrytëzimi.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
2. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

⁸ Si në rastet e heqjes së organeve.

1. RËNDËSIA E HETIMIT TË VEPRAVE PENALE QË LIDHEM ME TRAFIKIMIN

Veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore vazhdimisht janë parë si prioritare në kuptim të vëmendjes që u kushtohet në fazën e hetimit paraprak. Natyrisht që kjo vëmendje është rritur ndjeshëm vitet e fundit edhe si rrjedhojë e një ndjeshmërie më të madhe të shoqërisë në përgjithësi ndaj këtyre fenomeneve kriminale. Përtej angazhimit në kuadër të energjive apo burimeve që vihen në dispozicion të zbulimit dhe hetimit të këtyre veprave penale, tashmë kemi arritur të akumulojmë një eksperiencë disaveçare, e cila natyrshëm na vjen sot në ndihmë për të identifikuar më mirë problematikat e lidhura me metodat e hetimit e kuadrin ligjor në fuqi.

Për t'ju përgjigjur me efikasitet luftës ndaj trafikut të qenieve njerëzore, në Prokurorinë për Krimet e Rënda është ngritur një seksion që heton kryesisht këto vepra penale. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që bëjnë pjesë në të, përveç eksperiencës që grumbullojnë përgjatë hetimit, janë trajnuar vazhdimisht në kurse që kanë pasur në fokus teknikat e hetimit për këtë grup veprash penale.

Megjithatë, duhet të pranojmë se hetimi i këtyre veprave penale ngelet tejte i vështirë për shumë faktorë që shkojnë përtej kapaciteteve njerëzore e materiale që ne jemi në gjendje të vëmë në dispozicion të luftës ndaj trafikut të qenieve njerëzore. Për shkak edhe të historisë apo zhvillimeve të vrullshme të këtyre viteve, ne ballafaqohemi sot me një seri ngjarjesh kriminale të ndodhura edhe dhjetë apo dhe pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, të cilat në shumicën dërrmuese të tyre lidhen pikërisht me trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo distancë kohore ka sjellë mjaft vështirësi në hetimin e plotë tyre, pasi nuk është aspak e lehtë të grumbullohen provat e mjaftueshme për të provuar ekzistencën e veprës penale dhe rrethana të tjera që lidhen me fajësinë e personave të vënë nën hetim pas shumë vitesh nga kryerja e krimit. Për fat të keq, kjo problematikë rëndohet edhe nga mënyrat apo format se si kryhen këto vepra penale, ku shpesh është pothuajse e pamundur të grumbullohen prova brenda vendit pasi shumica dërrmuese e rasteve të shfrytëzimit kanë ndodhur jashtë territorit të Shqipërisë. Në përgjithësi, për vetë karakteristikat e këtyre veprave penale, janë personat e dëmtuar nga vepra të cilët kallëzojnë ngjarjen kriminale në organet e zbatimit të ligjit, ngjarje që tashmë kanë përfunduar dhe ku fokusi i hetimit drejtohet nga e shkuara. Gjithashtu, në shumë raste, mungojnë dëshmitarët apo prova të tjera indiciare dhe shpesh dëshmitë apo deklaratimet e të dëmtuarve ngelen të vetmet elementë të provës që arrihen të grumbullohen. Për më tepër, shpesh të dhënat që këto deklarime apo dëshmi përmbajnë nuk janë të plota, kanë pasaktësi dhe nuk japin shumë mundësi për të grumbulluar elementë të tjerë provues ku mund të mbështetet dëshmia e personit të dëmtuar.

Megjithë sa u përmend më sipër, janë një sërë veprimet hetimore që kryhen në këto raste, të cilat në shumicën e hetimeve kryhen në kuadër të ekzekutimit të letërporosive ndërkombëtare, ku janë kryesisht autoritetet kompetente të huaja të cilat kryejnë verifikimet apo veprimet hetimore të kërkuara nga ana jonë. Për shkak edhe të paplotësisë apo pasaktësive që në përmbajtjen e kallëzimit të personit të dëmtuar, shpesh përgjigjet që vijnë janë mjaft të cingura dhe imponojnë nisjen letërporosive të reja për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, çka ndikon drejtpërdrejt në zgjatjen e hetimit. Gjithashtu duhet vënë në dukje se edhe angazhimi i autoriteteve të huaja që kryejnë këto veprime jo gjithmonë ka qenë ai që do të duhet të ishte e për rrjedhojë ajo që ne arrijmë të përfitojmë në mjaft raste është shumë pak. Kemi konstatuar se nuk na sjellin ndihmesën

¹ Drejtues i Prokurorisë për Krimet e Rënda.

e duhur verifikimet në lidhje me vendet e banimit të personave të trafikuar, ato për identifikimin e vendeve ku është ushtruar aktiviteti apo edhe verifikimet mbi shoqërime të mundshme të personave të trafikuar në polici, pasi shpesh këto të dhëna nuk gjenden, nuk ka pasur shoqërime të personave që janë shfrytëzuar (në rastet e prostitucionit) ose të dhënat e marra nga personat e dëmtuar nga vepra penale janë të pasakta dhe nuk mundësojnë identifikimin e plotë të këtyre rrethanave. Në pjesën më të madhe të çështjeve që hetohen nuk ka të dhëna për dëshmitarë të mundshëm, pasi në shumicën e rasteve viktimat nuk njohin emrat e personave që kanë pasur kontakte apo japin të dhëna të mangëta, ndërkohë që ka ndodhur shpesh që shumë nga personat e njohur prej tyre kanë qenë vetë viktimat të rasteve të ngjashme dhe shpesh emrat që janë përdorur prej tyre kanë rezultuar të rremë.

2. TË ARDHURAT E ARDHURA NGA TRAFIKU

Një tjetër problem që ndeshet në fakt edhe në mjaft raste të tjera përveç këtyre të trafikimit të qënieve njerëzore ka të bëjë me të ardhurat nga krimi, të cilat sillen në Shqipëri në rrugë informale dhe rrallë ndodh që të identifikohen apo sekuestrohen dokumente bankare apo të shoqërive të transferimit të parave që lidhen me këto vepra penale. Tashmë është e qartë për të gjithë që nivelet e larta të informalitetit të ekonomisë e favorizojnë transferimin, fshehjen e origjinës dhe investimin në biznese të ndryshme të të ardhurave nga aktivitetet kriminale. Këto probleme natyrisht që krijojnë vështirësi në hetimin e plotë të ngjarjeve, pasi dëshmia ngelet sërish prova kryesore që duhet të mbështetet nga prova të tjera, qofshin këto edhe indiciare. Një ndihmë të madhe në këtë drejtim po jep edhe ligji i ashtuquajtur “antimafia” i cili mundëson sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të trafikantëve edhe në rastet e dështimit të hetimeve apo gjykimit.

Në këto kushte, është synuar që aktiviteti hetimor të fokusohet mbi verifikime të mëtejshme brenda territorit të vendit, që lidhen kryesisht me deklarime të personave që mund të kenë ndonjë dijeni rreth faktit, si p.sh rreth njohjes së viktimës me personin e hetuar apo mbi të dhëna të mësuara nga viktimat gjatë kohës së shfrytëzimit apo më vonë. Gjithashtu, në rastet kur personat që hetohen ndodhen në Shqipëri, kur vlerësohet si e dobishme, synohet të kryhen edhe veprime hetimore si përgjimet ambientale apo telefonike, të cilat ka raste që kanë dhënë rezultate.

3. PROCESI I TË PROVUARIT

Më mirë paraqitet situata me hetimin e veprave penale të kryera vitet e fundit ku ka më tepër mundësi të grumbullohen prova me dëshmitarë apo prova dokumentare si dhe të përdoren më me efikasitet teknikat speciale të hetimit. Tashmë ne kemi edhe raste të hetimit proaktiv të këtyre veprave penale, të cilat janë dërguar edhe për gjykim. Madje nuk mungojnë rastet kur kemi arritur të kryejmë edhe hetime të koordinuara në kohë reale me autoritetet e huaja.

Mjaft vëmendje i është kushtuar kontaktit me të dëmtuarit, të cilat përveç se konsiderohen si dëshmitarët kyç të hetimit dhe gjykimit, njihen edhe me mundësitë që u ofron ligji për mbrojtje apo për të ngritur padi civile në procesin penal. Vitin e kaluar kemi pasur edhe një rast ku e dëmtuara nga vepra penale është futur në programin për mbrojtjen e dëshmitarit. Tashmë kemi edhe një oficer të policisë gjyqësore të ngarkuar për të pasur kontakte të vazhdueshme me viktimat përgjatë gjithë fazës së hetimit dhe gjykimit.

Gjatë vitit 2011 kemi pasur një ulje të numrit të regjistrimeve për çështje që lidhen me trafikimin, ndërkohë që konstatojmë sërish referime të paplota nga policia gjyqësore. Ndeshemi shpesh me kallëzime të prindërve të cilët dyshojnë për mundësi të trafikimit të fëmijëve të tyre, por që janë të pambështetura nga të dhëna të tjera që lejojnë regjistrimin e procedimit penal. Megjithatë ne kemi synuar në çdo rast të orientojmë policinë gjyqësore që të vazhdojë me verifikime të tjera të cilat të krijojnë hapësirat për regjistrimin e

procedimit penal. Megjithëse ka një përmirësim të ndjeshëm, ende kemi raste të ndalimeve apo arrestimeve të nxituara nga ana e prokurorive në rrethe apo policisë për rastet e trafikimit. Përveç se ato shpesh nuk janë në përputhje të plotë me ligjin procedural, kufizojnë shumë mundësinë e përdorimit të teknikave speciale të hetimit, ndërkohë që në planin afatgjatë, kur çështja lidhet me ekzekutimin e letërporosive për jashtë shtetit, afatet e paraburgimit zgjaten deri në kufijtë e afateve ligjore, duke sjellë dhe dëme të mëdha në planin financiar për shtetin kur çështja duhet të pushohet për mungesë provash. Pikërisht për këto arsye duhet vepruar me shumë kujdes në lidhje me kufizimin e lirisë së personit nën hetim në këto çështje, ndërsa ngelet ende një sfidë shtimi i rasteve të sigurimit të provës në gjykatë, pasi është mjaft e vështirë për organet e ndjekjes penale të gjenden provat e kërkuara nga ligji procedural për të justifikuar një kërkesë të tillë para gjykatës, ndërkohë që rastet e ndryshimit të thënieve të mëparshme nuk janë të pakta.

4. NDRYSHIMET E KUADRIT LIGJOR DHE PROBLEMET E PRAKTIKËS GJYQËSOR QË LIDHEN ME TO

Përveç vështirësive të hetimit, vetë kuadri ligjor paraqet disa probleme që mund të shtrohen për diskutim. Ndryshimet e bëra në Kodin Penal, sidomos ato të viteve 2001 e 2004 që lidhen me dispozitën e “trafikimit të femrave”,² krijuan probleme në disa drejtime. Së pari, u krijua një dualizëm mes kësaj dispozite dhe³ nenit 114/a, “shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”. Ende dhe sot nuk është bërë e mundur të hiqet një vijë ndarëse e qartë mes këtyre dy dispozitave, pasi besojmë se për këdo specialist të fushës është e qartë se neni 114/b i përmban të gjithë elementët e anës objektive të nenit 114/a. Kjo sipas mendimit tonë ka krijuar konfuzion dhe ka çuar në interpretime të sforcuara nga prokuroritë dhe gjykatat. Fillimisht është ndjekur interpretimi sipas të cilit neni 114/a do të aplikohet në rastet kur mendimi kriminal ka lindur dhe veprimet e kundërligjshme janë konsumuar tërësisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo kur nuk ka pasur zhvendosje të të dëmtuarës, pra krimi është kryer tërësisht brenda territorit të vendit. Për mendimin tonë ky është një interpretim i bërë në kushtet e ekzistencës së dy figurave të veprës penale, ana objektive e të cilave përputhet në pjesën më të madhe, ndërkohë që vetë neni 114/b është mjaft i zgjeruar në kuptim të formave që parashikon, si p.sh rekrutimi, transporti, shfrytëzimi etj. Për rrjedhojë logjike, çdo interpretim që bëhet për dallimin mes dy dispozitave është i sforcuar dhe vështirë se mund të ketë koherencë në qëndrimet e mbajtura nga organet ligj zbatuese.

Kohët e fundit, të paktën në Prokurorinë për Krimet e Rënda, është ndjekur edhe një tjetër interpretim që besojmë është më i drejtë se i pari dhe që lidhet me konsensusin e femrës që ushtron prostitucion. Në rastet kur konstatohet se ka një marrëveshje mes femrës dhe personit që e shfrytëzon, pra femra nuk ka qenë e shtrenguar të hyjë në një marrëdhënie të tillë si në rastet që parashikon neni 114/b i kodit, është bërë cilësimi juridik sipas nenit 114/a të kodit. Për këto arsye mendojmë se ka nevojë për ndryshime tek këto dispozita. Ne vlerësojmë se ka vend që të dyja dispozitat të vazhdojnë të qëndrojnë të veçuara, por dallimi mes tyre duhet bërë më i qartë. Si kriter themelor ndarës duhet që të shërbejë pikërisht vullneti i femrës për të ushtruar ose jo prostitucion, ndërkohë që mund të bëhen rregullime të caktuara tek neni 114/a.

Një tjetër problem i hasur ka qenë edhe aplikimi i nenit 114/b kur veprimet e kundërligjshme kanë nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në kod (viti 2001) dhe kanë vazhduar më tej, ose në rastet kur ka vazhduar edhe pas ndryshimeve të vitit 2004. Këto situata kanë krijuar mjaft konfuzion dhe kanë çuar në interpretime të ndryshme. Një nga qëndrimet ka qenë ai i cili ka konsideruar se janë konsumuar dy vepra të ndryshme penale, si 114/a, pra shfrytëzimi prostitucionit në rrethana rënduese ashtu edhe 114/b, trafikimi i femrave për periudhën pas ndryshimeve në ligj. Ka pasur edhe qëndrime të cilat i kanë kualifikuar veprimet kriminale sipas nenit 114/a të kodit. Mendojmë se saktësimi i dallimit mes dy dispozitave do të ndihmonte në zgjidhjen deri diku të problemit të krijuar, pasi është mjaft e vështirë të përcaktojmë se cili nga dy qëndrimet do të ishte më i drejti.

² Neni 114/b, i Kodit Penal.

³ Neni 114/a, i Kodit Penal.

5. RRETHANAT CILËSUESE NË VEPRËN PENALE TË TRAFIKIMIT

Një tjetër problem që vlen të diskutohet ka të bëjë me rrethanat cilësuese të nenit 114/b, si p.sh. kryerja më tepër se një herë e veprës apo bashkëpunimi. Praktika e deritanishme me të drejtë ka konsideruar se do të konsiderohet si e kryer më tepër se një herë kjo veprë kur nuk ka një dënim të mëparshëm për episodet e mëparshme. Problemi qëndron tek masa e dënimit që aplikohet pasi në rast se personi është recidivist merr një dënim në minimum 7 vjet burg, ndërkohë që nëse e ka kryer dy ose më tepër herë këtë krim, pa u dënuar për ndonjërin nga rastet, dënohet me të paktën 15 vite burg. Këtu mendojmë se ka nevojë për ndërhyrje pasi duket krejt e paarsyeshme të bëhet një diferencim kaq i madh dhe të dyja situatat duhet të vlerësohen në mënyrë të përafërt. Vetë Kodi Penal dënimin e mëparshëm për një veprë penale e cilëson si një rrethanë rënduese e që mbahet parasysh në caktimin e masës së dënimit, ndërkohë që sipas rregullimit aktual ligjor të nenit 114/b, kjo kthehet në favorizuese për subjektin e veprës penale, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta.

Edhe në rastin e bashkëpunimit, ne e shohim si mjaft të lartë minimumin që parashikon ligji pasi nuk ka asnjë justifikim që personi të marrë dyfishin e dënimit për një rrethanë që kodi e vlerëson si rënduese në shumicën e dispozitave dhe madje edhe në rastin e dispozitave ku bashkëpunimi parashikohet si rrethanë cilësuese, diferenca në masat e dënimit është dukshëm më e ulët, si p.sh rasti i trafikimit të lëndëve narkotike. Ky parashikim ligjor duket edhe më absurd nëse do të merrnim parasysh rastet kur vepra kryhet në kuadër të grupit të strukturuar, ku subjekti mund të dënohet më pak se në rastin e një bashkëpunimi të thjeshtë.

Kemi mjaft raste kur individë që në bashkëpunim arrijnë të rekrutojnë një femër për ta shfrytëzuar për prostitucion por pa arritur të avancojnë më tej në shfrytëzimin e të dëmtuarës, dënohen më shumë se një person që ka arritur ta shfrytëzojë të dëmtuarën, dhe kjo për shkak të diferencës së madhe në marzhet e dënimit mes paragrafëve përkatës. Sërish mendojmë se është e pajustificueshme që organizuesi apo financuesi i trafikimit të femrave të dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg, ndërsa në rastin e bashkëpunimit të thjeshtë dënimi është sërish më i lartë.

Këto probleme si dhe çështje të tjera që besojmë se do të ngrihen nga pjesëmarrësit në konferencë do të demonstrojnë nevojën për një reformulim tërësor të neni 114/b të Kodit Penal, i cili duhet të thjeshtohet në përmbajtjen e tij, duke marrë parasysh natyrisht dhe kontradiktat që ai krijon me nene të tjerë të Kodit Penal.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Saida DOLLANI¹

1. PËRKUFIZIMI I KRIMIT “TRAFIKU I FEMRAVE” DHE FORMAT E NDRYSHME TË KËSAJ VEPRIMTARIE KRIMINALE, TË SHFAQURA NË PRAKTIKË

Sipas përkufizimit të nenit 3 të Protokollit shtesë të Konventës së Kombeve të Bashkuara, “kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” të 2000, njohur ndryshe si Konventa e Palermos, trafikimi i qenieve njerëzore paraqitet nga germa (a) si ajo veprimtari që konsiston në “rekrutimin, transportin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës dhe formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vunerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi”. Ky përkufizim konstituon bazën ligjore për detyrimin e penalizimit të sjelljeve të paligjshme që nga Shtetet nënshkruese është vendosur të marrin përsipër ta respektojnë sipas parashikimit të nenit 5 të Protokollit,² dhe që Shteti ynë si palë e Konventës e ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm penal duke e parashikuar, me të njëjtat terma përkufizues si edhe Konventa, në nenet 110/a si “trafik i personave”; 114/b si “trafik i femrave” dhe 128/b si “trafik i të miturve”.

Tashmë e vënë në dukje shprehimisht edhe nga relacioni shpjegues i Konventës së Varshavës se, ‘trafikimi i qenieve njerëzore formon një nga format moderne të së vjetrës tregti botërore të skllavërve’,³ edhe trafikimi i femrave, duke qenë se përfshihet në fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, është një nga format e skllavërisë moderne, por që krahasuar me atë historike paraqet karakteristika thelbësisht të ndryshme. Kështu, ndërsa skllavëria historike ka qenë e ligjshme dhe e lejueshme sot skllavërimi i qenieve njerëzore është i paligjshëm dhe aspak i lejueshëm. Përveç ndryshimeve esenciale që kanë nga njëra-tjetra, skllavëria historike dhe ajo moderne kanë një tregues të përbashkët po ashtu thelbësorë, karakterin fitimprurës, i radhitur i treti, pas trafikimit të armëve dhe trafikimit të lëndëve narkotike, trafikimi i personave, ku përfshihet edhe ai i femrave me qëllim shfrytëzimin në çdo formë të tyre, “konstituon një treg të paligjshëm që bën që organizatat kriminale të fitojnë miliarda dollarë në vit”.⁴

Eksperienca, bën të njohur faktin se rekrutimi i femrave kryhet në vendet e varfra apo ato në zhvillim, sidomos të atyre vendeve, ku edhe ne bëjmë pjesë, të një tranzicioni ekonomik, si pasojë e një transformimi të thellë politiko-ekonomik, të cilat kanë pësuar një ndryshim të shpejtë të kushteve të jetesës si pasojë e rënies së regjimeve diktatoriale.⁵

Autorët e krimit shfrytëzojnë varfërinë e femrave të gatshme për të emigruar dhe shpresën e tyre për një të ardhme më të mirë në shtetet ku do të emigrojnë, për t’i rekrutuar me premtime të gënjeshtërtë për martesë. Dalja e femrave të rekrutuara nga Republika e Shqipërisë dhe hyrja në shtetet e tjera, mund të ndodh si në mënyrë të ligjshme ashtu edhe në mënyrë të paligjshme, d.m.th. duke përdorur autorët e krimit rrugët jashtë

1 Gjyqtare e Gjykatës së Apelit për krime të Rënda, Tiranë.

2 Questione linguistico-traduttiva: il traffico di esseri umani- Marianna Angelillo, në adresën: www.Englishfor.it.

3 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D’EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSEERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

4 Traffico di esseri umani e tratta di persone. Azioni di contrasto integrate tra tutela della persona ed esigenze investigative- Dott. David Mancini, në adresën: www.altalex.com.

5 Traffico di esseri umani e tratta di persone. Azioni di contrasto integrate tra tutela della persona ed esigenze investigative- Dott. David Mancini në adresën: www.altalex.com.

pikave të kontrollit kufitar. Për pasojë viktimat femra fillimisht i nënshtrohen një gjendjeje skllavërie apo shtrëngohen me dhunë, duke u vendosur në një situatë varësie dhe, pastaj shfrytëzohen.⁶ Shqipëria është një vend ku më i përhapur është rekrutimi i femrave me qëllim shfrytëzimin për prostitucion në vendet e perëndimit, më së shumti në Itali, Greqi e Belgjikë.

Në legjislacionin tonë të brendshëm penal krimi i trafikimit të femrave është futur me *ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 30*. Në vështrim të dispozitës sipas këtij ligji, duhet thënë se norma penale nuk shpjegonte saktësisht termat përkufizues të trafikimit të femrave e, në këtë mënyrë nuk individualizoheshin qartësisht se, cilat ishin veprimet e paligjshme që klasifikoheshin në këtë krim. Për këtë, në praktikë disa kolegje gjyqësore iu referuan Protokollit shtesë të Konventës së Palermos në vjeljen e termave ligjorë për të individualizuar veprimet e subjektit përkundrejt të cilit procedohej për veprën penale të 'trafikimit të femrave'. Ky orientim i jurisprudencës bazohej në nenin 122 të Kushtetutës, i cili shprehimisht parashikonte se marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar pasi botohet në Fletore Zyrtare përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Duhet të vihet në dukje se, në zbatim të Konventës ligjvënësi i zakonshëm nxori ligjin *nr.8733, datë 24.1.2001*, duke e bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm penal krimin e 'trafikimit të femrave', për çka plotësisht e lejueshme zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës në vjeljen e termave ligjorë të përkufizimit të këtij krimi.

Në vitet pasardhëse Kodi Penal u reformua nga neni 2 i ligjit nr. 9188 datë 12.2.2004. Tashmë dispozita e nenit 114/b të K.P., posedon pikërisht normativën e duhur, duke shpjeguar qartësisht termat përkufizues që, siç edhe thuhet tashmë edhe në relacionin shpjegues të Konventës Evropiane, trafikimi i qënieve njerëzore, pra edhe i femrave, është bashkimi i elementeve në përkatësi të tre kategorive: veprim, mjet, qëllim.⁷

Sipas përkufizimit që neni 114/b i Kodit Penal, i bën trafikimit të femrave duhet thënë se kjo veprë penale është kombinim i tre elementeve bazë jo të veçuar nga njëri-tjetri, të cilët gjenden shprehimisht të treguara në përkufizimin e dispozitës, ku tre elementët janë:

1. **veprimi** i: "rekrutimit, transportimit, transferimit fshehjes ose pritjes së personave";
2. **nëpërmjet mjetit** të, kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër;
3. **qëllimi**: me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose të shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.⁸

Me vështrimin tek normativa e nenit 114/b të Kodit Penal, duke qenë se në praktikën gjyqësore të gjykatave për krime të rënda ka pasur çështje juridike debatuese, nëse kjo veprë penale thith apo konkurron veprat penale të parashikuara nga nenet 114 e 114/a të Kodit Penal, shkurtimisht dëshiroj të sjell dy orientimet të formuara mbi këtë çështje nga jurisprudenca e kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Një orientim është ai që çmon se, vepra penale e parashikuar nga neni 114/b thith veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit. Pra, atje ku sjellja e paligjshme e rekrutimit, transferimit, fshehjes ose pritjes së femrës me mjetet e treguara nga neni 114/b, është përmbushur me qëllim shfrytëzimin e femrës dhe po ashtu nga i njëjti subjekt kriminal edhe është shfrytëzuar për prostitucion, përveç aplikueshmërisë së normës së nenit 114/b nuk ngrihet çështja e raporteve me rastin e 'shfrytëzimit', duke u konsideruar shfrytëzimi i prostitucionit të femrës së rekrutuar, transferuar, fshehur ose pritur, si pjesë përbërëse e veprimeve të trafikimit. Kështu, kolegji penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: "*E ndjera S., në shtetin italian ushtronte prostitucion... Gjykata e Chiavarit në Itali,*

6 Traffico di esseri umani e tratta di persone. Azioni di contrasto integrate tra tutela della persona ed esigenze investigative- Dott. David Mancini në adresën: www.altalex.com.

7 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D'EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

8 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D'EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

pasi ka shqyrtuar çështjen në ngarkim të të gjykuarit G. H. të akuzuar se para dhe pas vitit 2002 ka shfrytëzuar për prostitucion të dëmtuarën S. K., me vendimin nr. 273/5 e ka deklaruar atë të pafajshëm...Ndërkohë, vepra penale për të cilën gjykata shqiptare e ka deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin G.H. dhe që është trafikimi i femrave, parashikuar kjo nga neni 114/b-2 i Kodit Penal, ka si qëllim shfrytëzimin e femrës për prostitucion. Nëse nga një vendim përfundimtar të një gjykate të huaj konkludohet se e dëmtuara S. nuk është shfrytëzuar nga i gjykuari për ushtrim prostitucioni, edhe konkluzioni i gjykatës se ky person e ka rekrutuar të dëmtuarën me qëllim prostitucioni, nuk qëndron’⁹

Orientimi tjetër i jurisprudencës është ai që të dyja këto norma janë konkurruese. Pra, atje ku sjellja e rekrutimit, transferimit, fshehjes ose pritjes së femrës me mjetet e treguara nga neni 114/b është përmbushur me qëllim shfrytëzimin për prostitucion dhe, po ashtu, nga i njëjti subjekt kriminal edhe është shfrytëzuar për prostitucion, vepra quhet e përfunduar që në momentin e rekrutimit, transferimit, fshehjes ose pritjes, duke mos i konsideruar veprimet e shfrytëzimit për prostitucion si veprime të cilat përbëjnë figurën e veprës penale të trafikimit për prostitucion, por si provë që vërteton qëllimin për shfrytëzimin e prostitucioni të rekrutimit apo transferimit apo fshehjes ose pritjes së femrës. Sipas këtij orientimi të jurisprudencës, veprimet e paligjshme të shfrytëzimit për prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë cenojnë një tjetër dispozitë penale dhe pikërisht atë të parashikuar nga neni 114/a pika 5 e Kodit Penal, ndaj personi që edhe e shfrytëzon femrën e trafikuar duhet të përgjigjet edhe për këtë veprë penale. Kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se “Në arsyetimin e saj, ndryshe nga sa pranohet nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit konsideron se vepra penale e trafikimit të femrave për prostitucion nuk është kryer duke e keqtrajtuar dhe detyruar të dëmtuarën me dhunën fizike. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të rënda Tiranë: ‘...keqtrajtimi dhe detyrimi i të dëmtuarës me dhunë fizike në eventualitetin e ekzistencës së tyre ka rezultuar në një moment të dytë, pas konsumimit të veprës penale të trafikimit prej të pandehurit T, është përdorur në funksion të shfrytëzimit të prostitucioni, veprë e parashikuar nga neni 114/a/4,5 të Kodit Penal veprë për të cilën nuk rezulton të jetë akuzuar prej organit të prokurorisë’... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se nga të gjitha aktet provuese mbi të cilat janë bazuar vendimet e gjykatave ka rezultuar në mënyrë të qartë se trafikimi i të dëmtuarës F. Prej të pandehurit D. është realizuar jo nëpërmjet dhunës në të gjitha fazat e shfaqjes së veprës penale të trafikimit siç janë rekrutimi, transferimi etj, ashtu siç me të drejtë ka arsyetuar në vendimin e saj Gjykata e Apelit për Krime të Rënda... Duke pasur parasysh përcaktimin që i bëhet veprës penale të trafikimit të femrave në nenin 114/b të Kodit Penal, del qartë se ajo konsiderohet e konsumuar me vërtetimin e faktit të trafikimit të femrës, nëpërmjet mashtrimit, me qëllim shfrytëzimin e saj për prostitucion dhe nuk ka rëndësi nëse personi i dëmtuar nga vepra penale ka ushtruar prostitucion ose jo dhe nëse i ka sjellë përfitime të gjykuarit kjo veprimtari”¹⁰

Pavarësisht orientimit të dytë, nuk evidentohet rast praktik që nga akuzat të jenë veçuar veprimet e trafikimit të femrave nga ato të shfrytëzimit për prostitucion.

2. TRAFIKIMI I BRENDSHËM I QENIEVE NJERËZORE

Trafikimi i qenieve njerëzore mund të praktikohet si brenda territorit të një vendi ashtu edhe jashtë kufijve të tij.

Nga artikulli që Konventa e Palermos i bën krimit të organizuar duket se trafikimi i femrave ka të bëjë me territoret e shumë shteteve, çka ka sjellë që në praktikë vepra penale e trafikimit të femrave të jetë kuptuar si një veprë penale ndërkombëtare.

Në të vërtetë, siç thuhet edhe në relacionin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore’ nënshkruar nga Palët në Varshavë më 16.05.2005 dhe, e bërë të ekzekutueshme për Shqipërinë me ratifikimin e saj me ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006, ‘trafikimi i qenieve

⁹ Citim nga vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2009-71 (292) datë 20.05.2009.

¹⁰ Citim nga vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2010-728 (403) datë 28.04.2010).

njerëzore nuk përmban domosdoshmërisht një element transnacional dhe mund të ekzistojë në nivel pastërtish nacional'.¹¹

Koncepti i trafikimit të brendshëm është normuar në dispozitën e nenit 2 të Konventës së Këshillit të Evropës “për Masat Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, e cila shprehimisht parashikon se ‘Kjo Konventë do të zbatohet për të gjitha format e trafikimit të qënieve njerëzore, qoftë **kombëtare** ose transnacionale, të lidhura apo jo me krimin e organizuar’. Është e qartë se siç shprehimisht parashikohet edhe nga neni 39 i Konventës, ajo synon të forcojë Protokollin e Palermos dhe ka një fushë më të gjerë zbatimi pikërisht duke përfshirë edhe konceptin e trafikimit të femrave, si qenie njerëzore, të konsumuar edhe brenda territorit kombëtar.¹²

Gjithashtu, edhe për sa i përket termit ‘transportim’, si një nga format e veprimit kriminal të trafikimit të femrave, duhet thënë se Konventa nuk kërkon që të këtë një kalim të kufijve që kjo të konsiderohet si element përbërës i trafikimit të qënieve njerëzore. Po ashtu, e thënë edhe më sipër, Konventa nuk kërkon aspak, që në rastet e trafikimit ndërkombëtar, pra kur vepra penale e trafikimit të femrave ka filluar në një Shtet, p.sh. rekrutuar në Shqipëri, dhe vazhdon të kryhet në një tjetër Shtet, p.sh. pritur në Itali, që viktima të këtë hyrë ilegalisht në atë Shtet. Mund të jetë pra, trafikim i femrave edhe kur një kufi ndërshtetëror është kaluar ligjërisht apo prezenca mbi territorin e Shtetit tjetër është e ligjshme”.¹³

E përcaktuar fusha e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës “për Masat Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore” nga neni 2, i cili parashikon që Konventa aplikohet qoftë për trafikimin ndërkombëtar ashtu edhe për atë kombëtar, e duke qenë se nga Konventa nuk kërkohet që ligjvënësi i brendshëm të parashikojë në dispozitë penale shprehimisht fushën e zbatimit të saj, por vetëm kërkon parashikimin si penalisht të ndëshkueshëm të trafikimit, vepër penale tashmë e parashikuar nga ligjvënësi ynë, koncepti i trafikimit të brendshëm të femrave vilet pikërisht nga kjo Konventë, sipas nenit 122 të Kushtetutës.

Kështu, në praktikë janë evidentuar rastet e rekrutimit e të femrës me anë të mashtrimit të cilat pasi i kanë vendosur në gjendje skllavërie, duke mos arritur t’i kalonin jashtë kufijve shtetëror, subjektet kriminale kanë shfrytëzuar punën e tyre brenda territorit kombëtar.

Po kështu, nga eksperiencia gjyqësore është evidentuar rasti i rekrutimit të femrave me qëllim shfrytëzimin si prostituta në Kosovë, por duke qenë se për shkaqe të pa varura nga vullneti i tyre subjektet kriminale nuk mundën t’i transferonin jashtë kufijve të Shtetit, brenda territorit të Shqipërisë ia kaluan kontrollin e tyre subjekteve të tjera kriminale, për çka dhe janë ndëshkuar sipas parashikimit të nenit 114/b të Kodit Penal.

3. PROBLEME TË PRAKTIKËS GJYQËSORE

Trafikimi i femrave, nxjerrë nga numri i gjykimeve, në eksperiencën e gjykatave për krime të rënda, përfaqëson një nga rastet e paligjshmërisë së trafikimit të qënieve njerëzore që drejtësia thirret për tu marrë më shpesh.

Proceset në lidhje me këtë fakt të paligjshëm bëjnë të dalin në dritë nga njëra anë vulnerabiliteti i femrës që është viktimë dhe nga ana tjetër autorët e faktit të paligjshëm që janë në rastet më të shumta dy persona individ meshkuj, por edhe grupe të përbëra nga tre e më shumë persona.

11 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D’EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

12 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D’EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

13 Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D’EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197 – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it.

Karakteristika më e shpeshtë e krimit të trafikimit të femrave është që ajo buron nga rastet në të cilat autori përfiton nga gjendja apo raportet intime të vendosura me viktimën e, në radhë të dytë vijnë rastet në të cilat autori përfiton nga gjendja ekonomike apo sociale vulnerabël e femrës.

Me krijimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe asaj të Apelit për Krime të Rënda, duhet thënë se, një njohje më e specializuar e fenomenit të trafikimit ka ndodhur, çka vërehet edhe me zgjidhjen e problematikave të hasura në praktikë.

Kështu, në procesin penal, dëshmia e personit/femrës të dëmtuar nga vepra penale është quajtur e mjaftueshme për të dhënë një vendim fajësie, megjithatë në këto raste gjykata ka kryer një vlerësim të detajuar të pohimeve si në profilin objektiv ashtu edhe në profilin subjektiv, sepse ka pasur parasysh edhe interesin që viktima ka për të shpënë deri në fund gjykimin. Pohimet e të dëmtuarës janë vlerësuar mbi të gjitha nga këndvështrimi logjik dhe koherent të vetë tregimit, duke iu nënshtruar shqyrtimit të gjykatës besueshmëria qoftë e jashtme – përputhja me prova apo indicie të tjera – ashtu edhe e brendshme e dëshmitares. Pra, gjatë procesit është proceduar në konstatimin nëse deklaruesja/dëshmitarja është një person i besueshëm, duke dalë në pah në raste të tilla arsyet e kallëzimit, defektet e saktësisë, njohja apo kujtesa, personaliteti i subjektit, mbi të gjitha për të kuptuar, nëse është e prirur për të gënjer. Kritika e besueshmërisë së dëshmitarit të vetëm mund të kalojë para së gjithash, nga një gjykim mbi vetë dëshmitaren dhe në veçanti mbi arsyet e zgjedhjes së denoncimeve të fakteve.¹⁴

Në lidhje me dëshminë e të dëmtuarës, e cila e rekrutuar me anë të mashtrimit nga subjekti kriminal, dhe më pas e mbajtur nën petkun e bashkëjetueses ose bashkëshortes dhe e shfrytëzuar si prostitutë prej tij, janë vërejtur dy orientime në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

Kështu, ndërsa për gjykatën e krimeve të rënda dhe atë të apelit për krime të rënda, në të gjitha rastet dëshmitarja, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë është dëmtuar nga vepra penale e trafikimit, është quajtur viktimë e vënë në gjendje skllavërie dhe, për pasojë, ky burim prove i “papërfshuar nga detyrimi për të dëshmuar”,¹⁵ nga Gjykata e Lartë jo gjithmonë është e konsideruar e tillë.

Një orientim mazhoritar i jurisprudencës së Gjykatës së Lartë është pikërisht që e dëmtuara duhet të çmohet sipas normimeve të nenit 153 të K.Pr.Penale, pra si dëshmitare, pasi ajo nuk përfshihet në rrethin e personave që “përfshihen nga detyrimi për të dëshmuar”.

Ndërsa orientimi tjetër, duke mos e konsideruar femrën viktimë, ka konsideruar se prova e dëshmisë është marrë në kundërshtim me ligjin e nuk mund të përdorej si e tillë, në vështrim të nenit 151/4 e 380 të K.Pr.P., megjithëse në fakt është vërejtur mos bërja e njohur femrës së shfrytëzuar e të drejtës për të mos dëshmuar e parashikuar për bashkëjetuesen.¹⁶ Kështu, kolegji penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: “...*ligjëvënësi i ka njohur një status të veçantë bashkëshortit, ish bashkëshortit, bashkëjetuesit apo personit të lidhur me birësim me të pandehurin në një procedim penal, duke e bërë të detyrueshme për organin procedues që në çdo rast, edhe kur kallëzimi i veprës penale të jetë bërë nga këta subjekte, në momentin e administrimit të dëshmisë atyre duhet t’i bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar. Duke iu referuar Kodit të Familjes, bashkëjetesa do të duhet të interpretohet si një situatë fakti, ekzistenca e të cilës në vështrim të nenit 158/ç të K.Pr.Penale do të duhet të verifikohet rast pas rasti nga ana e organit procedues....*”¹⁷

Një fenomen që i evidentuar nga praktika gjyqësore është edhe tolerimi nga ana e femrave të trafikuar, që për arsye të frikës apo turpit, nuk i denoncojë menjëherë faktet, dhe kur ndodh që pas një kalimi kohe viktima vendos të kallëzojë faktet në prokurori apo policinë gjyqësore, kjo sjellje e vonuar mund të rrezikojë që të interpretohet në dëm të shpalljes së drejtësisë penale. Dyshimi që mund të gjejë ‘fole’ është në lidhje

14 *Violenze alle donne: dal fatto al processo- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.*

15 Neni 158 i Kodit të Procedurës Penale.

16 Germa ç, pika 1, neni 158, i Kodit të Procedurës Penale.

17 Citim nga vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2008-102 (555) datë 03.12.2008.

me qëllimin që ka nxitur gruan të denoncojë e që përdoret si instrument presioni nga pala e akuzuar në përcaktimin e besueshmërisë së dëshmitares.

Një tjetër ngarkesë negative për besueshmërinë e të dëmtuarës është që nga vonesa e tregimit të fakteve mund të ketë mospërputhje të tilla që, megjithëse nuk ndikojnë në mënyrë të rëndësishme mbi faktin penal, ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitares.¹⁸

Legjislacioni ynë penal, në paragrafin e tretë të nenit 114/b, parashikon trafikimin e femrave në rrethanën rënduese edhe të dhunës fizike, ndaj në çdo rast të mundur ku dhuna ka lënë shenja të jashtme fizike, duhet që femra të mos hezitojë të bëjë diagnostikimet e menjëhershme të ekzistencës së lëndimeve të rënda. Dëshmia mjekësore mund të përfaqësojë një mbështetje të vlefshme të akuzave, edhe kërkesa e ndërhyrjes së menjëhershme të forcave policore, atje ku është e mundur, mund të kontribuojë në përf forcimin e dëshmisë së të dëmtuarës.¹⁹

Në praktikë mund të hasen probleme nga mënyra e përdorur e verbalizimeve të kallëzimeve. Tashmë, duket si një problem i superuar, por ka ndodhur që gjatë kallëzimit të ngjarjes së paligjshme nga e dëmtuara, organi procedues të jetë mjaftuar vetëm me mbajtjen e një procesverballi të tillë, pa vazhduar më tej me pyetjen apo marrjen e deklarimeve si person që di për rrethanat e çështjes, me qëllim që të tilla deklarime të mund të përdoren në gjykim në rastet, kur dëshmitarja për arsyt që parashikohen nga pika 3 e nenit 369 e K.Pr. Penale, nuk mund të dëgjohet në proces.

Po ashtu, edhe gjuha e përdorur gjatë verbalizimit të deklarimeve të viktimës ka rëndësi dhe është e përshtatshme që ato të verbalizohen ashtu sikundër thuhet, qoftë edhe në dialekt, pa filtrime nga ai që përpilon aktin, me qëllim që kur përdoren këto deklarime sipas nenit 362 të K.Pr. Penale, të mos lënë hapësira për të shkaktuar mungesën e besueshmërisë së dëshmitares. Një zgjidhje e kësaj vështirësie praktike është – siç për të gjitha deklaratimet në fazën e hetimeve paraprake – jo vetëm të dokumentimit në procesverbal me dorëshkrim por edhe në riprodhim audioviziv.²⁰

Gjithashtu, nuk duhet të hezitohet nga ana e viktimës të shpalesë të gjitha faktet dhe rrethanat që ajo njeh, sepse në një mënyrë apo në një tjetër ato janë në favor të besueshmërisë së deklarimeve. Nga praktika është parë e vlefshme që tregimi qoftë edhe për vendet e ushtrimit të prostitucionit në shtetet ku ato i kanë trafikuar kanë bërë që hetimet mbi këto rrethana të japin rezultate të tilla në proces/gjykim, të cilat kanë shpënë në konfirmimin e vërtetësisë së deklarimeve.

Qendra e vërtetë e formimit të provës dëshmi pa dyshim që është diskutimi në proces ku dëshmitarja i nënshtrohet shqyrtimit të prokurorit, mbrojtësit dhe të pandehurit. Ajo që shpesh ndodh është se viktima mund të mosbesohet në dëshminë e saj apo të ndihet e turpëruar nga ajo që i ka ndodhur. Mbrojtja, në ushtrim plotësisht të ligjshëm të detyrës së saj, e zë ngushtë të dëmtuarën, duke kërkuar të mbledhë në përgjigjet e femrës së trafikuar gjithë pasiguritë dhe mospërputhjet e saj. Kështu, mund të ketë pyetje drejtuar dëshmitares, të cilat i kushtojnë bezdi që përpara publikut të ekspozojë fakte të dhimbshme që sidoqoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë cenuar dinjitetin e saj, çka mund ti ngjallin vuajtje dhe indinjatë e që mund ta shpërqendrojnë atë.²¹ Një ndihmë e shmangies së gjithë kësaj vuajtjeje mund të jetë zhvillimi i procesit me dyer të mbyllura, për aq sa është e mundur, neni 340 i K.Pr.P. si dhe neni 7 dhe 8 i ligjit për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda, çka eviton ndër të tjera, por që është më thelbësorja, shtrembërimin e dëshmisë së viktimës.

Kodi i procedurës penale parashikon institutin e sigurimit të provës ku përcakton në geramat a) e b) të pikës 1 të nenit 316, sigurimin e marrjes së dëshmisë së një personi gjatë fazës së hetimeve paraprake, apo marrjen

18 *Violenze alle donne: dal fatto al processo- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.*

19 *Violenze alle donne: dal fatto al processo- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.*

20 Pika 3, neni 115 Kodit të Procedurës Penale.

21 *Violenze alle donne: dal fatto al processo- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.*

e dëshmisë si veprim i ngutshëm sipas nenit 336 të K.Pr.P. Në praktikë evidentohen rastet kur gjykata nuk pranon kërkesën e prokurorit për sigurimin e provës dëshmi të të dëmtuarës duke kërkuar prova faktike të kërcënimit apo dhunës së dëshmitares. Në fakt duhet të merret në konsideratë që nga vepra penale e dëmtuara tashmë ndihet me të vërtetë e kërcënuar, dhunuar qoftë edhe psikologjikisht.

Në procesin penal garancitë i referohen thellësisht - edhe në dëgjim të opinionit publik- të akuzuarit. Për të akuzuarin garancitë konsistojnë më së shumti në mundësinë për tu mbrojtur nga akuza false. Procesi duhet t' i sigurojë të akuzuarit mundësinë për tu njohur me aktet e akuzës dhe të mundet të organizojë një mbrojtje të përshtatshme, në këtë kuptim garancia jepet nga metoda e kontradiktoritetit.²²

Në lidhje me viktimën gjykimi ka si qëllim riparimin e lëndimit të pësuar. Nga ky këndvështrim shpërblimi i dëmit mund të jetë një zgjidhje për të lënduarën nga vepra penale, por që është evidentuar vetëm në një rast të kërkohej dhe që nga gjykata penale është vendosur veçimi i padisë civile nga ajo penale. Megjithatë, riparimi i asaj që ka pësuar viktima nëpërmjet shpërblimit të dëmit, nuk është e mundur të jetë plotësisht i rikuperueshëm, 'sepse lëndimi prek atë komponent më të thellë dhe më kompleks të strukturës njerëzore, siç është dinjiteti'.²³

Nga këndvështrimi ekstremisht konkret, procesi dhe vendimi janë një rrugë dhe një rezultat i një debati, në të cilin për fat të keq jo gjithmonë fiton e vërteta e fakteve.

Viktimat nga vepra penale shpresojnë të njihen gjatë procesit si mbajtës të së drejtave (në këtë kuptim mund të shpjegohet shpresa e tyre në drejtësinë). Procesi mund të transformojë një jetë të mohuar apo të shkelur me këmbë në një identitet të viktimës dhe mund ta bëjë atë të dalë nga situata e inferioritetit dhe nënshtrimit.²⁴

Tashmë nga praktika, del në pah që një nga provat kyçe të akuzës është dëshmia e viktimës dhe shenjat që ajo mbart kur është përdorur dhuna fizike. Kështu, që është deçizive që të parashikohen masa mbrojtëse me qëllim që viktima të jetë e aftë t' i rezistojë forcës së kërcënimit të atij që është i interesuar në dobësimin e akuzës. Nga pikëvështrimi procedural rregullimi i heqjes së viktimës nga kërcënimi, dhunimi apo frika është ajo e parashikuar nga neni 316 apo 336 i K.Pr.Penale, ku mund të ketë vend për shtimin e rasteve të përshejtimit të marrjes së provës nga gjykata.²⁵

Një tjetër diskutim, sidomos i ngritur shpeshherë nga mbrojtja, është në lidhje me dhënien e pëlqimit të personit/femër për tu shfrytëzuar si prostitutë, fakt i cili përdoret në shfajësim të të pandehurit si kryerës i veprës penale të trafikimit.

Në fakt, duket se këtë diskutim e mbyll neni 4 germa b) e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore' i cili thotë shprehimisht se: 'b) *Kompromisi i një viktime të "trafikimit të qënieve njerëzore" në lidhje me shfrytëzimin e synuar, të parashtruar në nënparagrafin (a) të këtij neni, nuk do të jetë i vlefshëm kur është përdorur ndonjë nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a)*', ku nga ana tjetër nënparagrafi a) i nenit 4 të Konventës thotë se: 'a) *"Trafikim i qënieve njerëzore" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve*'.

22 *Violenze alle donne: dal fatto al processo-* dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.

23 *Violenze alle donne: dal fatto al processo-* dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.

24 *Violenze alle donne: dal fatto al processo-* dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.

25 *Violenze alle donne: dal fatto al processo-* dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.

Pra, germa b) e nenit 4 të Konventës, saktëson që pëlqimi i femrës, viktimë e trafikimit, për tu shfrytëzuar nuk merret aspak në konsideratë, e aq më tepër si element shfajësues, pikërisht sepse ndaj saj janë përdorur mjetet e treguara në mënyrë eksplicite qoftë nga Konventa ashtu edhe nga vetë dispozita penale e nenit 114/b të K.Penal, çka do të thotë se e vendosur femra fillimisht nën gjendje skllavërie ajo nuk është më e lirë të zgjedhë apo të kuptojë se çfarë e pret. Por edhe nëse ajo dëshiron të prostitutojë, kjo nuk do të thotë që ajo 'ka dëshirë të pranojë apo të pësojë abuzime të çdo tipi. Për këtë arsye neni 4 (b) parashikon që ekziston trafikimi i qënieve njerëzore qoftë kur viktima jep pëlqimin ashtu edhe kur nuk jep pëlqimin për tu shfrytëzuar'.²⁶

Thellësia e fakteve të trafikimit të femrave është e pamasë, ndaj do të ishte e përshtatshme të forcohej ndjeshmëria e subjekteve institucionale në një vëmendje të veçantë përkundrejt këtyre situatave, sepse 'krahas parimit të prezumimit të pafajësisë për atë që akuzohet, është një tjetër parim i qytetërimit: procesi penal nuk është vetëm selia e garancive të të pandehurit, por së pari është shpallje e drejtësisë, e me këtë rast, edhe njohja e së drejtës të personit të cenuar nga vepra penale'.²⁷

BIBLIOGRAFIA:

1. *Questione linguistico-traduttiva: il traffico di esseri umani*- Marianna Angelillo, në adresën: www.Englishfor.it;
2. *Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D'EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197* – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it;
3. *Traffico di esseri umani e tratta di persone. Azioni di contrasto integrate tra tutela della persona ed esigenze investigative*- Dott. David Mancini, në adresën: www.altalex.com;
4. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2009-71 (292) datë 20.05.2009;
5. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2010-728 (403) datë 28.04.2010);
6. *Violenze alle donne: dal fatto al processo*- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org;
7. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2008-102 (555) datë 03.12.2008;
8. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
9. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

²⁶ *Relazione esplicativa della CONVENZIONE DEL CONSIGLIO D'EUROPA SULLA LOTTA CONTRO LA TRATTA DI ESSERI UMANI STCE n°197* – Lotta contro la tratta degli esseri umani, 16.V.2005 në adresën: www.retepariopportunita.it

²⁷ *Violenze alle donne: dal fatto al processo*- dott. Mirko Margiocco, në adresën: www.donnaesport.org.

Amarildo LAÇI¹

1. PËRSE ËSHTË I DOMOSDOSHËM BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NDËRKOMBËTAR

Disiplina e marrëdhënieve me autoritetet e huaja nuk ka rrënjë shumë të gjata në kohë. Një pengese absolute për zhvillimin progresiv të këtyre raporteve ka qenë dhe mbetet ende sovraniteti i shtetit. Ky i fundit është shoqëruar edhe nga vështirësi të shumta në drejtim të stabilizimit të marrëdhënieve solidare ndërmjet shteteve. Është pikërisht ky sovranitet i shtetit, që ka çuar në një dimension kryesisht kombëtar të fenomenit kriminal, sidomos të luftës kundër këtij fenomeni, dhe kjo deri në një epokë mjaft të afërt. Parimi i territorialitetit të ngushtë të ligjit penal implikues, siç dihet, shfaqet jo vetëm në aplikimin e tij për ata që gjenden në territorin e shtetit, por edhe, në një atribut ekskluziv të një pushteti relativ për autoritetet kombëtare të vendit në të cilin krimi është kryer.

Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, sidomos për t'i dhënë një shtyrje më tej interesit të përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit, është kaluar në një stad, ku regjistrohet një prirje e legjislatorit të vendeve të ndryshme drejt perspektivës për të zbutur ashpërsinë e parimit të territorialitetit në favor të prodhimi të efekteve ekstrakombëtare dhe ekstraterritoriale të akteve gjyqësore të cilat tentojnë të realizojnë pjesëmarrjen e përbashkët të shteteve të interesuara në procedimin ndërmjetës: heqjen dorë nga juridiksioni i autoriteteve territorialisht kompetente në favor të shtetit të kërkuar, i cili merr detyrën për të ushtruar procedimin penal, ose për t'i dhënë ekzekutim një dënimi të dhënë nga autoritetet gjyqësore të shtetit kërkuar. Linja e kësaj tendence, natyrisht, që nuk i përket të gjitha shteteve në të njëjtën masë. Secili prej tyre stabilizon atë rrjet raportesh bashkëpunimi, që zgjedhjet politike të autoriteteve të qeverise së vendit, në atë moment historik, e bëjnë të mundur.

Lëvizja e lirë të njerëzve në kontinentin evropian, çoi në një ridimensionim të krimit. Tashmë krimi i ka kapërcyer kufijtë e të qenit kombëtar, për pasojë, lufta kundër tij nuk mundet kurrësi të bëhet e plotë duke i qëndruar strikt parimit të sovranitetit absolut dhe atij të territorialitetit. Në një luftë të fortë kundër krimit dhe kriminelëve, nuk duhen neglizhuar asnjëherë përmasat që ai ka marrë. Për këto arsye, ideja e sovranitetit absolut i hapi rrugë një koncepti të ri, atij të "sovranitetit të kufizuar" dhe, në këtë kuadër, një bashkim shtetesh, formuar nga delegimi i sovranitetit, që ka mundur të zërë një vend të rëndësishëm në jetën politike të kontinentit tonë është Këshilli i Evropës.

Për të bërë të mundur vënien nën kontroll të këtij lloji krimi është e domosdoshme përputhja dhe bashkimi i të gjitha përpjekjeve të shteteve të veçanta, që nëpërmjet instrumenteve juridike të miratuar bashkërisht, të krijojnë bazën e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën ndaj krimit, nisur që nga shkëmbimi i informacionit në nivelet e policive të ndryshme gjatë hetimeve paraprake, gjykimi i subjekteve dhe, në fund, në fazën e vuajtjes së dënimit të dhënë nga gjykata përkatëse. Këto shkaqe lindën nevojën për një bashkëpunim të ndërsjellë të shteteve për zgjidhje të përbashkëta të disa problemeve të kriminalitetit dhe të ndryshimit të konceptit tradicional të ligjit penal territorial. Mbi këto baza lindën edhe konventat evropiane të karakterit shumëpalësh në kuadrin e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

¹ Gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.

2. LETËRPOROSITË NDËRKOMBËTARE

Letërporositë ndërkombëtare janë një ndër format kryesore të bashkëpunimit ndërkombëtar që parashikon Konventa Evropiane “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”. Neni 1 i Konventës sqaron qëllimin dhe objektin e saj. Palët angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet, dënimi i të cilave është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese.

Lidhur me letërporositë, Neni 3 (1) i Konventës shprehet se Pala së cilës i drejtohet kërkesa do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal, që i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt plotësimin e akteve hetimore ose kalimin e provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve. Neni 15 (1) parashikon se, Letërporositë, për të cilat nenet 3, 4 dhe 5, si edhe kërkesat e parashikuara në nenin 11, do të drejtohen nga Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e Palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe do të kthehen nëpërmjet të njëjtës rrugë. Në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërdrejt nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese tek autoritetet gjyqësore të palës së cilës i drejtohet kërkesa.²

Përmbajtja e letërporosive ndërkombëtare rregullohet edhe nga Kodi i Procedurës Penale (KPP). Neni 509 përfshin kriteret për dërgimin e letërporosive për jashtë shtetit. Sipas këtij neni, letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t’i nisur ato. Neni 511 shprehet për vlerën e akteve të marra me letërporosi. Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t’i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji.

Letërporosia ndërkombëtare ashtu siç përcakton legjislacioni ynë në nenet 505 dhe 509 të K.Pr.Penale ka të bëjë me komunikimet, njoftimet dhe aktivitetet e tjera për marrjen e provës. Ndihma juridike që jepet me anë të letërporosive konsiston në këto drejtime.

- **Marrja e provës:** e cila konsiston në dëgjimin e dëshmitareve, të eksperteve apo të një pandehuri, si dhe në marrjen e provave shkresore apo dokumenteve që lidhen me një çështje penale në shtetin e huaj. Protokolli i dytë shtesë i Konventës përbën një hap mjaft të rëndësishëm përpara në përsosjen e formave, mënyrave e procedurave të bashkëpunimit të ndërsjellë.
- **Dorëzimi i akteve:** të tilla mund të jenë aktet hetimore, provat materiale, dokumentet, fashikujt, procesverbalet apo vendimet gjyqësore. Si rregull dërgohen kopje të tyre të vërtetuara nga sekretaria e gjykatës. Mund të ndodhë që të kërkohet origjinali i një dokumenti apo prove shkresore. Për këtë problem neni 3 i Konventës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” jep zgjidhjen se këto dokumente mund të jepen por me kushtin e vënë shtetit të huaj për kthimin e tyre në një afat të caktuar dhe për t’i ruajtur nga dëmtimi. Është neni 511 i K.Pr.Penale që parashikon për analogji këtë rregull. Ndërsa në bazë të nenit 6 të Konventës origjinalet e fashikujve dhe të dokumenteve që janë dhënë gjatë komunikimit në ekzekutimin e një letërporosie, do t’i kthehen nga pala kërkuese menjëherë palës të cilës i drejtohet kërkesa, përveç kur kjo e fundit heq dorë.
- **Njoftime dhe komunikime me letërporosi:** që mund të jenë komunikimi i një vendimi gjyqësor penal, njoftimi për t’u paraqitur si dëshmitar ose ekspert në një çështje penale etj. Për këtë zbatohen dispozitat për njoftimet të parashikuara nga neni 140 i K.Pr.Penale. Ky veprim sipas nenit 508 të Kodit bëhet nga Prokurori i Rrethit përkatës.
- **Dërgimi i personave autoriteteve të shtetit të huaj:** të tillë janë dëshmitarët, ekspertet, personat e pandehur apo të dënuar. Këta persona në bazë të nenit 8 të Konventës kërkohet të jenë të pranishëm në shtetin

² Lidhur me nenin 15 të Konventës, Shqipëria ka deklaruar (neni 2 i ligjit nr. 8498, datë 10.06.1999) se: “... pala shqiptare deklaron se në zbatim të nenit 15, pika 6, duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuar drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t’i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë”.

që ka paraqitur kërkesën, është e domosdoshme që ata të japin pëlqimin e tyre lidhur me këtë fakt, nëse duan apo jo të shkojnë në shtetin kërkues. Nëse nuk duan të shkojnë autoritetet shqiptare nuk mund t'i vënë përpara përgjegjësisë penale vetëm për këtë fakt. Në këtë rast do të procedohet me marrjen e provës nga Gjykata shqiptare në rast se shteti i huaj do ta pranojë si zgjidhje. Në rast se ka marrëveshje dypalëshe, ku parashikohet ndryshe do të zbatohet marrëveshja.

3. DY FJALË NË LIDHJE ME KUPTIMIN E DËSHMISË SI PROVË

Në kuadrin e llojeve të provave, të parashikuara në kreun e II-të të Kodit të Procedurës Penale, një rëndësi të veçantë paraqet “*dëshmia*”, e vendosur në seksionin e I-rë të këtij kapitulli, nenet 153-165 të këtij Kodi. Kjo lloj prove ka qenë historikisht një instrument i privilegjuar i shqyrtimit gjyqësor, me ekskes parësor ndërmjet burimeve të krijimit të bindjes së gjykatës, duke përfaqësuar, pa dyshim, nga pikëpamja statistikore, llojin e provës më të përdorshme.

Roli qendror i llojit të provës “*dëshmi*” në sistemin tonë procedural rezulton në mënyrë indirekte, i konfirmuar nga vendosja sistematike e kësaj disipline në brendësi (në fillim) të kapitullit të II-të, të titulluar “*Llojet e provave*”, menjëherë pas kapitullit të I-rë të titulluar “*Rregulla të përgjithshme*” mbi provat, si dhe nga rëndësia që i është atribuar kësaj disipline në kuadrin e titullit VII-të, që i është dedikuar “*Gjykimit*”, ku rregullat që kanë të bëjnë me marrjen e dëshmisë gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe me kriteret e përdorimit të rezultateve të saj, nenet 359-362 të Kodit të Procedurës Penale përfaqësojnë, në një farë mënyre, pikën e referimit të gjykimit.³

Dëshmia mund edhe të përcaktohet si një “*deklarim shkencë*” përsa i përket një fakti të përcaktuar që përbën objekti prove, i perceptuar nga deklaruesi personalisht, nëpërmjet shqisave të tij, apo nëpërmjet tregimit të të tjerëve (referimit tek të tjerët)- e ashtuquajtura “*dëshmi indirekte*” (*de relato*), e parashikuar në nenin 154 të K.Pr.Penale.

Dëshmia, duke mbajtur parasysh qëllimin e saj pasqyrimin e ekzistencës së një fakti edhe nëpërmjet kontrollit të besueshmërisë së deklaruesit, mund të konsiderohet edhe me cilësinë e një prove komplekse ku “*fakti që do të ekspozohet*” si dhe “*besueshmëria*” e personit që do të ekspozojë faktin sa sipër, janë pjesë të pandara nga të cilat varet kapaciteti provues i llojit të provës dëshmi.⁴

Fuqia provuese e mjetit të provës “*dëshmi*” varet jo vetëm nga rëndësia e faktit të ekspozuar gjatë pyetjes, por dhe nga besueshmëria e dëshmitarit. Dëshmitari duhet të vlerësohet në raport me dëshminë e tij me të njëjtën mënyrë që gjykohet i pandehuri në raport me faktin penal që i atribuohet prej akuzës. Jurisprudenca ka treguar se dëshmia mund të rezultojë me cilësinë e një prove tepër të rrezikshme, përsa kohë edhe dëshmitari, në mirëbesim, mund të gënjejë duke u nisur nga konsiderata që kujtesa (kujtesa e një fakti të caktuar) është përafërsisht e saktë, por kurrë “*tërësisht e saktë*”. Nga ana tjetër, edhe një e dhënë mund të marrë, një rëndësi themelore, përsa i përket aspektit provues.

Me qëllim vlerësimin e dëshmisë, duhet mbajtur parasysh që veprimtaria perceptuese, njohëse dhe përfaqësuese e titullarit të dëshmisë, proceset e memories, ndërveprojnë ndërmjet tyre në momentin kur rezulton prezent në një ngjarje, kjo e fundit perceptohet, interpretohet dhe regjistrohët në një farë mënyrë. Më pas në fazën “*latente*” që prezumohet periudha ndërmjet ndodhjes së ngjarjes dhe evokimit të saj në formën e dëshmisë në kuadrin e deklarimit të dëshmitarit i gjithë materiali njohës ripërpunohet. Në fund nevojitet që të përkthehen në fjalë, kujtimet e asaj që është perceptuar dhe revokuar e, natyrisht, efekti do të jetë i ndryshëm në varësi të subjektit të thirrur për të dëshmuar. Kriteret e vlerësimit të dëshmisë duhet të

³ Sokol Binaj, “*Dëshmia dhe roli i saj si provë në procesin e të provuarit*”, referat i mbajtur në seminarin trajnues me gjyqtarë e prokurorë, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 30-31 janar 2008, f. 5.

⁴ Pra, nga “*pesha*”, rëndësia e faktit të paraqitur gjatë pyetjes së dëshmitarit dhe nga besueshmëria e dëshmitarit.

plazmohen në varësi të “cilësisë” së provës, cilësi e përcaktuar nga një sërë elementësh të cilët mund të jenë nga më të ndryshmet, ku spikat niveli i besueshmërisë së dëshmitarit, i cili krijohet duke mbajtur parasysh karakteristikat personale, morale, intelektuale, sensitive të tij, nga prania ose jo e një interesi personal të tij në çështjen në gjykim, si dhe nga aftësia e tij (niveli) për të memorizuar dhe për të qenë i vëmendshëm.⁵

Gjykata e faktit, në vlerësimin e provës dëshmi, duhet të nisët nga prezumimi që, derisa nuk provohet e kundërta, dëshmitari referon (dëshmon) fakte objektivist të vërteta. Dëshmia mund të konsiderohet e pavlerë vetëm në kushtet e ekzistencës të elementëve pozitivë, të aftë për të konfirmuar që dëshmia është e rreme (që dëshmitari gënjen) apo që perceptimi dhe kujtesa e dëshmitarit është e vesuar. Në ndryshim nga deklaratimet akuzuese, të bashkëpandehurit në të njëjtën vepër penale apo nga personi i marrë i pandehur në një procedim të lidhur, të cilat për t’u konsideruar prova,⁶ kanë nevojë për elementë të tjerë provues,⁷ deklaratimet e dëshmitarit nuk kanë nevojë për elementë konfirmimi të jashtëm, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për verifikimin e besueshmërisë së dëshmitarit.

4. LEXIMI I DEKLARIMEVE TË BËRA NGA PERSONI QË NUK GJENDET APO ME VENDBANIM JASHTË SHTETIT

Nëpërmjet përcaktimit të nenit 369/2 të K.Pr.Penale parashikohet mundësia, brenda sistemit të “*leximeve të lejueshme*”, për marrjen e akteve të krijuara në fazën e hetimeve paraprake, gjatë shqyrtimit gjyqësor, akte të cilat ndërkohë janë bërë të papërsëritshëm. Në këtë mënyrë ligjvënësi ka synuar t’i japë vlerën e provës jo vetëm akteve gjenetikisht të tillë, me të drejtë eksesi të drejtpërdrejtë në fashikullin e gjykimit dhe të lexueshme detyrimisht, në zbatim të kërkesave të germës “b”, të pikës 1, të nenit 332 të K.Pr.Penale “veprimet e *papërsëritshme të policisë*”. Pra, bëhet fjalë për shkaqe apo rrethana të cilat kanë ndodhur pas formimit të aktit.

Leximi i akteve të kësaj natyre, të formuara në fazën e hetimeve paraprake, vendoset nga gjyqtari, mbi kërkesën e palëve, por edhe kryesisht nga ky i fundit (përcaktimi i pikës 1, të këtij neni). Kushti ligjor që legjitimon aplikimin e procedurës së leximit konsiston në pamundësinë e përsëritjes së aktit për shkak të rrethanave apo fakteve të paparashikueshme, vlerësimi i të cilave çmohet rast pas rasti, në mënyrë të pavarur nga gjyqtari që gjykon çështjen në themel.

Nga formulimi i dispozitës në fjalë mbetet i hapur, në çmim të gjykatës dhe të praktikës gjyqësore në përgjithësi, përcaktimi i parametrave të nocionit të “papërsëritshmërisë së prejardhur” - rrethanave të paparashikuara të cilat nuk mundësojnë përsëritjen e aktit. Synimi i dispozitës në fjalë është të pajtojë respektimin e parimit të oralitetit,⁸ me nevojën e mos humbjes së materialit provues të dobishëm (të përdorshëm) në funksion të dhënies (bazimit) të vendimit.⁹

Në funksion të përcaktimit të rrethanave të paparashikuara, gjyqtari duhet të verifikojë ekzistencën e një situatë pamundësie të krijuar pas marrjes së aktit e cila ishte e pamundur të parashikohej në momentin e formimit të tij. Gjyqtari që gjykon çështjen në themel, duke mbajtur parasysh rrethanat e njohura efektivist, por edhe ato potencialisht të njohshme, në momentin e formimit të aktit, duhet të vlerësojë, duke u rikthyer idealisht në atë moment (periudhë) nëse ishte e mundur apo jo parashikimi lidhur me pamundësinë për të përsëritur një akt të tillë.

5 Sokol Binaj, “Dëshmia dhe roli i saj si provë në procesin e të provuarit”, referat i cituar *supra*, f. 6.

6 Neni 152/3 i Kodit të Procedurës Penale.

7 Prova që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

8 Marrja e provës në prezencë të kontradiktoritetit të palëve.

9 Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vijim të një qëndrimi tashmë të konsoliduar, ka konstatuar se: “Është në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë, të garantuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një dënim i bazuar ekskluzivisht mbi deponimin e viktimës, i bërë jashtë debatit gjyqësor” (prezencës së kontradiktoritetit të palëve) dhe i marrë me procedurën e leximit”.

Pamundësia (e prejardhur) për të përsëritur aktet e marra gjatë hetimeve paraprake duhet të çmohet në mënyrë të pavarur nga gjyqtari i gjykimit të çështjes në themel dhe të arsyetohet në mënyrë të përshtatshme dhe logjike, në funksion të parashikueshmërisë apo paparashikueshmërisë. Idealisht gjyqtari duhet të kthehet në fazën e hetimeve paraprake, në momentin kur ekzistonte mundësia që prova (akti) të merrej nëpërmjet institutit të sigurimit të provës, për të vlerësuar nëse mund të parashikohej ndërhyrja e faktorëve që më vonë do ta bënë aktin të papërsëritshëm. Barra për të provuar si karakterin e paparashikueshëm dhe atë objektiv të pamundësisë për të realizuar pyetjen e dëshmitarit i bie palës që kërkon leximin e deklarimeve të bëra nga deklaruesi përpara policisë gjyqësore apo prokurorit.

Një çështje delikate, që merr interes të veçantë në këtë kuadër, ka të bëjë me vlerësimin e rastit të mosgjjetjes së dëshmitarit. Pra, mund të lexohen dhe të futen në fashikullin e gjykimit deklaratimet e bëra nga dëshmitari në fazën e hetimeve paraprake, kur ky i fundit, për shkaqe të paparashikuara, në momentin e pyetjes së tij, rezulton në pamundësi për t'u gjetur (i mosgjjetur). Vlerësimi i gjyqtarit për mosprezencën e dëshmitarit duhet të bazohet mbi një verifikim të thellë dhe rigoroz. Me këtë qëllim konsiderohet e zbatueshme procedura komplekse, e parashikuar për deklarimin e mosgjjetjes së të pandehurit, nenet 140 e 141 të K.Pr. Penale, pra në funksion të deklarimit të mosgjjetjes së dëshmitarit.

Pika 3, e nenit 369 të K.Pr. Penale bën fjalë për leximin e deklarimeve të bëra nga shtetas shqiptar apo i huaj, me vendbanim jashtë shtetit, në kushtet e pamundësisë së përsëritjes së tyre, për shkak të mosparaqitjes, mosgjjetjes apo edhe refuzimit për të dëshmuar. Dispozita në fjalë parashikon leximin e deklarimeve të bëra jashtë shtetit (me shtetësi shqiptare apo të huaj) në rastin e mos paraqitjes së tij.

Me “*mosparaqitje*” do të konsideronim verifikimin e mungesës së personit rezident jashtë shtetit, që është thirrur në zbatim të pikës 1, të nenit 142 të K.Pr. Penale, që normon njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit. Pra, përveç faktit të mungesës fizike, dispozita imponon që personi që do të pyetet të jetë thirrur rregullisht. Pavlefshmëria e thirrjes apo mungesa e njoftimit (në rastet kur ka ndryshuar vendbanimin) nuk autorizon gjykatën të procedojë automatikisht me leximin, por me ripërtëritjen e urdhrit të thirrjes.

Ndërsa në kushtet e dëshmitarit që “*nuk gjendet*” kemi mendimin se do të konsiderohet personi, rezident jashtë shtetit, të cilit nuk i njihet adresa. Ky status mosgjjetje do të deklarohet pas urdhërimit për kryerjen e kërkimeve jashtë shtetit, sipas rregullave të caktuara ndërkombëtare, nëpërmjet Interpol-it dhe përfundimeve të këtyre kërkimeve. Leximi i deklarimeve të bëra në fazën e hetimeve rezulton automatik në shqyrtimin gjyqësor për sa kohë dëshmitari, rezident jashtë shtetit, refuzon, pas paraqitjes të dëshmojë, duke përfituar nga e drejta e heshtjes.¹⁰

5. VLEFSHMËRIA E PROVAVE ME DËSHMITARË TË MARRË NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT GJYQËSOR NDËRKOMBËTAR, PROBLEMATIKA E HASUR DHE DISA MENDIME NË LIDHJE ME KËTË ÇËSHTJE

Në jurisprudencën e gjykatave për krime të rënda, gjatë gjykimit të çështjeve penale me karakter transnacional në fushën e trafikimit të femrave, të miturve dhe njerëzve, kryesisht me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit apo punës së detyruar janë vërejtur qëndrime të ndryshme në lidhje me vlefshmërinë e provave me dëshmitarë të marra nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, të mundësuar nga qenia njëkohësisht anëtarë në Konventën e Këshillit të Evropës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale, nënshkruar në Strasburg, më 20.04.1959.

Neni 10/1 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se “*Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria, nga parimet dhe normat*

10 Sokol Binaj, “*Dëshmia dhe roli i saj si provë në procesin e të provuarit*”, referat i cituar *supra* f. 19-21.

përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi". Në bazë të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit juridik shqiptar dhe ato kanë epërsi mbi ligjet e brendshme në kundërshtim me to. Gjithashtu, këto dispozita ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë, me përjashtim të rastit kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe për zbatimin e tyre kërkohet nxjerrja e një ligji.

Konventa Evropiane "Për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale" dhe dy Protokollat e saj janë ratifikuar nga Shqipëria.¹¹ Ndihma e ndërsjellë juridike në fushën penale është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me autoritetet e huaja. Ndihma që jepet me letërporosi konsiston në a) marrjen e provave, e cila konsiston në dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurit, si dhe në marrjen e provave shkresore apo dokumenteve që lidhen me një çështje penale në shtetin e huaj; b) dorëzimin e akteve, të cilat mund të jenë akte hetimore, prova materiale, dokumente, fashikuj, procesverbale apo vendime gjyqësore; c) njoftimet dhe komunikimet me letërporosi, që mund të jenë komunikim i një vendimi gjyqësor penal, njoftimi për t'u paraqitur si dëshmitar etj; si dhe d) dërgimi i personave autoriteteve të shtetit të huaj si dëshmitarët, ekspertët apo personat e pandehur.

Marrja e provave në përputhje me ligjin nuk është një kusht abstrakt apo formal. Përkundrazi, ne mendojmë se ajo është e një rëndësie themelore për drejtësinë e një procesi gjyqësor penal. Asnjë gjykatë nuk mund, pa dhunuar administrimin e drejtësisë, të bazohet në prova të cilat jo vetëm janë marrë me mjete të pandershme, por mbi të gjitha, në mënyrë të paligjshme. Në qoftë se ndodh kështu, gjykimi nuk mund të jetë i drejtë.¹²

Në vendimin e saj nr. 23, datë 23.07.2009, Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar pretendimin e të gjykuarit A.G. se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe jo në përputhje me konventën ndërkombëtare për ndihmën juridike në fushën penale e atë për transferimin e procedimeve, është shprehur se: "11. Aktet e siguruarat me letërporosi kanë vlerën e provës në qoftë se janë marrë në përputhje me normat procedurale shqiptare. Në doktrinën e të drejtës penale, lidhur me marrjen e provave me letërporosi, çështja e ligjit të zbatueshëm është shumë e rëndësishme. Pyetja kryesore që lidhet me këtë çështje është nëse prova merret sipas ligjit të shtetit kërkues, apo në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar. Një shtet mund të kërkojë që disa formalitete të zbatohen në mënyrë që ai shtet ta pranojë provën e mbledhur gjatë procesit. 12. Siç u përmend dhe më sipër, parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Provat trajtohen në Titullin IV të KPP. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi (neni 152 i KPP). Neni 193 i KPP, pjesë e seksionit VIII mbi Dokumentet si lloje provash në një procedim penal parashikon, që si të tilla, mund të merren edhe procesverbalet e procedimeve të tjera. Kështu, neni 193/1 parashikon se lejohet marrja e procesverbalet të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. 13. Nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të dosjes gjyqësore Gjykata vëren, se mënyra e marrjes së provave në procesin gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është bërë në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe me nenet 193, 505 e në vijim të KPP. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe jo në përputhje me konventat ndërkombëtare përkatëse, është i pabazuar".

Nga analiza e vendimeve gjyqësore të marra në shqyrtim për qëllim të këtij punimi vërehet se prokuroria për krime të rënda dhe gjykata e shkallës së parë, në marrjen e provave të nevojshme për hetimin dhe gjykimin e krimit të trafikimit transnacional të femrave, njerëzve dhe të miturve, me qëllim, kryesisht, shfrytëzimin e

11 Kuvendi e ka ratifikuar Konventën dhe Protokollin e saj Shtesë me ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999, ndërsa Protokollin e Dytë Shtesë, me ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002. Konventa dhe protokollin i parë, ka hyrë në fuqi për vendin tonë, në datën 03.07.2000, ndërsa Protokollin e Dytë, më 01.02.2004.

12 Mendimi i pakicës i gjyqtarëve Pettiti, Spielmann, De Meyer dhe Carrillo Salcedo, në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 12 qershor 1988, në çështjen *Schenk kundër Zvicrës*, në "Për një rend publik evropian", Vendime të zgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Vëllimi i I-rë, Tiranë 2001, f. 659.

tyre për prostitucion, e kanë zbatuar gjerësisht këtë instrument ndërkombëtar të Këshillit të Evropës. Nga ana e shteteve anëtare në këtë konventë, kryesisht, Italia, Greqia, Franca, Belgjika, Britania e Madhe etj, përgjithësisht është treguar kujdesi i duhur për të vënë në dispozicion të autoriteteve gjyqësore shqiptare, të gjithë materialin provues të kërkuar me anë të letërporosive. Problem i përgjithshëm mbetet koha relativisht e gjatë që kërkohet për t'i ekzekutuar ato nga autoritetet e huaja, çka passjell probleme në respektimin e afateve strikte të përcaktuara në Kodin tonë të Procedurës Penale, në lidhje me afatin e hetimeve paraprake dhe kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, si gjatë hetimit, ashtu edhe në dy shkallët e gjykimit.

Praktika gjyqësore nuk ka sjellë, përgjithësisht, probleme në lidhje me vlefshmërinë dhe fuqinë provuese të provave dokumentare,¹³ të marra me anë të letërporosive. Ato janë çmuar si të vlefshme dhe plotësisht të përdorshme në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. E kundërta ka ndodhur dhe po ndodh me provën me dëshmitar, për të cilën kolegje të veçanta të të dy shkallëve të gjykimit të gjykatave për krime të rënda, ndajnë qëndrime të ndryshme, në lidhje me procedurën se si duhen përfutur këto dëshmi, për të qenë të vlefshme dhe të përdorshme në funksion të vendimmarrjes finale të gjykatës.

Për të pasqyruar këto qëndrime, mendoj të pasqyroj dy vendime gjyqësore, krahas disa të tjerëve të ngjashëm, që “përkrasin” njërin apo tjetrin qëndrim.

5.1 Interpretimi i parë që i konsideron të vlefshme dhe të përdorshme dëshmitë e marra me letërporosi, sipas procedurës që ndjek shteti i kërkuar (i huaj) edhe kur ato nuk janë marrë nga gjykata

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda,¹⁴ në dallim nga gjykata e shkallës së parë, e çmon të bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”, kërkesën e organit të akuzës për përdorimin si provë të deklarimeve të shtetasve francezë D.D. dhe P.O.-V., të dhëna përpara oficerëve të policisë gjyqësore, në datat 28.05.2010 dhe 03.06.2010, në zbatim të letërporosisë së gjykatës për krime të rënda Tiranë, drejtuar autoriteteve franceze, *për arsytet që do të rendisim më poshtë:*

Mbi letërkërkesën e gjykatës për krime të rënda, autoritetet franceze, oficerët e policisë gjyqësore të Rajonit të Lionit, kanë marrë dëshminë e shtetasve francezë D.D. dhe P.O.-V., duke respektuar formulën e betimit, sipas nenit 360/2 të K.Pr.P, që gjykata ka kërkuar të zbatohet, në zbatim të nenit 3/2 të Konventës, dhe duke iu përmbajtur pyetjeve të përcjella me letërporosi nga gjykata e shkallës së parë, mbi pyetjet e parashtruara nga prokurori dhe mbrojtësi i të pandehurit. Ashtu siç me të drejtë ka pretenduar në apel organi i prokurorisë, këto dëshmi janë prova plotësisht të përdorshme dhe duhej të merreshin nga gjykata e shkallës së parë, pasi ato janë marrë në përputhje me legjislacionin procedural francez dhe nuk bien në kundërshtim me ligjin shqiptar.

Në të kundërt me sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, autoritetet franceze e kanë ekzekutuar letërporosinë në bazë të ligjit të tyre, duke u bazuar edhe në parashikimin e paragrafit të parë, të nenit 3 të Konventës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, i cili parashikon se shteti i kërkuar e zbaton letërporosinë sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin e tij. Në asnjë dispozitë të Konventës apo në rezervat që i ka bërë shteti shqiptar këtij instrumenti ndërkombëtar gjatë ratifikimit të saj, nuk parashikohet ndonjë klauzolë përjashtuese sipas së cilës, provat e marra sipas procedurës së vendit të kërkuar nuk mund të përdoren, nëse vijnë në kundërshtim me ligjin e shtetit kërkues.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda konstaton se Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.¹⁵ Për pasojë, në kuptim të nenit 122 të Kushtetutës është pjesë e sistemit tonë të brendshëm juridik dhe zbatohet drejtpërdrejt, pasi ajo është e vetzbatueshme.

Paragrafi i dytë, i nenit 122 të Kushtetutës parashikon se: “Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”. Në këtë frymë pajtuese duhet interpretuar edhe neni 3/1 i kësaj

13 Neni 152/1 i Kodit të Procedurës Penale.

14 Vendimi nr. 60, datë 23.12.2010.

15 Ligji nr. 8498, datë 10.06.1999 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, të vitit 1999, faqe 697.

Konvente, sipas të cilit: "Pala së cilës i drejtohet kërkesa do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislati i vendit të saj, letërporositë që lidhen me..." , i cili, duke qenë dispozitë e një marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuar me ligj, të botuar në Fletoren Zyrtare dhe pjesë e sistemit tonë të korpusit juridik, ka epërsi në lidhje me çdo normë të Kodit tonë Procedural Penal, në lidhje me procedurën (formën) e marrjes së një prove nga një shtet i huaj me letërporosi, mjafton që të plotësohet kushti i vënë në këtë nen, që prova të merret nga autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar, sipas ligjit procedural dhe atij specifik që rregullon marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale.

Gjykata për krime të rënda, në mënyrë korrekte dhe me qëllim respektimin e parimit të kontradiktoritetit në marrjen e dëshmimeve të këtyre shtetasve, ka dërguar me letërporosi edhe pyetjet që janë vlerësuar t'u bëhen atyre nga gjykata dhe palët në proces.

Në parim, në mbështetje të nenit 332/1, germa "ç" të K.Pr.Penale, materialet e ardhura në ekzekutim të letërporosisë janë pjesë e fashikullit të gjykimit dhe për këtë shkak ato gjenden në materialet që prokurori i ka bashkëngjitur kërkesës për gjykim. Kodi i Procedurës Penale shqiptare thekson në mënyrë të qartë se, për të marrë vendimin gjykata mund të përdorë vetëm prova që janë marrë e verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.¹⁶

Është e vërtetë që në nenin 369, pika 1 të K.Pr.Penale, përcaktohet e drejta e gjykatës për të vendosur edhe kryesisht leximin e akteve që përmbahen në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor, por leximi i deklarimeve të bëra nga personat që kanë dijeni për rrethanat e çështjes, rregullohet posaçërisht në pikën 3 të këtij neni. Në mënyrë taksative ky nen kërkon që personi i cili mund të ketë dijeni për rrethanat e çështjes, duhet të jetë thirrur për të dëshmuar. Në interpretim të këtij neni, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda çmon që, në asnjë rast gjykatat nuk mund të lexojnë procesverbalet me deklarimet e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, me arsyetimin që këto akte janë përfshirë në fashikullin e gjykimit. Në vlerësimin e kësaj gjykate pika 1, e nenit 369 bën fjalë për akte të tjera, siç mund të jenë ato të përcaktuara në nenin 332 të K.Pr.Penale.

Në nenin 332, shkronja "ç" e K.Pr.Penale përcaktohet që kërkesës së prokurorit për gjykimin e çështjes i bashkohen edhe "procesverbalet për sigurimin e provës dhe të atyre të plotësuara jashtë shtetit në bazë të letërporosisë". Fakti që në ekzekutim të letërporosisë nga autoritetet franceze janë paraqitur edhe deklarimet e shtetasve D.D. dhe P.O.-V., nuk e legjitimon gjykatën t'i lexojë ato, pa kërkuar më parë thirrjen e tij me cilësinë e dëshmitarit në këtë gjykim, ashtu siç me të drejtë ka vepruar ajo, duke kërkuar pyetjen e tyre në respektimin të parimit të kontradiktoritetit, duke dërguar të gjitha palët në proces pyetjet e tyre në letërkërkesë.

Në ligjin për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" dhe protokollet e saj shtesë; rezulton që shteti shqiptar, përveç rezervave, ka bërë dhe deklarime, në mënyrë të posaçme për nenin 3, paragrafin e dytë të saj, në lidhje me dëshmitarët dhe ekspertët që ajo kërkon të pyeten, duke kërkuar respektimin e nenit 360/2 të K.Pr.Penale¹⁷, me pasojë pavlefshmërinë e veprimit të kryer.

Rrjedhimisht, në gjykimin e këtij kolegji, procesverbalet e dëshmimeve të dhëna nëpërmjet letërporosisë nga shtetasit francezë D.D. dhe P.O.-V., marrë respektivisht në datat 27.05.2010 dhe 03.06.2010, nga oficerët e policisë gjyqësore, janë plotësisht të përdorshme në funksion të vendimarrjes së kësaj Gjykate, në rastin në gjykim.

¹⁶ Neni 380 i Kodit të Procedurës Penale.

¹⁷ Ky dispozitë ka këtë përmbajtje: "2. Sekretari i gjykatës lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit: "Betohe se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë." Pas kësaj dëshmitari deklaroi "betohe" dhe tregon gjeneralitetet e tij.

5.2 Interpretimi i dytë që i konsideron të papërdorshme dëshmitë e marra me letërporosi kur ato nuk janë marrë nga gjykata

Në shqyrtim të procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, gjykata e apelit konstaton se marrja e këtyre deklarimeve si provë është vendosur me vendimin e ndërmjetëm të datës 14.02.2007, në të cilën gjykata ka disponuar për lejimin e marrjes së provave të kërkuara nga organi i akuzës duke bërë pjesë të këtyre provave edhe këto deklarime të përfshira në “aktet e tjera të sjella nga autoritetet gjyqësore turke”.

Këto deklarime i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në seancën e datës 20.06.2007. Gjykata rezulton të ketë refuzuar kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e të pandehurve për thirrjen e pyetjen e këtyre shtetasve në gjykim me cilësinë e dëshmitarëve apo të bashkë të pandehurve.

Në analizë të këtyre veprimeve procedurale të kryera nga gjykata e shkallës së parë, krahasuar me rregullat procedurale në fuqi, gjykata e apelit konstaton se përfshirja e këtyre deklarimeve në fashikullin e gjykimit dhe përdorimi i tyre si prova është bërë në kundërshtim me ligjin.

Është e vërtetë që, në kuptim të nenit 332/1, germa “ç” e K.Pr.Penale materialet e ardhura në ekzekutim të një letërporosie janë pjesë e fashikullit të gjykimit në parim, dhe për këtë shkak ato gjenden në materialet që prokurori i bashkëngjiti fashikullit që ai ndërton, dhe që, në kuptim të dispozitës së mësipërme, e shoqëron kërkesën për gjykimin e çështjes në gjykatë.

Ky rregull i vendosur në këtë dispozitë ka kufizimet e tij, në kuptim të nenit 511 të K.Pr.Penale i cili parashikon se: *“Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t’i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji”*. Në këtë kuptim edhe në rast se autoritetet turke do të kishin ekzekutuar letërporosinë, shoqëruar me kondicione të caktuara për përdorimin e akteve të përcjella, përsëri në interpretim të kësaj dispozite përdorimi dhe vlera e tyre do të përcaktohej në zbatim të ligjit shqiptar duke mos shkelur ndalimet që përcakton e drejta e brendshme për çdo rast konkret. Në vijim gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar të analizojë e marrë në shqyrtim përdorimin me cilësinë e provës në gjykim të deklarimeve që kanë bërë bashkë të pandehurit në procedimin penal që zhvillohet në Turqi, në zbatim të dispozitave procedurale që rregullojnë marrjen e provave sipas legjislacionit shqiptar.

Në titullin IV, në kreun “Provat”, të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohen të gjitha llojet e provave që rregullon legjislacioni, parashikohet gjithashtu edhe e drejta e organit që procedon për marrjen e tyre. Në këtë kuptim organi që procedon në fazën e hetimeve paraprake mund të marrë çdo provë nga ato që parashikon ky kre, me përjashtim të provës “dëshmi” dhe “pyetje të të pandehurit dhe të palëve private”, të cilat krijohen si prova vetëm me ekzekutimin e rregullave të pyetjes përpara gjykatës, mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit.

Neni 380 i K.Pr.Penale, që përcakton kufijtë e provave që mund të përdorë gjykata në dhënien e një vendimi, përcakton edhe kriterin ndarës të aktivitetit të gjykatës në shqyrtimin gjyqësor. Sipas kësaj dispozite gjykata i merr provat në proces dhe në këtë kuptim ajo mund të marrë çdo provë që parashikon ligji, madje edhe tej atyre të parashikuara në zbatim të nenit 151/3 të K.Pr.Penale, si dhe verifikon provat që janë marrë më parë prej palëve. Në provat që gjykata vetëm i verifikon, mund të përfshihet çdo lloj nga ato të parashikuara nga kreu i provave, duke përjashtuar deklaratimet e dëshmitarëve, bashkë të pandehurve dhe të palëve private, të cilat janë prova që krijohen si të tilla vetëm në debatin gjyqësor.

Në vazhdim të këtij arsytimi gjykata, për të pasur të drejtën të shfrytëzojë në dhënien e vendimit prej saj të të dhënave që vijnë nga deklaratimet e bashkë të pandehurve, shtetas turq, duhej të kishte vendosur thirrjen e tyre në gjykim, në kuptim të nenit 167/a të K.Pr.Penale, i cili përcakton rregullin e pyetjes së një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur që procedohet jashtë shtetit.

Kjo dispozitë, e shtuar në Kodin e Procedurës Penale, është vënë në ekzekutimit të rregullave të pranuar nga shteti ynë me ratifikimin e Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, me ligjin nr. 8598 datë 10.06.1999. Në kuptim të këtyre dispozitave, e konkretisht të neneve 7-12 të Konventës, deklaratimet e dëshmitarëve, ekspertëve apo personave që i nënshtrohen një procesi penal, do të merren vetëm në zbatim të procedurave përkatëse të pyetjes, në përgjigje të kërkesës së shtetit kërkues për pyetjen e tyre. Pra, jo vetëm legjislacioni ynë procedural, por edhe konventa pranon se deklaratimet e kësaj kategorie, në të cilën përfshihet edhe bashkë i pandehuri, përftohen me letërporosi, vetëm pasi shteti kërkues, nëpërmjet organit të tij gjyqësor të aftë të marrë një deklaram të tillë për efekt prove, organ i cili sipas legjislacionit tone është vetëm gjykata, të këtë disponuar me një kërkim të tillë.

Në çdo rast, për të përdorur në një gjykim deklaratime të dhëna nga një individ i tillë ai duhet të thirret paraprakisht nga gjykata. Vetëm pasi të jetë ezauruar ky veprim procedural gjykata, në kushtet e refuzimit, apo pamundësisë së pyetjes së personit të kërkuar prej autoriteteve kompetente të shtetit të huaj apo prej një grupi kompetent të deleguar nga shteti kërkues, mundet të procedojë duke zbatuar rregullat që parashikojnë dispozitat tona procedurale në lidhje me përfshirjen, nëpërmjet leximit, të akteve të hartuara me deklaratimet e tyre në fazën e hetimeve paraprake.

Në procesin e zhvilluar në shkallë të parë konstatohet se gjykata ka proceduar me marrjen e deklaratimeve të bëra nga bashkë të pandehurit, shtetas turq, gjatë fazës së hetimeve paraprake, në prezence të prokurorit të çështjes, pa ezauruar thirrjen e tyre në gjykim në kuptim të nenit 167/a të K.Pr.Penale.

Për pasojë, këto deklaratime nuk janë as prova të cilat janë marrë nga gjykata dhe as prova të cilat janë verifikuar prej saj, por janë të dhëna të përfituara në kundërshtim me ligjin, për pasojë në zbatim të nenit 151/4 të K.Pr.Penale, nuk mund të përdoren.¹⁸

Siç konstatohet lehtë në dy vendimet e sipërcituara, gjykatat ndahen në vlerën procedurale që kanë dëshmitë e marra me letërporosi nga gjykatat, gjatë hetimit gjyqësor të çështjes. Pothuajse në të gjitha vendimet e analizuara vërehet se letërporosia e gjykatës pason atë të prokurorisë, të dërguar nga kjo e fundit gjatë hetimit paraprak të çështjes, për marrjen e të njëjtës provë, deklaratimet e dëshmitarëve që ndodhen në territorin e shtetit të kërkuar. Edhe pse gjykatat në letërporosinë e tyre vënë theksin në marrjen e këtyre dëshmimeve nga gjykata kompetente e shtetit të kërkuar, në thuajse në asnjë rast këto shtet nuk e kanë zbatuar këtë kërkesë, duke vijuar, sërish, të marrin provën jo nga gjykata, por nga oficerët e policisë gjyqësore (hetuesit). Konstatohet se në marrjen në pyetje autoritetet e huaja respektojnë pyetjet e dërguara nga autoriteti gjyqësor shqiptar, që në rastin e letërporosive të dërguara nga gjykata, pasqyrojnë pyetjet e të gjithë palëve në proces.

Në vlerësimin tim një qëndrim i tillë nga autoritetet gjyqësore të huaja ndodh, pasi mënyra se si veprohet për ekzekutimin e letërporosive ndërkombëtare rregullohet nga ligji i tyre i brendshëm. Diskrecionin e shtetit të kërkuar për të zbatuar normat e veta të brendshme e ka njohur edhe vetë Konventa Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, në nenin 3/1 të saj.

Të habit fakti se përse autoritetet gjyqësore shqiptare nuk i referohen në kërkesën e tyre për ndihmë juridike, rasteve të tjera që parashikon Konventa Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe Protokollat e saj:

- (1) njoftimi i dëshmitarit që ndodhet jashtë shtetit për t’u paraqitur dhe dëshmuar përpara gjykatës shqiptare që po shqyrton themelin e çështjes penale, siç parashikohet në nenet 3/1&2, 8, 9 dhe 10 të Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”; dhe
- (2) përdorimit të videokonferencës dhe/apo konferencës telefonike, në referim të neneve 9 dhe 10 të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”.

¹⁸ Vendimi nr. 51, datë 02.11.2007 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Një vështirësi praktike mund të jetë kostoja jo e vogël financiare që duhet të përballojë organi procedues për sjelljen e dëshmitarit në Shqipëri, në referim të neneve 9 dhe 10/2&3 të Konventës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, por në asnjë rast ky motiv nuk ka gjetur pasqyrim në aktet e përfshira në fashikullin e gjykimit.

Është e kuptueshme se marrja e provës drejtpërdrejt nga ana e gjykatës do të garantonte në maksimum të drejtën e mbrojtjes dhe atë të barazisë së armëve në procesin penal, që përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së.¹⁹

6. PËRFUNDIME

Në vlerësimin tim, përse kohë që prova me dëshmitarë është marrë gjatë gjykimit të çështjes, me vendim (disponim) të gjykatës, dhe në letërporosi gjejnë pasqyrim të gjitha pyetjes që kërkohen t’u jepet përgjigje nga dëshmitari, dhe që janë përgatitur, si nga prokurori, ashtu edhe nga i pandehuri dhe mbrojtja e tij, pa përjashtuar edhe gjykatën, kjo dëshmi e dhënë, edhe pse e marrë jo nga gjykata e shtetit të kërkuar, por nga një autoritet tjetër gjyqësor i atij shtetit, në referim të nenit 24 të Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, është plotësisht e vlefshme dhe e çmueshme nga gjykata, në funksion të vendimmarrjes së saj përfundimtare. Në këtë rast garantohen të drejtat procedurale të të pandehurit, si e drejta e mbrojtjes, ashtu edhe ajo e barazisë së armëve, pasi i pandehuri, nëpërmjet hartimit të pyetjeve që bëhen pjesë e letërporosisë, i ka realizuar të drejtat që i njeh ligji procedural penal, Kushtetuta dhe KEDNJ-a, për të marrë në pyetje dëshmitarët gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet ndaj tij.

Nuk më duket racional qëndrimi i kundërt që e lidh vlefshmërinë e dëshmisë së dhënë, thjesht me faktin që ajo nuk është marrë nga gjykata kompetente e shtetit të kërkuar, përse kohë Konventa, në të tilla raste nuk e ka parashikuar një detyrim të tillë dhe përse kohë shtetit të kërkuar i është njohur e drejta nga vetë konventa për ta marrë provën (ekzekutuar letërporosinë sipas ligjit të tij të brendshëm). Një qëndrim i tillë kaq “strikt” thjesht do të dëmtonte efektivitetin dhe efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, pasi prova të rëndësishme për procesin do të përjashtoheshin nga përdorimi i tyre, edhe pse, në thelb, të drejtat e të pandehurit në marrjen e kësaj prove, janë garantuar në mënyrë të mjaftueshme.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Kodi i Procedurës Penale
3. Kodi Penal
4. Ligji nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”
5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
6. Konventa Evropiane “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqësorëve penale”
7. Konventa Evropiane e Ekstradimit
8. Konventa Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar”
9. Konventa Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”
10. Konventa mbi Zbatimin e Marrëveshjes së Schengen-it, e vitit 1985.
11. Vendime gjyqësore të gjykatave shqiptare në të gjitha shkallëve të gjyqësorit
12. Artan Hoxha “Ekstradimi sipas instrumenteve ligjorë të BE-së. Ngjashmëritë dhe ndryshimet më

¹⁹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 19, datë 18.09.2008; nr. 95, datë 27.07.2001; nr. 07, datë 27.04.2005.

instrumentet e Këshillit të Evropës”, shtëpia botuese “Morava”, 2000.

13. Latanzi, G & Lupo, E: Esecuzione e Raporti Giurisdizionali con le Autorita Straniere, Librat X, XI, Giuffre, 1997.
14. Ema Barbe « *Schéma des procédures d'enquête comparées*», Les Petites Affiches, nr. 72, 16 qershor 1997, numër special « Vers un espace judiciaire européen pour les enquêtes criminelles ».
15. F. Alt-Maes, « *Développement de l'entraide répressive internationale* », Revue de science criminelle, tetor-dhjetor 1992.
16. Régis de Gouttes, « *De l'espace judiciaire pénal pan-européen* », Mélanges Levasseur, Litec, 1992.
17. Louis Antoine Aledo, Droit International Public, Dalloz connaissance du droit, 2005.

Faqe interneti të konsultuara:

1. www.eurojust.europa.eu
2. www.ejn-justcrim.europa.eu
3. <http://curia.europa.eu>
4. www.dejure.it
5. www.lexitalia.it
6. http://www.u-paris2.fr/08753547/0/fiche___pagelibre/&RH=P2-RDA&RF=P2-MEMOIRE
7. www.mondogiuridico.com
8. www.EUR-Lex
9. www.italgiure.it
10. www.giustizia.it
11. www.legali.com
12. www.diritto-in-rete.com

HYRJE

Drejtësia jonë penale karakterizohet nga tipari diskrecionar pasi tërë sistemi procedural por dhe ai penal material synojnë në zbulimin dhe ndëshkimin e autorit të veprës penale, pa u marrë në veçanti me pasojat e veprës penale dhe pozitën e të dëmtuarit nga ajo. Standardet e normave ndërkombëtare në të cilat në kemi aderuar e i kemi pranuar si pjesë të korpusit tonë ligjor kërkojnë tashmë respektimin e pozicionit të viktimave të trafikimit, trajtimin e veçantë të tyre dhe kompensimin e tyre. Ndaj këtyre duhet të reflektojmë dhe legjislacioni ynë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive të viktimave të trafikimit. Tendencia e re që gjen zhvillimin e saj në të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare e që ka për qëllim përkrahjen e rolit të viktimës në të drejtën penale në përgjithësi,² nisët nga përparësia që e drejta ndërkombëtare penale i jep pozitës kryesisht të femrës e të miturve.³

Disa legjislacione përfshi dhe tonin nuk kanë adaptuar akoma konceptin e “viktimologjisë”. Viktimat nuk janë shumë aktive në procedurat penale, viktimat zakonisht bëhet subjekt i viktimizimit sekondar që rezulton me mos-raportimin e krimeve e qëllimi kryesor i drejtësisë penale mbetet dënimi dhe parandalimi i krimit. Standardet ndërkombëtare të sanksionuara në normat juridike ndërkombëtare na detyrojnë në juristëve dhe gjyqtarëve shqiptar që të trajtojmë në përputhje me to viktimat e trafikimit.

1. STANDARDET NDËRKOMBËTARE NË TRAJTIMIN E VIKTIMAVE DHE KOMPENSIMIN E TYRE

Dokumenti i parë ndërkombëtar dhe universal që ka të bëjë në mënyrë specifike me të drejtat e viktimave dhe procedurën e kompensimit të dëmit ndaj tyre është Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit e adoptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.⁴ Përkrah përcaktimit të kuptimit “viktimë”⁵ ky dokument promovon edhe disa të drejta të tyre si veprim deri te organet e drejtësisë dhe trajtim të drejtë ndaj tyre (*që mes tjerash nënkupton ndihmën juridike dhe njoftimin në kohë për të gjitha aspektet procedurale*), restituim (*rikthimi i pronës, kompensimi i dëmit, restorimi i të drejtave*, etj.), kompensim (*i siguruar nga shteti kur mjetet financiare të kryerësit janë të pamjaftueshme për këtë gjë*) etj.

1 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kryetar.

2 The responsibilities and the rights of victims of crime. The Modern Law Review 1992 Jul; 55(4): 482-505.

3 Sebba L. The victim's role in the penal process: A theoretical orientation. The American Journal of Comparative Law 1982; 30(2): 217-240.

4 The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985).
URL: <http://www.unhcr.ch/html/menu3/b/h>.

5 Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.

Konventa e Palermos⁶ dhe Protokollit i saj shtesë mbi parandalimin e trafikut të grave e të fëmijëve janë instrumenti ndërkombëtar më i plotë që i kushtoi vëmendjen e duhur të drejtës për viktimën duke sanksionuar "... detyrimin e shteteve palë, që në varësi të ligjit kombëtar, të mundësojnë që qëndrimet dhe shqetësimet e viktimave të bëhen prezent dhe të merren në shqyrtimin gjatë etapave të përshtatshme të procedurave të hetimit."⁷ Neni 6, paragrafi 2 i Protokollit, ripërsërit *detyrimin e shteteve palë që të ofrojnë ndihmë për viktimat e trafikimit*. Sipas kësaj dispozite shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikut në rastet e duhura, informacion në lidhje me procedurat gjyqësore, asistencës e ti kushtojnë vëmendje inkurajimit të viktimave për të bashkëpunuar me autoritet.

Konventa e Këshillit të Evropës "*Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme*"⁸ nuk rezultoi një normë ndërkombëtare efikase për shkak se ratifikimi i saj nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës zgjati shumë, ndërkohë që Konventa e Këshillit të Evropës "*Për Veprim kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore*"⁹ është akti më i plotë juridik ndërkombëtar. Kjo Konventë e Këshillit të Evropës ka veçantitë e saj në krahasim me instrumentet e tjerë ndërkombëtare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Përsa i përket fushës së zbatimit të kësaj Konvente ajo mbulon të gjitha llojet e trafikimit cilitdo qofshin viktimat: burra, gra, fëmijë duke siguruar në këtë mënyrë barazinë gjinore. Kjo Konventë është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar që përkufizon termin "*viktimë e trafikimit të qënieve njerëzore*" në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë të cilët limitohen duke i lënë secilit Shtet të çmojë se kush do të quhet viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme.

Në kuadër të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin (OSBE) është hartuar dhe një Plan - Veprim për Luftimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore¹⁰ që ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave, mos-penalizmin e personave të trafikuar për vepra penale të lidhura me trafikimin, ngritjen e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit dhe hartimin e Udhëzuesve për identifikimin e saktë, informimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të trafikuar. Protokollit mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës se OKB kundër krimit të organizuar gjithashtu parashikon mundësinë e kompensimit.¹¹ Konventa Evropiane "*Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme*"¹² është një akt tjetër që synon në nxitjen e shteteve për përcaktimin e skemave që garantojnë kompensimin e viktimave. Kjo Konventë synon ndihmën e viktimave në rastet kur ato nuk mund të kompensohen në një mënyrë tjetër. Qëllimi është kompensimi i atyre që kanë pësuar një dëm trupor ose dëmtim të shëndetit. Konventa parashikon se kompensimi mbulon shpenzimet mjekësore, të ardhurat e humbura, shpenzimet për mbajtjen e personave të varur.

Si akte Rekomanduese janë: Korniza e vendimit të dt.15.03.2001 të Këshillit të BE për pozitën e viktimave në procedimet penale parashikon që "*Shtetet duhet të shqyrtojnë në rast se ligjet dhe procedurat vendase janë të përshtatshme dhe përgjegjëse për viktimat e trafikut, e të inkurajojnë kompensimin e tyre*". Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së "*Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale*" parashikon se "*një gjykatë penale duhet të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Duhet të hiqen kufizimet ekzistuese dhe pengesat teknike që çojnë në mosrealizimin e një të drejte të tillë, kompensimi duhet të jetë përparësi në rastin e një dënimi alternativ e se gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje nevojës për kompensim të dëmit.*" Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së "*Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit*" shton se "*Shtetet duhet të vlerësojnë masën e mbulimit të siguracioneve nga skemat private ose publike të sigurimit për sigurimin efikas të viktimave sipas nevojave të tyre*" Rekomandimi nr.9713 i KE-së,"në

6 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollit II i saj "Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve"

7 Neni 25 i Konventës se OKB si dhe neni 6/pag 2 I Protokollit II.

8 E hartuar në Strasburg me 24.11.1983 dhe e ratifikuar nga shteti ynë me ligjin nr. 9265 datë 29.07.2004.

9 Konventa e miratuar në Strasburg vitin e kaluar.

10 Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit - Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.

11 Neni 6, pika 6; "Shtetet palë duhet të sigurojnë që sistemet e tyre ligjorë të përfshijnë masa që iu ofrojnë viktimave të trafikut të personave mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar.

12 Konventa e miratuar në Strasburg me 24.11.1983, ratifikuar me ligjin nr.9265 dt.29.07.2004.

lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes” parashikon gjithashtu se “...masat që duhet të merren për trajtimin e dëshmitarëve veçanërisht në rastet e krimit në familje”.

2. TRAJTIMI I VIKTIMAVE OSE TË DËMTUARAVE NGA VEPRA PENALE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Duke pasur parasysh sa është thënë më lart lidhur me tendencat bashkëkohore për ripërcaktimin e pozitës së viktimës në të drejtën penale, mund të konstatohet siç përmendëm dhe më sipër se legjislacioni shqiptar që kanë të bëjnë me çështjet penale janë plotësisht të orientuara drejt autorit të veprës penale. Në qoftë se analizohet Kodi Penal në këtë aspekt, gjëja e parë që do të konstatohet është se termi “viktimë” nuk paraqitet fare në pjesën e përgjithshme të këtij kodi (ashtu si edhe në shumë vende tjera me sistem juridik kontinental. Kodi Penal i RSH¹³ në pjesën e përgjithshme ka të bëjë me konceptet e përgjithshme të krimit, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale dhe pjesën e posaçme që ka të bëjë me veprat konkrete penale); që do të thotë se viktimja nuk paraqet një subjekt të veçantë dhe të pavarur të së drejtës penale. Qëllimet e vetme të sanksioneve penale janë parandalimi specifik dhe i përgjithshëm (*ndalimi i autorit ta përsërisë veprën penale si dhe ndalimi i të tjerëve ta kryejnë të njëjtën*) dhe rehabilitimi i autorit. Restituimi dhe kompensimi i viktimës nuk përmenden fare si qëllime të sanksionit penal. Ndërsa Kodi i Procedurës Penale përmend termin “*person i dëmtuar*”¹⁴ i cili njihet si subjekt procedural në disa figura vepre penale si dhe kuptimin e të dëmtuarit material nga vepra penale.¹⁵ Pra, “*personi i dëmtuar*” ose “*paditësi privat*” janë palë subsidiare e jo primare në një proces penal. Veprat penale të trafikimit nuk legjitimojnë si subjekt procedural “*viktimën*” e trafikimit. Kjo për shkak se veprat penale kundër trafikimit të qënieve njerëzore janë të reja në legjislacionin tonë. Në kuadër të detyrimeve nga norma ndërkombëtare kjo duhet rishikuar dhe të drejtat e viktimës duhet të përcaktohen qartësisht pikërisht si janë të përcaktuara qartësisht të drejtat e të akuzuarit. Që të arrihet kjo, së pari viktimja duhet të pranohet si palë direkt në proces dhe të realizohen të drejtat themelore të saj: pjesëmarrja, mbrojtja dhe restituimi. Kjo do të duhej të ishte fryma e reformave në legjislacionin penal shqiptar që janë duke u zhvilluar tani.

Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar si subjekt procedural të dëmtuarin nga vepra penale dhe ka legjitimuar si subjekt në veprim të dëmtuarin material nga vepra penale.

Legjislacioni i veçantë e kryesisht ai në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar ka reflektuar detyrimet që rrjedhin nga normat ndërkombëtare të sipërcituara. Në ligjin “*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”¹⁶ është përcaktuar detyrimi i organeve të posaçme administrative për marrjen e masave të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjes së tij, përfshirë edhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë. Gjithashtu KPrP ka parashikuar dhe pyetjen në distance të dëshmitarëve,¹⁷ kjo si nevojë e domosdoshme për të siguruar efikasitet në punën e organeve të procedimit penal dhe sistemit gjyqësor në goditjen e autorëve të krimit të organizuar, për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë, nëpërmjet të cilave krijoheshin vështirësi serioze për vërtetimin e fajësisë dhe dënimin e tyre, për të përqsuar legjislacionin tonë me atë ndërkombëtar.

Sipas pikës 7 të shtuar në nenin 361 të KPrP, pyetja e dëshmitarit në distancë mund të bëhet brenda territorit të vendit tonë ose jashtë vendit. Ligji parashikon që gjatë kësaj pyetje në distancë duhet të respektohen rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit tonë të Procedurës Penale. Dëshmitari pyetet nëpërmjet lidhjes audio-vizive dhe personi i autorizuar nga Gjykata qëndron në vendin ku ndodhet

13 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 dhe hyrë në fuqi 1 qershor 2006.

14 Neni 58 i KPrP “Të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale”, neni 59 “I dëmtuari akuzues”.

15 Neni 61 i KPrP “Padia civile në procesin penal”.

16 Ligji nr.9205 dt.415.03.2004”Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

17 Ndryshimet e KPrP me ligjin nr. 9276 dt.16.09.2004 “Për disa ndryshime në KPrP”.

dëshmitari dhe bën identifikimin e tij, si dhe kujdesit për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në proces-verbal.

Fshehja e identitetit të dëshmitarit. Ligji ynë në procedurat penale parashikon “*ndryshimi i identitetit të dëshmitarit (të personit që do të pyetet nga gjykata)*”. Në këto raste gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme në rast se “është e domosdoshme” njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm të tij me qëllim që të përmbushë këtë detyrim. Ligji ia lë gjykatës që të vlerësojë se çfarë masash konkrete ajo do të marrë. **Në seancën gjyqësore**, dëshmitarja në një veprë trafikimi ku vetë ka qenë e trafikuar qëndron në një vend të posaçëm jashtë sallës ku gjykohet i pandehuri. Salla ku qëndron viktimja është një sallë apo dhomë tjetër, më vete nga ajo ku kryhet gjykimi i çështjes. Pyetja e dëshmitares realizohet nëpërmjet një qarku të mbyllur televiziv, audio dhe video, ku ajo dhe i pandehuri mund të komunikojnë pa qenë në të njëjtën sallë. Pala e dëmtuar, prokurori, kanë të drejtë që të kërkojnë në gjykatë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim marrjen e masave mbrojtëse, lëshimin e një urdhri për ruajtjen e anonimitetit.

Mbrojtja e dëshmitarit të drejtësisë: Në zbatim të detyrimit dhe frymës së Protokollit të Palermos,¹⁸ ligji për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe dëshmitarët e mbrojtur¹⁹ ka bërë përcaktimin e “personit të mbrojtur” ose “dëshmitarit të drejtësisë”. “*Dëshmitari i drejtësisë*” është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, i cili në cilësinë e dëshmitarit ose personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte dhe rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni²⁰ (përfshihen edhe veprat penale lidhur me trafikimin). Viktimat e trafikimit mund të paraqiten shpesh në këtë pozitë procedurale.

Deri tani në Gjykatën e Krimeve të Rënda nuk kemi pasur raste të dhënies së këtij statusi viktimave të trafikimit por gjithsesi kur ato kanë qenë dëshmitarë gjatë sigurimit të provës apo dëshmisë janë shoqëruar me punonjës policie për në Gjykatë të asistuar nga aktivistë të shoqërisë civile apo të organizatave të ndryshme që ushtrojnë aktivitete në këtë fushë. *Masat e posaçme për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë* zbatohen kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes së dëshmitarit të drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, personi pranon edhe bashkëpunon me vullnet të lirë me organin e prokurorisë dhe gjykatën e kur nëpërmjet dëshmisë së tij të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, jep të dhëna të bazuara që përbëjnë prova vendimtare për një procedim penal për krime të rënda, ndihmojnë në parandalimin e kryerjes së krimeve të rënda ose në zvogëlimin e pasojave që shkaktohen prej tyre dhe ndihmojnë në riparimin e dëmeve dhe të humbjeve të shkaktuara nga kryerja e krimeve të rënda.²¹

Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarin e drejtësisë vendosen vetëm nëse ai ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz, është i përshtatshëm për t’u përfshirë me këto masa, me vullnetin e vet të lirë pranon dhe merr pjesë aktivisht në zbatimin e tyre. *Masat e posaçme të mbrojtjes për dëshmitarë*, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e afërm ose të lidhur me ta janë ato që kanë të bëjnë me ndryshimin e identitetit, të vendbanimit, mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve të personit të mbrojtur, dhënia e deklarimeve të dëshmitarit nën një identitet tjetër dhe administrimi i tyre me mjete të veçanta për deformimin e zërit, të pamjes së vërtetë të tij dhe forma të tjera të caktuara sipas ligjit,²² masa të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjes së tij, përfshi dhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë; mbrojtje dhe trajtim i posaçëm në rastet kur, për kryerjen e një veprë penale, bashkëpunëtorit të drejtësisë i është caktuar masë sigurimi ose

18 Neni 24, paragrafi i parë detyron shtetet palë që të marrin masat e duhura, për të siguruar mbrojtje fizike efektive të dëshmitarëve, zbatohen edhe për viktimat e trafikimit kura ato janë dëshmitarë. Këto masa mund të përfshijnë, Krijimin e procedurave për mbrojtjen fizike; - Kur është e domosdoshme dhe e mundshme zhvendosjen e tyre, në rastet e duhura lejimin, mosdhënien ose dhënien e kufizuar të informacionit që ka të bëjë me identitetin e tyre dhe vendosjen, sigurimi i rregullave për marrjen e provave që lejojnë dhënien e dëshmisë nga dëshmitarët në një mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e tyre.

19 Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

20 Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

21 Neni 28 i KP.

22 Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

është dënuar me burgim; rehabilitimi social; ruajtja, ndryshimi dhe sigurimi i përkohshëm i vendit të punës.

Gjithashtu edhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda” përmban dispozita, ku parashikohet gjithashtu që kjo gjykatë mund të lejojë që pyetja e dëshmitarit dhe ballafaqimet të bëhen duke zbatuar, bashkërisht ose veçmas, rregullat vijuese:

- Në praninë e të pandehurit dhe të mbrojtësit, por pa kontakt pamor;
- Pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit;
- Pa u rregulluar burimet për të dhënat e dëshmitarit”.²³

E zbatimit të masave të posaçme varet nga: ekzistenca dhe niveli i gjendjes së rrezikut, përshtatshmëria e personit të mbrojtur në raport me masën e posaçme të mbrojtjes që zbatohet si dhe korrektësia e personit të mbrojtur në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen e mbrojtjes²⁴. Rregulla të tjera të rëndësishme për mbrojtjen e dëshmitarëve janë parashikuar edhe në shtesën e bërë në nenin 361/a-1 të Kodit të Procedurës Penale,²⁵ këto shtesa parashikojnë që pyetja e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre të cilat merren kryesisht nga ana e gjykatës ose me kërkesën e palëve. Në ligj nuk jepen përcaktime se cilat janë masat e veçanta të mbrojtjes, por parashikojnë që: “kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në nenin 361/7 e Kodit të Procedurës Penale” Këto janë garanci efektive dhe të realizueshme për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit sipas kushteve të kërkuara.

3. ÇËSHTJE TË PRAKTIKËS GJYQËSORE QË LIDHEN ME TRAJTIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT GJATË GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE NË SHKALLË TË PARË

Trajtimi i viktimës së trafikimit nga pozicioni i dëshmitarit gjatë gjykimin në shkallën e parë ku kompetente është Gjykata për Krime të Rënda²⁶ ka problematiken e saj. ku kryesorja është mungesa e parashikimeve ligjore të pozicionimit të viktimës përveçse në rolin dëshmitares ose paditëses civile për dëmin material. Në pozicionin e dëshmitares në shumicën e rasteve trajtim të veçantë kërkojnë seancat e sigurimit të provës së thënies të viktimave/dëshmitare gjatë fazës së hetimeve paraprake . Fillimisht ato marrin kurajën dhe bëjnë kallëzimin, por ndodh që gjatë gjykimin ato kur paraqiten si dëshmitare paraqesin një situatë tjetër që lidhen me presionin e mundshëm të trafikantëve. Gjatë seancës së sigurimit të provës për këto dëshmitare është aplikuar neni 8 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” duke u pyetur

23 Ligji nr 9110, datë 24.07.2003 , “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës së krimeve të rënda”.

24 Neni 10/4 i Ligjit nr. 9205, dt. 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

25 Ndryshimet e bëra me ligjin nr.9276, datë 16.09.2004. “Për disa ndryshime në KPrP”.

26 Gjatë periudhës 01.01.2011 – 24.04.2012, në GJKR rezulton se: Në tërësi, me objekt vepra penale që lidhen me “Trafikimin e qënieve njerëzore” kanë qenë në gjykim 13 (trembëdhjetë) çështje penale, prej të cilave: Nga çështjet që kanë qenë në gjykim, me këtë objekt, rezulton se **gjatë vitit 2011**: 12 çështje penale kanë përfunduar me vendim përfundimtar; Në çështjet penale të sipërhënuara janë sjellë për gjykim gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) persona, (të pandehur), prej të cilëve: Për veprën penale të “Trafikimit i të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 janë të regjistruara **3 (tre) çështje**: Gjithashtu për veprën penale “Trafikimi i të miturve” parashikuar nga neni 128/b/1 të K.Penal është regjistruar **1 (një) çështje penale**. Sa më sipër, për veprat penale të parashikuara nga nenet 128/b/3 dhe 128/b/1 janë akuzuar gjithsej **9 (nëntë) të pandehur**. Me akuzën e “Trafikimit të femrave për prostitucion”, sipas nenit 114/b/3 janë regjistruar **7 (shtatë) çështje penale** secila prej tyre me nga 1 (një) të pandehur. Për **këtë veprë penale, janë akuzuar 7 (shtatë) persona të sjellë për gjykim**. Kanë përfunduar 5 (pesë) çështje penale: Për këto çështje me nga 1 (një) të pandehur, është dhënë vendim përfundimtar, dy prej këtyre çështjeve penale janë gjykuar në vitin 2012. Për veprën penale të “Trafikimit të personave” parashikuar nga neni 110/1 të K.Penal ka pasur 1 (një) çështje penale e cila ka përfunduar me vendim përfundimtar. Në gjykim për veprën penale të “Shfrytëzimit i prostitucionit në rrethana rënduese” parashikuar nga neni 114/a të K.Penal, ka qenë regjistruar një çështje penale ku është akuzuar një i pandehur i cili ka qenë i akuzuar njëkohësisht edhe për veprën penale të “Trafikimit të femrave” parashikuar nga neni 114/b/1 të K.Penal. Në gjykim për veprën penale të “Trafikimit të femrave” parashikuar nga neni 114/b/2 të K.Penal ka qenë regjistruar 1 (një) çështje penale e cila ka përfunduar me vendim përfundimtar Për vitin 2012, deri në 24 Prill, kanë përfunduar me vendim përfundimtar gjithsej 2 çështje penale sipas nenit 114/b/3 të Kodit Penal. Aktualisht është vetëm një çështje në gjykim sipas nenit 114/b/3 të Kodit Penal.

pa kontakt vizual. Infrastruktura e Gjykatës sonë, sallat e gjyqit janë konceptuar për përmbushjen e kësaj garancie në trajtimin e viktimave. Gjatë shoqërimit të tyre në Gjykatë ne bashkëpunojmë me qendrat e rehabilitimeve dhe punonjësit psikologë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të mekanizmave të referimit.²⁷ Gjatë pyetjes së tyre në praktikë gjyqësore të Gjykatave të Larta është konstatuar se në kushtet kur viktimat e trafikimit janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale organet e zbatimit të ligjit në përgjithësi nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P (*përfundimi nga detyrimi për të dëshmuar*).

Rast Praktik: Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka dhënë Vendimin nr. 29 dt. 11.06.2007 sipas të cilit i pandehuri A.K. është gjetur fajtor për veprat penale të "*Trafikimit të femrave për prostitucion*", në dëm të shtetas H.Xh; "*Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese*", kryer në dëm të shtetas L.K. dhe "*Falsifikim të dokumenteve*", "*Falsifikim të pasaportave*", të parashikuara nga nenet 114/b/1, 114/a, pika 3,4,5,6 -25, 189/1, 186 dhe 278/a/2 i K.Penal dhe përfundimisht, në bashkim të dënimeve është dënuar me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Pas ankimit të palëve, për këtë çështje është dhënë Vendimi nr. 56 datë 11.12.2007, nga ana e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, sipas të cilit i pandehuri A. K. është gjetur fajtor edhe për veprën penale të pastrimit të parave të pista dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 20 (njëzet) vjet burgim. Ndërsa i pandehuri F. T. është gjetur fajtor nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, krahas veprave penale të falsifikimit të dokumenteve dhe falsifikimit të pasaportave, edhe për veprat penale të "*Shfrytëzimit të prostitucionit*" në rrethana rënduese, në dëm të shtetas M.D., të "*Shfrytëzimit të prostitucionit*" në dëm të shtetas L.K., të "*Pastrimit të parave të pista*" dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.

Ndaj këtij vendimi është bërë rekurs nga palët dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Larë ka dhënë Vendimin nr. 555 datë 03.12.2008, sipas të cilit Vendimi nr 29 datë 11.06.2007 të Gjykatës së shkallës së Parë dhe Vendimi nr 56 datë 11.12.2007 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal dhe si të tillë janë prishur duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se "*vendimet gjyqësore janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal, posaçërisht dispozitave të nenit 158/ç/2 e 151/4 të K.Pr.Penale*". Pasi citohet neni 158/ç/2 i K.Pr.Penale, në faqen 8 të Vendimit nr 555 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë arsyetohet se: "*Duke analizuar përmbajtjen e kësaj dispozite, vërehet se ligjvënësi, për shkak të ruajtjes së parimeve të një marrëdhënie shoqërore të rëndësishme, sikundër është ajo mes bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, e ka përjashtuar këtë rreth subjektësh nga detyrimi për të dëshmuar gjatë gjyqimit të procedimit penal në ngarkim të të afërmeve të tyre, në lidhje me ngjarje e fakte mbi të cilat ato kanë dijeni. Posaçërisht, ligjvënësi i ka njohur një status të veçantë bashkëshortit, ish bashkëshortit, bashkëjetuesit apo personit të lidhur me birësim me të pandehurin në një procedim penal, duke e bërë të detyrueshme për organin procedurës që në çdo rast, edhe kur kallëzimi i veprës të jetë bërë nga këto subjekte, në momentin e administrimit të dëshmisë atyre duhet t'i bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar. Në këtë mënyrë, vet ligjvënësi e ka veçuar këtë rreth subjektësh nga personat e tjerë që parashikon neni 16, të cilët pavarësisht lidhjes me të pandehurin, për sa kohë janë në cilësinë e kallëzuesit nuk mund të përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar. Në rastin konkret, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se ka qenë detyrim i gjykatës që zhvilloi seancën gjyqësore dhe mori dëshminë e shtetas H. Xh., që konform nenit 158/ç të K.Pr.Penale, në momentin kur mori dijeni për lidhjen mes të pandehurit dhe të dëmtuarës, t'i bënte të njohur kësaj të fundit të drejtën që ajo kishte për të mos dëshmuar... Për shkaqet e mësipërme, dëshmia e të dëmtuarës H. Xh. përbën një provë të administruar në shkelje të ligjit (neni 151/4 I K.Pr.Penale), e për rrjedhojë vendimet gjyqësore të cilat u bazuan në të duhet të prishen.*" Në bazë të nenit 440 dhe 447 të K.Pr.Penale, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë hetimi gjyqësor të kësaj çështje ka qenë e obliguar që të respektojë dhe ti përmbahet Vendimit nr 555 dt. 03.12.2008 të Gjykatës së Lartë, për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në të, si dhe të zbatojë detyrat dhe konkluzionet e këtij vendimi të Gjykatës së Lartë.²⁸

Problem është fakti kur viktimat e trafikimit kthehen në Shqipëri për pak kohë me qëllim për tu kthyer sërish në vendin nga vijnë dhe kanë përjetuar pasojat e trafikimit por që tashmë janë shkëputur nga kjo

27 Marrëveshja për mekanizmin kombëtar të referimit për viktimat e trafikimit, botim 2006 ODIHIR- OSBE.

28 Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

gjendje. Së pari, në legjislacionin tonë nuk ka një dispozitë procedurale për dhënien e një ndihmese viktimës në mënyrë të veçantë apo identifikimin e saj, rregullimi i vetëm është në suazën e aktit nënligjor.²⁹ Gjatë kësaj periudhe të shkurtër qëndrimi të tyre në Shqipëri mundësia e vetme është sigurimi i provës, ndërsa pyetja e tyre në gjykim mund të bëhet vetëm nëpërmjet letërporosive për jashtë shtetit.

4. DËMSPËRBLIMI OSE KOMPENSIMI I VIKTIMAVE. A SIGURON DREJTËSIA JONË PENALE DËMSPËRBLIMIN OSE KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE?

Sistemi ynë ligjor nuk ka një ligj të veçantë të kompensimit dhe të dëmshpërblimit të viktimave. Në legjislacionin tonë procedural penal ne kemi vetëm një mundësi për të siguruar dëmshpërblimin e viktimës për shkak të dëmit të shkaktuar. Kjo nëpërmjet padisë civile në procesin penal. Padia civile në procesin penal parashikohet nga neni 61 i Kodit të Procedurës Penale.³⁰ Kjo dispozitë i jep të drejtë personit që ka pësuar një dëm material nga vepra penale, ose edhe trashëgimtarëve të tij, që të kërkojnë, me anë të një padie civile në procesin penal, kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit. Viktimat e trafikimit mund të paraqiten në pozicionin e paditëses civile duke paraqitur padi civile në procesin penal kundër trafikantit të tyre, por dhe mund të të paraqesin një padi të veçantë civile, në gjykatën civile duke iu referuar dispozitës së lartpërmendur të Kodit Civil, mbi shpërblimin e dëmit jopasuror. Padia civile, në fakt, i siguron mbrojtje viktimës sepse me kërkesën e kësaj të fundit, si paditëse civile, organi procedues me qëllim që të sigurohet kthimi i pasurisë dhe shpërblimi i dëmit, mund të vendosë sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil. Kjo masë qëndron deri në përfundimin e çështjes.³¹

Për sa u takon disponimeve për padinë civile gjykata, sipas rastit, e pranon tërësisht ose pjesërisht ose e rrëzon atë. Kur jep vendim pafajësie, për shkak se fakti nuk parashikohet si veprë penale ose kur vendoset pushimi i çështjes penale, padia civile lihet e pashqyrtuar. Një çështje problematike e sistemit tonë procedural se për veprat penale që ndiqen me ankimin, ndjekja penale mund të fillojë vetëm kur i dëmtuari ankohet.³² Këtu futen kategoria kryesore e veprave penale në fushën e moralit të familjes. Instrumenti i akuzës private nuk ka rezultuar efektiv e nuk ka funksionuar si duhet kjo për arsye se të dëmtuarat nga dhuna në familje nuk e ushtrojnë atë po që se nuk asistohen. Kjo dhe për shkak të debateve ligjore nëse mund të përdoret padia civile në procesin penal neni 61 i KPrP për dëmin jopasuror pasi ky nen referon vetëm tek dëmi material. Çështjet e ushtrimit të përfaqësimit ligjor janë një problem më vete në garantimin e kësaj të drejte.

4.1 Cila është mënyra më e mirë për të siguruar këtë të drejtë të viktimës

Standardet ndërkombëtare kërkojnë kompensimin e viktimave të trafikimit, rehabilitimin e tyre moral e material. Njihen disa lloje kompensimesh për viktimën në legjislacione të ndryshme, sisteme të ndryshme ligjore kanë gjetur mënyra të ndryshme për të bërë kompensimin e viktimave. Kompensimi mund të bëhet nga autori i veprës penale ose nga shteti. Kompensimi nga autori i veprës penale mund të realizohet duke shfrytëzuar instrumentet proceduralë civile dhe penale. Instrumentet civile mund të përdoren duke inkurajuar ngritjen e padive civile të dëmshpërblimit të dëmit nga ana e viktimës. Ky instrument nuk është i favorshëm për situatën në të cilën vihet viktimja dhe kohëzgjatja e proceseve civile. Mënyra e bashkëveprimit të së drejtës civile në procesin penal ndaj autorit është një mënyrë tjetër që siguron gjykimin e njëkohshëm të autorit dhe të padisë së kërkit të kompensimit dhe lehtëson psikologjikisht viktimën e redukon

29 VKM nr.582 datë 27.07.2011” Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit.”

30 Neni 61:”Ai që ka pësuar një dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.”

31 Neni 63 i Kodit të Procedurës Penale.

32 Konventa Evropiane Mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme parashikon që shteti mund të ndihmojë në kompensimin e atyre që kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur nga një krim i dhunshëm dhe të personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë, nëse kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera. Kompensimi jepet edhe nëse personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose të dënohet.

procedurën e shpenzimet.³³ Kompensimi mund të bëhet ndaj viktimës edhe nëpërmjet caktimit të masës së kompensimit si pjesë e dënimit kryesor siç parashikojnë disa legjislacione. Disa legjislacione parashikojnë dhe mundësinë e kërimit nga ana e viktimës së fitimit të munguar p.sh nga mosmarrja e pagës. Kompensimi nga autori i veprës penale i cili e ka shkaktuar dëmin dhe vuajtjen duhet të jetë qëllimi kryesor. Kjo mund të bëhet në disa mënyra: kompensimi nëpërmjet proceseve civile e penale.

4.2 Si mund të sigurohet dëmshpërblimi i këtyre viktimave dhe kompensimi i tyre në rastin e sistemit tonë ligjor!

Siç përmendëm më sipër instrumentet proceduralë civilë e penale nuk rezultojnë efikase. Sigurimi i fondeve publike jo gjithmonë i mundur – mund të jetë e mundur vetëm krijimi i skemave të sigurimeve shëndetësore ose rrjeteve sociale të financuara nga shteti. Më i volitshëm mund të ishte miratimi i një ligji të veçantë për kompensimin e viktimave të trafikimit apo të dhunës në përgjithësi. Ky ligj do jetë në ndihmë të personave të dhunuar që kanë pësuar dëmtim të shëndetit si rezultat i krimit dhe kanë nevojë për trajtim shëruar, pension apo pagesë tjetër për mirëqenie. Mënyrë tjetër është sigurimi i fondeve për kompensimin e viktimave nëpërmjet pasurive të sekuestruara e të konfiskuara trafikantëve, pasuri të vëna në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kryerjes së veprës.

Në rastin e viktimave të trafikimit apo viktimave të veprave penale të rënda që janë në kompetencën e Gjykatës për Krime të Rënda *ligji antimafia*³⁴ ka parashikuar mundësinë e kompensimit të viktimave nëpërmjet pasurive që u konfiskohen autorëve të veprave penale të këtyre veprave. Pra, pasuritë e konfiskuara futen në një fond të veçantë - *Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor*. Pasuritë e paluajtshme dhe mjetet monetare të këtij fondi mund të përdoren dhe për kompensimin e viktimave të trafikimit ose të krimeve të tjera të rënda. Por ligji nuk ka parashikuar drejtpërdrejt autoritetin dhe kompetencën e gjyqtarit për të vendosur për kompensimin si dhe nuk është e qartë se në çfarë mënyrë mund të përfitojë një viktimë nga ky fond: nëpërmjet procesit administrativ apo atij penal e civil. Në ligj mund të bëhen ndryshime ku ky regjim të ndryshohet në dobi të viktimave të trafikimit. Fondi i posaçëm mund të përdoret për kompensimin e dëmit fizik e moral të femrave të trafikuar drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit të kërkesës për konfiskim ku gjyqtari të këtë kompetencë për të urdhëruar kompensimin në një masë të caktuar.

5. NDRYSHIMET LIGJORE TË NEVOJSHME

Të drejtat e viktimës duhen konsideruar si të barabarta me të drejtat e të akuzuarit. Është evidente tendenca e përgjithshme e përcaktimit të të drejtave procedurale të të akuzuarit si të drejta themelore të njeriut, por një gjë e tillë nuk vërehet kur bëhet fjalë për të drejtat e viktimës. Duhet gjetur patjetër mënyra të evitimit të viktimizimit sekondar në mënyrë që të inkurajohet qasja e viktimës drejt sistemit ligjor duke e përmirësuar përshtypjen e deri tanishme për këtë sistem si të huaj, të shtrenjtë dhe të largët për viktimën. Sa i përket Shqipërisë, mendoj që është koha që ta pranojmë së pari termin “*viktimë*” në legjislacionin dhe të adaptojmë “*viktimologjinë*” si teori, si dhe ti sigurojmë të drejtat themelore të tyre për arritjen e balancës mes të akuzuarit dhe viktimës duke parashikuar mundësinë për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë. Duhet gjetur një instrument ligjor efikas për kompensimin duke miratuar një ligj të veçantë për kompensimin e viktimave të trafikimit ose duke ndryshuar ligjin “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”.³⁵

5.1 Ndryshimet e nevojshme në ligjin penal.

Një riorganizim më i mirë i përmbajtjes së neneve të KP mbi veprat penale antitrafikim duke përdorur një gjuhë më të thjeshtë, lehtësisht të kuptueshme nga zbatuesit e ligjit. Për këto nene duhen **standardizuar edhe termat dhe elementët e përdorur në përmbajtjen e neneve për trafikimin**, pasi në Kod nuk ka një përkufizim të qartë për to. Në përgjithësi, edhe nga zbatuesit e ligjit në praktikë janë hasur vështirësi

33 Mekanizmat kombëtare të referimit, Manual praktik, OSBE/ODIHR.

34 Ligj n.r. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese”.

35 Ligj n.r. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese”.

në kuptimin dhe interpretimin e elementëve të veprës penale të trafikimit. Duhet që të rishikohen dhe qartësohet interpretimi i disa termave si “*fshehja*”, “*marshtrimi*”, “*përfitimi nga gjendja shoqërore*”, “*vënia në përdorim ose transplantimi i organeve*”³⁶ etj.

Vepra penale **me nenin 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”** duhet riformuluar e kaluar në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda. Duhet shtuar një nen për shfrytëzimin e të miturve. Legjislacioni penal duhet të njohë **përrjashtimin nga përgjegjësia** penale të viktimave të trafikimit për veprime të paligjshme, të cilat ato mund t’i kenë kryer si gjatë shfrytëzimit të tyre si viktima trafikimi. Neni 307 i KP, paragrafi parë, i ngarkon me përgjegjësi penale personat që refuzojnë për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth dijenisë për kryerjen e një vepre penale. Në nenin 307 të shtohet një paragraf ku të listohen arsytet e ligjshme për përrjashtimin nga përgjegjësia penale të personave që kanë dijeni për veprën penale, duke e shprehur më vete edhe rastin kur personi është viktimë e trafikimit apo viktimë e krimit në përgjithësi (këtu mund të përfshihen të gjitha ato vepra që ndiqen kryesisht). Për më tepër, viktimat e trafikimit për shkak të pozitës së tyre si viktima mund të detyrohen të kryejnë edhe vepra të tjera penale si: kalimi i paligjshëm i kufirit, falsifikimi i dokumenteve, përfshirje në veprimtari kriminale (*shitje të lëndëve narkotike, vjedhje deri edhe vrasje*). Në KP të shtohet një dispozitë e veçantë në të cilën të parashikohet përrjashtimi nga përgjegjësia penale i viktimave të trafikimit për të gjitha krimet apo kundërvajtjet e kryera si viktima trafikimi.³⁷

5.2 Ndryshimet e nevojshme në legjislacionin procedural e ligjet e veçanta

Siç e theksuam më sipër për viktimat e krimit në përgjithësi, dhe viktimat e trafikimit në veçanti në K.Pr.P nuk janë parashikuar dispozita të cilat marrin në mbrojtje pozitën e tyre në procesin penal. Sipas K.Pr.P viktima e trafikimit shfaqet në procesin penal me *statusin e dëshmitares së një rëndësie të veçantë, por ato nuk legjitimohen si palë në procesin penal*. Veprat penale të trafikimit janë vepra që ndiqen kryesisht dhe në këtë rast e dëmtuara (viktima e trafikimit) nuk mund të paraqitet si palë në proces siç paraqitet i dëmtuari akuzues për veprat penale të parashikuara nga neni 59 i K.Pr.P. Viktima e trafikimit, duke mos qenë e përfaqësuar në proces, nuk është e mbrojtur si duhet, pavarësisht garancive të tjera ligjore.

Zgjidhja do të ishte që të parashikohen dispozita të veçanta në K.Pr.P për përfaqësimin e viktimës (*interesave të viktimës*) nga persona të tretë, përfaqësues ligjorë të viktimës, avokatë, punonjës të organizatave të ndryshme etj., dhe kjo të realizohet brenda procesit penal, edhe në rastin kur viktima nuk pranon të dëshmojë. Duhet rishikuar dispozitat e K.Pr.P që rregullojnë aksesin e të dëmtuarës në drejtësi (*në këtë rast viktimës së trafikimit, por jo vetëm*) me qëllim që ai/ajo (*i dëmtuari/e dëmtuara*) të bëhet palë aktive në proces në funksion të mbrojtjes së interesave dhe rehabilitimit të saj.

Çështja e kompensimit të viktimave të trafikimit **kompensimin e viktimës së trafikimit** ka nevojë për përmirësime ligjore. Krahas krijimit të një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të trafikimit duhen ndryshuar dhe plotësuar edhe dispozitat e K.Pr.P për ngritjen e padisë civile në procesin penal dhe gjykimin e saj brenda këtij procesi. Ky është edhe rasti i vetëm ku, sipas K.Pr.P nenet 58-68, viktima e trafikimit mund të marrë pjesë si palë në proces, nëpërmjet padisë civile në procesin penal, për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit. Për çështjen e kompensimit të viktimave të trafikimit duhen pasur parasysh rekomandimet e dhëna nga misionet vëzhguese³⁸ dhe direktivat e rekomandimet ndërkombëtare.³⁹ Mungesa e parashikimeve të

36 Raporti i GRETA-s - paragrafët 48 – 52. Qartësimi i termave dhe koncepteve të përdorura në Kod Penal do të na ndihmonte për të standardizuar edhe termin e saktë që duhet të përdorimin për vetë fenomenin, problem i krijuar edhe për shkak të vështirësive në përkthimin dhe kuptimin e termave të tillë si: *trafikimi i qënieve njerëzore, trafikimi i personave, trafikimi në njerëz etj.*

37 Raporti i GRETA-s – paragrafi 162, 163, 164, 165 dhe rekomandimi nr. 24 referuar nenit 26 të Konventës së KE-së “Dispozita e Mosdënimit”.

38 Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (raporti i GRETA-s paragrafët 171, 172, 174, 128 dhe rekomandimi nr. 17).

39 Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011 (paragrafi 13 dhe neni 17) rekomandojnë dhe inkurajojnë përdorimin e aseteve të konfiskuara për mbështetjen e viktimës së trafikimit për mbrojtje përfshirë edhe kompensimin.

qarta në K.Pr.P për **dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit në mënyrë të pakushtëzuar**. Në praktikë kjo është zgjidhur duke iu referuar direkt akteve ndërkombëtare ose me instrumente të tjera si: Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit.

Duhet të ndryshohet K.Pr.P., përkatësisht neni 158 të K.Pr.P. Nga praktika gjyqësore është konstatuar se, në kushtet kur viktimat e trafikimit janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale, organet e zbatimit të ligjit, në përgjithësi, nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P. Por në të vërtetë, në mënyrën se si është aktualisht e formuluar dispozita e mësipërme krijon paqartësi lidhur me *të drejtën e të dëmtuarve për të mos dhënë deklaratim* në fazën e hetimeve paraprake apo dëshmi gjatë gjykimit, në rastet kur deklarojnë se kanë bashkëjetuar apo kanë lidhur martesë me tutorët e tyre.⁴⁰ Nisur nga nevoja për të pasur një kuadër ligjor sa më të plotë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, i cili të jetë edhe në përputhje me standardet dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, mund të shikohet mundësia e ideja e hartimit të një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Reformat ligjore dhe institucionale gjatë këtyre 10 viteve të fundit në luftën kundër trafikimit duhen vijuar dhe me trajtimin e viktimave të trafikimit e kompensimin e tyre; përvoja e deritanishme e Gjykatës së Krimeve të Rënda e strukturave të tjera pararendëse antitrafikim janë në garanci për përmbushjen e këtij standardi të ri. Shteti dhe shoqëria duhet të bëjnë çështje e mundur për t'u ndihmuar viktimave ta tejkalojnë stigmën me të cilën ballafaqohen dhe të çlirohen prej saj dhe në këtë mënyrë, duke dekurajuar autorët e mundshëm të trafikimeve. Kompensimi ose dëmshpërblimi moral për veprimin e trafikimit do ti jepte viktimës së trafikimit mundësinë për tu rehabilituar moralisht e integruar objektivisht dhe njëherë në jetën social – ekonomike duke rivendosur në vend të drejtën. Kjo duke e bërë Shqipërinë që të plotësojë standardet e nevojshme në këtë fushë të drejtësisë penale.

BIBLIOGRAFIA:

1. The responsibilities and the rights of victims of crime. The Modern Law Review 1992 Jul; 55(4): 482-505.
2. Sebba L. The victim's role in the penal process: A theoretical orientation. The American Journal of Comparative Law 1982; 30(2): 217-240.
3. The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: <http://www.unhcr.ch/html/menu3/b/h>
4. Mekanizmat kombëtare të referimit, Manual praktik, OSBE/ODIHR-botim 2006
5. Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.
6. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollit II i saj "Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve"
7. Plan - Veprim për Luftimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit - Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.
8. Konventa e Këshillit të Evropës "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme"
9. Konventa e Këshillit të Evropës "Për Veprim kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore"
10. Vendimi dt.15.03.2001 të Këshillit të BE për pozitën e viktimave në procedimet penale "
11. Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së "Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale"
12. Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së "Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit".
13. Rekomandimi nr.9713 i KE-së "Në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes".

⁴⁰ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 555 datë 03.12.2008.

14. Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
15. Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011
16. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, www.qpz.gov.al
17. Kodi i Procedurës Penale, viti 1995 i ndryshuar
18. Ligji nr 9110, datë 24.07.2003 , “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës së krimeve të rënda”. www.qpz.gov.al
19. Ligji nr. 9205, dt. 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”
20. Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese”
21. VKM nr.582 datë 27.07.2011” Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit.
22. Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
23. Vendimin nr. 29 date 11.06.2007 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al
24. Vendimi nr. 56 date 11.12.2007, nga ana e Gjykatës se Apelit për Krime te Renda,
25. Vendimin nr. 555 date 03.12.2008 i Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al

Dhurata HAVERI¹

Duke pasur parasysh cenimin masiv të së drejtës për të jetuar dhe shkeljen e të drejtave të fëmijëve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, shpalli më 20 Nëntor 1959 “Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës”. Që nga kjo datë, 20 nëntori është shpallur ditë e të drejtave të fëmijëve. Në hyrjen e deklaratës në fjalë thuhet: *“Njerëzimi, u ka borxh fëmijëve gjërat më të mira që ai mund t’iu ofrojë”*.

1. ÇFARË TREGON KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Të drejtat në fjalë mund të përmbliidhen në dhjetë pika:

1. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.
2. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të gëzojnë shëndet të plotë dhe t’ju jepet kujdesi maksimal shëndetësor dhe mjekësor.
3. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për arsim fillestar falas. Përveç kësaj, atyre duhet t’iu mundësohet edhe arsimimi i mëtejshëm.
4. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për pushim, kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike.
5. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t’u dëgjuar.
6. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për një edukim të mirë, prindërit apo edukatorët e tjerë nuk duhet të përdorin dhunë, keqtrajtimi dhe keqpërdorimi është i ndaluar.
7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë në luftë dhe gjatë arratisjes.
8. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes nga puna shfrytëzuese dhe keqpërdorimi seksual.
9. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe të mbajnë kontaktin me të dy prindërit, nëse ata janë të ndarë.
10. Fëmijët dhe të rinjtë e gjymtuar kanë të drejtën e ndihmës dhe përkrahjes së veçantë, si dhe të pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

Jo pa qëllim parashtrova rrethin e të drejtave në mënyrë që të dalin në pah detyrimet në vijim të realizimit të të drejtave.

2. TRAFIKIMI I TË MITURVE DHE PROBLEMET E PRAKTIKËS GJYQËSOR QË LIDHEN ME TO

Trafikimi i “të miturve” i parashikuar si i tillë në nenin 128 /b/1 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: “rekutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual të punës ose shërbimeve të tjera të detyruara, skllavërimi ose forma të ngjashme me skllavërimin, dënohet me burgim 7-15 vjet dhe me 4 -6 milion lekë”.

¹ Gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

Në referim të dispozitës sa më sipër Prokuroria për Krimet e Rënda dhe në vazhdim Gjykata për Krimet e Rënda ka bërë pjesë të procedimeve penale shumë raste, të cilat që nga viti 2004, kohë kur dhe ka filluar të funksionojë në bazë të Ligjit nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda,” nga organi i akuzës dhe më pas gjykata për krimet e rënda i janë nënshtruar procesit hetimor dhe më pas gjyqësor 22 raste të procedimit penal, për të cilat është konkluduar me vendim përfundimtar, kundër të pandehurve të akuzuar për kryerjen e veprës penale, sipas parashikimeve të nenit 128/b të Kodit Penal.

Natyra e gjykimeve dhe veçoritë e tyre për efekt të rrethit të personave të dëmtuar,² nga konsumimi i elementëve të veprës penale si më sipër është shumë e ndjeshme dhe me një rëndësi dhe vëmendje veçanërisht të rëndësishme për shkak të subjekteve të dëmtuara nga kryerja e kësaj vepre.

Në tërë praktikën gjyqësore vëmendja ndalet në legjislacionin që rregullon dhe normon marrëdhënie të rëndësishme duke marrë në mbrojtje kështu këtë subjekt të veçantë, për shkak të detyrimit ligjor që rrjedh nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligjet e dala në bazë dhe për zbatim të saj.

Në funksion të gjykimeve me akuzën sa më sipër vjen në ndihmë, Protokollin për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar e bërë e zbatueshme në Shqipëri.³

Duke parë në kohë ecurinë e këtyre proceseve konstatohet se pothuaj se në të gjitha rastet është pranuar kërkesa për gjykim e organit të prokurorisë për krime të rënda me të pandehur të akuzuar për veprë penale të parashikuar nga neni 128/b të Kodit Penal, nga Gjykata për Krime të Rënda duke konkluduar në përfundim të këtyre gjykimeve me pranimin e kërkesës dhe deklarimin fajtor të të pandehurve sipas akuzës së ardhur për gjykim.

Kjo gjë flet për një kuptim dhe trajtim të saktë të kritereve ligjore, elementëve të veprës penale që duhet të jenë prezent në rastin e akuzës së trafikimit të të miturve, parashikuar si i tillë nga neni 128/b i Kodit Penal.

Në rastet e ardhura për gjykim, në arsyetimet e saj ligjore gjykata është ndalur në analizën e elementëve përbërës të figurës së veprës penale të trafikimit të të miturve të cilat kanë qenë prezent ose jo dhe që kanë të bëjnë me realizimin nga ana e të pandehurve të formave të “rekrutimit”, “transportimit”, “transferimit”, me qëllim shfrytëzimit të punës e cila përbën dhe rastin më të përhapur dhe më të shpeshtë në praktikën gjyqësore, të konstatuar gjatë këtyre viteve. Vërehet se shpesh herë këto raste shoqërohen me keqtrajtime dhe detyrime me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme të cilat kanë si qëllim fitimin material ose jo i cili mund të jetë i realizuar në vlera të caktuara ose në pritje të realizimit të këtij qëllimi.

3. ZBATIMI I KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nga praktika gjyqësore në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ku në nenin 3 pika “c” parashikohet se: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmijë për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet trafik personash, edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nenin paragrafin (a) të këtij neni, dhe në pikën (d) parashikon se: (d) “Fëmijë” nënkupton çdo person nën 18 vjeç.

Është pranuar referuar rasteve objekt shqyrtimi, se në zbatim të konventës si më sipër nuk ka rëndësi të provohet nëse nga të pandehurit janë përdorur mjetet e kërcënimit, mashtrimit, shtrëngimit, pasi nuk

² Viktima të trafikimit.

³ Me Ligjin nr. 8920 dt 11/07/2002, ku në nenin 3, Përkufizime, germa (d) të tij thotë : (d) “Fëmijë “ nënkupton çdo person nën 18 vjeç.

kërkohej nga dispozita përkatëse, por është mjaftuar të provohet se të pandehurit, pa përdorur mashtrimin apo forma të tjera kanë kryer veprime të paligjshme të “rekrutimit”, “transportimit”, “transferimit” të një fëmijë me qëllim shfrytëzimi, gjë që e bën të dallueshme veprën penale të trafikimit të fëmijëve sipas nenit 128/b të Kodit Penal nga neni 114/b i Kodit Penal”, “trafikimi i femrave”,⁴ i cili rregullon rastet kur subjekte të dëmtuara janë mbi moshën 18 vjeç dhe të aftë për të kuptuar rrezikun e veprimeve të paligjshme të kryera ndaj tyre që kanë për qëllim trafikimin e personave.

Në të gjitha rastet konstatohet dukshëm se rrethi i personave të dëmtuar nga kryerja e veprimeve të paligjshme të të pandehurve janë persona të cilët janë vulnerabël, në kushte të rënduara familjare, me prindër të divorcuar dhe në pamundësi të garantimit të tyre të një trajtimi të duhur arsimor, social dhe kulturor, të braktisur nga prindërit biologjik, por dhe nga rrethi i afërt i tyre, të pambrojtur ndjeshëm nga strukturat përgjegjëse për garantimin e kushteve minimale jetike, arsimore dhe shëndetësore të tyre, rrethana këto të studiuara paraprakisht nga subjektet e këtyre veprave penale dhe që i bën kështu viktimat e trafikimit të jenë pre e lehtë për tu arritur dhe “gjahu” i tyre.

Për shkak të pamundësisë së tyre për tu mbrojtur dhe paaftësisë së tyre për të kuptuar riskun dhe rrezikun që i vjen nga këto veprime të paligjshme, që në vetvete përbëjnë elementët e figurës së veprës penale të “trafikimi të fëmijëve”,⁵ qoftë edhe të personave që e kanë për detyrë të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, prindërit biologjik, ky grup personash bëhet viktimë e veprimeve të paligjshme shpesh herë nga personat më të afërm të tyre.

Kështu, për shkak të kompleksitetit dhe të marrëdhënive të ndërthurura familjare dhe shoqërore veprimet e paligjshme që kanë në thelb të tyre elementet e veprës penale të trafikimit të të miturve, sipas nenit 128/b të Kodit Penal, simulohen me veprime të birësimit ose të kalimit të paligjshëm të kufirit.

Kështu për shembull, në rastin me të pandehur A.Xh etj, rrethanat e faktit penal paraqiteshin si më poshtë..: Të pandehurit A. Xh,Z.Sh, dhe E,R janë shtetas “romë” dhe kanë lidhje midis tyre. I pandehuri A. Xh është nip i të pandehurit D. S ndërsa ky i fundit është bashkëshort me të pandehurën Z. Sh.

Në ditët e verës 2006 shtetasja A. B gazetare e emisionit “Fiks Fare”, pranë stacionit të televizionit “Top Channel” tek ka kaluar pranë Parkut Rinia ka parë disa fëmijë romë që lypnin lëmshë. Ajo ka menduar që, në kuadër të emisionit “Fiks Fare” të bëjë një kronikë televizive për këtë emision. Deklaruesja është prezantuar me emrin Anjeza, ka hyrë në bisedë me njërin prej tyre duke i shprehur interesimin dhe dëshirën e motrës së saj që jetonte në Greqi, e cila donte të birësonte kundrejt shpërblimit një fëmijë. Deklaruesja Anjeza i ka thënë bashkëbiseduesit se e motra ndodhej në Greqi dhe nga martesja e saj prej 15 vjetësh nuk kishin lindur fëmijë. Pas disa kontaktesh deklaruesja është orientuar të kërkojë dhe pasi ka gjetur ka negociuar me të pandehurin A. Xh gjithnjë duke shfaqur interesimin e marrjes për birësim kundrejt shpërblimit të një fëmije për motrën e saj në Greqi. I pandehuri A. Xh ka ndërmjetësuar duke biseduar me të pandehurin D. S dhe Z. Sh për të dhënë për birësim kundrejt shpërblimit djalin e tyre të mitur G .Sh. Në këto kushte me dt 7/11/2006 të pandehurit si më sipër janë takuar dhe kanë biseduar me shtetasen A. B (gazetaren) dhe sipas kërkimit të saj për birësimin e fëmijës janë nisur nga Tirana në Gjirokastër me destinacion Greqinë, ku dhe është bërë paraprakisht shpërblimi prej 1000 eurosh. Me arritjen në Greqi dhe përfundimin e procedurave të birësimit do të likuidohej dhe pjesa e mbetur e detyrimit prej 3000 eurosh. Për efekt të realizimit të birësimit me dokumente prindërit biologjike kanë lëshuar deklaratë ku kanë shprehur vullnetin e përcaktuar nga shtetasja A.B (gazetare) se fëmijën e tyre do ta jepnin për birësim. Me ndërmjetësimin e një personi tjetër do të realizohej kalimi i fëmijës jashtë territorit shqiptar kundrejt shpërblimit. Në këto kushte pasi ka kaluar fëmija në Greqi është likuiduar dhe pagesa prej 2500 eurosh e cila ka qenë pjesë e shpërblimit për realizimin e trafikut ose lëvizjes, zhvendosjes, transferimit të fëmijës nga territori shqiptar në territorin grek.

4 Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004.

5 Neni 128/b i Kodi Penal.

U ndala në parashtrimin e këtij rasti, jo pa qëllim, por për të kuptuar se sa pak vlen jeta e një fëmije dhe sa i pambrojtur është ai përpara cenimit të të drejtave të tij, qoftë kur këto të drejta nëpërkëmbën apo cenohen dhe nga prindërit biologjik.

Në rastin konkret trafikimi i të miturve parashikuar si i tillë nga neni 128/b i Kodit Penal konkurrin me veprën penale të “kërkimit ose marrjes së shpërblimeve për procedurat e birësimit⁶ dhe me veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit.⁷

Referuar dispozitës, neni 128/b/3 të Kodit Penal dhe kuptimit të ligjit material penal për skllavërimin gjykoj se nocioni i skllavërimit si fenomen shkon tej shitjes, presupozon një interval kohor më të gjatë në kohë, është një mekanizëm i përdorur nga përfituesi (trafikanti) për sigurim fitimi material ose jo, i vazhdueshëm, që fillon me veprime konkrete në funksion të kryerjes së veprës dhe mbaron me skllavërimin ose me forma të ngjashme me skllavërimin (kryerjen e punëve apo shërbimeve të ndryshme të detyruara), por që mund të funksionojë ose jo në raporte prindër - fëmijë dhe më tej.

Vetë ekzistenca e termit “skllavërim ose forma të ngjashme me skllavërimin” i përdorur nga ligjvënësi në dispozita të Kodit Penal në kuadër të “trafikimit të të miturve” dhe parashikimi i tij në ligj, neni 128/b/3 i Kodit Penal,⁸ nuk mjafton të konsiderohet prezent si formë e veçantë e kryerjes së kësaj vepre penale apriori pa u provuar rrethanat që kanë çuar në skllavërim e që shpesh herë bëhen të vështira për tu vërtetuar.

Dhe në fund do doja ta mbyllja me një citat të shkrimtarit të njohur britanik Charles Dickens: “Në botët e tyre të vogla, në të cilat fëmijët gjejnë ekzistencën... nuk ka asgjë që perceptohet dhe ndihet aq saktë si padrejtësia. “Parë në këtë këndvështrim detyra e organeve të procedimit penal merr një rëndësi të veçantë në luftën kundër këtij fenomeni veçanërisht të rrezikshëm për shoqërinë tonë dhe më gjerë.

BIBLIOGRAFIA:

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
3. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

⁶ Parashikuar nga neni 124/a të Kodit Penal.

⁷ Parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal.

⁸ Ligji nr 9188, dt 12/2/2004 dhe shtuar fjala shitje me Ligjin nr 9859, dt 21/1/2008.